



DEMARKACIONI KOSOVË – MALI I ZI

(ASPEKTE NDËRKOMBËTARE, GJEOGRAFIKE,
POLITIKE DHE HISTORIKE)



Redaktra: Pof. Dr. Muhamet Sadiku
Lektura: Sylë Osmanaj
Ballina: Dardan Luta
Botimi: Adhoc

Ekipi i hulumtimit:

- 1.Prof. dr. Zejnullah Gruda
- 2.Prof. dr. Muharem Cërabregu
- 3.Prof. dr. Riza Smaka
- 4.Prof. dr. Florim Isufi
- 5.Prof. dr. Shpejtim Bulliqi
- 6.Prof. dr. Muhamet Sadiku
- 7.Prof. dr. Zymer Neziri
- 8.Sylë Osmanaj

2015

Përmbajtja

Hyrje

Prof. dr. Muhamet Sadiku

1. INFORMATA BAZIKE

- Aspekte politike dhe kushtetuese
- Aspekte gjeografike
- Komuna e Pejës në kontekstin e demarkacionit
- Plani hapësinor i parkut nacional “Bjeshkët e Nemuna”

2. ASPEKTE NDËRKOMBËTARE TË DEMARKACIONIT: MËSIMET PËR RASTIN E KOSOVËS

Prof.dr. Zejnullah Gruda

- Konteksti ndërkombëtar dhe ex - jugosllav i demarkacionit

Prof. dr. Riza Smaka

- Delimitacioni dhe demarkacioni kufitar ndërmjet Kosovës, Malit të Zi dhe Serbisë

3. ASPEKTE GJEOGRAFIKE DHE HARTOGRAFIKE TË DEMARKACIONI

Prof. dr. Muharem Cërabregu

- Parimet e përgjithshme dhe të veçanta në përcaktimin e kufijve shtetërorë të Republikës së Kosovës

Prof. dr. Florim Isufi & Prof. dr. Shpejtim Bulliqi

- Të dhënat hartografike mbi kufirin Kosovë – Mali i Zi

4. ASPEKTE HISTORIKE TË KUFIRIT KOSOVË - MALI I ZI

Prof. dr. Zymer Neziri

- Kufiri Kosovë - Mali i Zi në Luftën e Dytë Botërore

Sylë Osmanaj

- Konteksti historik i kufirit ndërshtetërorë në mes Kosovës dhe Malit të Zi

Prof. dr. Muhamet Sadiku

5. REAGIMI INSTITUCIONAL DHE QYTETAR

- Reagimi institucional
- Reagimi qytetar dhe i komunitetit të prekur nga demarkacioni

Konkluzionet

populli ju ndal” (Koha Ditore)

- *“S’preket asnjë metër i Kosovës me Malin e Zi” (Zëri)*

SHTOJCAT

Hartat

Dokumente dhe shkresa

- *Informatë nga Komisioni shtetëror për shenjimin dhe mirëmbajtjen e kufirit shtetëror*

(Republika e Kosovës – Mali i Zi)

- *Kërkesa e AAK-së për pezullimin e nismës për lidhjen e Marrëveshjes në mes Kosovës dhe Malit të Zi për demarkacionin e kufirit (5 gusht 2015)*
- *Konkluzionet e Kuvendit Komunal të Pejës (maj 2015)*

Shtypi

- *“Banorët paralajmërojnë “luftë”, nëse Qeveria pranon vijën e Malit të Zi “ (Koha Ditore)*
- *“Cërabregu: Kufiri me Malin e Zi sipas hartës së viti 1962” (Koha Ditore)*
- *“Shteti fqinj gllabëron 12 mijë hektarë tokë të Kosovës” (Kosova Sot)*
- *“Thaçi e Hyseni do të firmosin për kufirin me Malin e Zi” (Koha Ditore)*
- *“Haradinaj: Vija e kufirit me Malin e Zi e gabuar, ndaloni se*

Hyrja

Në kohë të fundit është sensibilizuar çështja e përcaktimit të vijës së demarkacionit Kosovë - Mali i Zi. Në kohën kur Komisioni shtetëror i Kosovës për shënimin dhe mbikëqyrjen e kufirit Kosovë - Mali i Zi, paralajmëron përfundimin e këtij procesi, në opinionin e gjerë publik dhe profesional – shkencor po shprehen shqetësime rreth pasojave politike afatgjata, cilësisë dhe kredibilitetit profesional të këtij procesi. Për përfundimin dhe arritjen e marrëveshjes më parë, në ueb-sajtin e saj, kishte paralajmëruar edhe pala malaziase. Hartimit të këtij hulumtimi i kanë paraprirë protestat e qytetarëve, dy panel-diskutime, njëri në QPZH & FES dhe tjetri në Kuvendin e Kosovës, si dhe diskutimi në Komisionin për politikë të jashtme të Kuvendit të Kosovës. Diskutimi, sidomos në panelin e parë, ka theksuar nevojën e reagimit me argumente shkencore hartografike dhe me faktografi historike.

Deri më tani këto bisedime janë shoqëruar me kontestime dhe shqetësime, sidomos të qarqeve shkencore, të komunave dhe të komunitetit të prekur. Megjithatë, këto shqetësime kanë mbetur të paadresuara nga institucionet qeveritare të Republikës së Kosovës duke dhënë porosi nga institucionet qeveritare se Kosova “nuk do të humbë as një milimetër toke.” Aktualisht opinionin është shumë pak i njoftuar për punën e komisionit shtetëror dhe kjo gjë paraqet një situatë të vështirë, sidomos për banorët e viseve kufitare, të cilët preken me vijën e demarkacionit, por edhe për qytetarët e Republikës së Kosovës në përgjithësi. Paraqiten edhe komente se procesi duhet të përfundohet, ngase vonesa mund të ndikojë në dinamikën e MSA-së dhe të liberalizimit të vizave. Megjithatë, në demokraci pjesëmarrja e shoqërisë civile në çështjet sensitive, siç është kjo, mund të jetë e dobishme. Kjo situatë mund të tejkalohet nëse bisedat bëhen transparente dhe nëse sigurohet involvimi i institucioneve dhe i ekspertëve shkencorë të fushës përkatëse dhe i shoqërisë civile, i medimeve dhe i komunitetit.

Në përgatitjen e këtij hulumtimi janë marrë në konsideratë inputet shkencore dhe profesionale, informatat e Komisionit shtetëror, shqetësimet e shoqërisë civile dhe të komuniteteve. Gjithashtu, janë marrë në konsideratë edhe shumë intervista dhe biseda me përfaqësues të komunitetit të prekur. E tëra kjo ka për qëllim që të fuqizohet pozita negociuese e Kosovës në raport me pretendimet e palës malaziase. Hartuesit e këtij hulumtimi dhe të gjeturat e tij, mund të jenë të dobishme në rishqyrtimin e këtyre bisedave dhe të vendimeve qeveritare. Dhe përfundimisht procesi të vihet mbi bazë të parimeve shkencore e profesionale të demarkacionit dhe të mbështetet me argumente gjeografike - hartografike, natyrore - morfo-hidrologjike, etnike dhe historike.

Në fund të raportit prezantohen edhe konkluzionet që e reflektojnë seriozitetin e çështjes dhe gjetjen e zgjidhjeve më të mira në funksion të ndërtimit të fqinjësisë së mirë dhe të rritjes së bashkëpunimit me Republikën e Malit të Zi.

Falënderimi i veçantë për mbështetjen e hartimit të këtij hulumtimi i takon Fondacionit gjerman Friedrich Ebert Stiftung.

Prof. dr. Muhamet Sadiku

Prishtinë,
2015

Prof. dr. Muhamet Sadiku
1. INFORMATA
BAZIKE

Aspekte politike dhe kushtetuese

Që me përfundimin e Luftës së Dytë Botërore, statusi politik - kushtetues i Kosovës në kuadër të Jugosllavisë së dytë ka përjetuar një evoluim në kuptimin e avancimit të pozitës së saj kushtetuese, edhe pse i vonuar dhe i pamjaftuar. Në vitin 1945 Serbia me Ligjin mbi ndarjet administrative Kosovën e konsideronte si krahinë autonome të Kosovës dhe Metohisë. Harta e vitit 1962 Kosovën e paraqet në kufijtë e vet administrativë. Krahina e Kosovës dhe Metohisë përbëhej nga 28 njësi administrative. Me ndryshimet kushtetuese të vitit 1963 Kosova e fiton statusin e Krahinës Autonome në kuadër të Republikës së Serbisë

Të gjitha zhvillimet politike në ish - Jugosllavi në fund të viteve të 60-ta dhe në fillim të viteve të 70-ta kanë rezultuar në decentralizim në rendit politik dhe ekonomik. Kjo është reflektuar edhe në fuqizimin e pushtetit autonom në Kosovë. Në këtë kuptim me ndryshimet në Kushtetutën e Jugosllavisë të vitit 1974, Kosova që bërë element konstituitiv i Federatës jugosllave, duke fituar kompetenca shtesë ekonomike, politike dhe sociale. Me këtë kushtetutë Kosova kishte siguruar përfaqësim të drejtperdrejtë në organet federative. Sipas Kushtetutës të vitit 1974 (Neni 5, paragrafi 2 dhe 4), republikat dhe krahinat kanë mundur të ndryshojnë kufijtë administrativë vetëm pas miratimit në kuvendet republikane dhe krahinore, kështu që edhe për ndryshimin e kufijve administrativë të Kosovës është kërkuar miratimi i Kuvendit të KSA të Kosovës.

Në procesin e shpërbërjes së ish - Jugosllavisë, Komisioni i Badinterit të drejtën për shkëputje ua kishte dhënë vetëm republikave, por jo edhe krahinave autonome. Kjo njohje për shkëputje dhe pavarësim të republikave ishte kushtëzuar me respektimin e kufijve administrativë. Këtë të drejtë për pavarësim e ka shfrytëzuar edhe Kosova, së pari me Rezolutën 1244 dhe në vitin 2008 me shpalljen e pavarësisë në kufijtë e njëjtë administrativë si në rastin e njësive federative të tjera.

Aspekte gjeografike

Kosova gjendet në Ballkanin Perëndimor dhe kufizohet me Serbinë në veri dhe lindje, me Maqedoninë në jug, me Shqipërinë në perëndim dhe me Malin e Zi në perëndim dhe veriperëndim, ka popullësi prej 1,780,021 dhe zë vendin e 142 në botë sipas numrit të banorëve, me dendësi mesatare të popullësisë prej rreth 170 banorë në km². Indeksi i zhvillimit njerëzor vlerësohet në 0.733.

Gjeografia dhe gjeologjia na japin arsye thelbësore për të kuptuar rëndësinë historike dhe vazhdimësinë e Kosovës, veçanërisht për gjysmën lindore të saj. Ajo përmban përqendrim të madh të mineraleve sa e gjithë Europa Juglindore. CIA vlerëson se pasuritë më të mëdha natyrore të Kosovës janë nikeli, plumbi, zinku, magnezi, kromi dhe shumë minerale të tjera.

Kosova paraqet një hapësirë gjeografike heterogjene. Zona e fushëgropave përbën rreth 36,5% të sipërfaqes së tërësishme, ku dallohet Rrafshi i Kosovës (me lartësi mesatare prej 550 m), ai i Dukagjinit (me 330m), dhe luginat e lumenjve Llab, Kriva Rekë, Ibër dhe Morava e Sipërme. Rreth 37% të sipërfaqes së Kosovës i takojnë zonës malore, në pjesën perëndimore shtrihen Bjeshkët e Nemuna (maja Gjeravica, 2.656m), në jugperëndim shtrihet Sharri (maja Bistra, 2.640 m), kurse në anën veriore shtrihen Malet e Kopaonikut (2.000 m) dhe në anën jugore shtrihet Karadaku i Shkupit (1.650 m). Ndërmjet Kosovës dhe Dukagjinit shtrihet një zonë kodrinore-malore, e cila i ndan këto dy basene. Në përgjithësi, Kosova ka një klimë më kontinentale se Dukagjini. Në rajonet malore mbizotëron klima alpike.

Lumenjtë më të mëdhenj të Kosovës janë: Ibri, Drini i Bardhë, Lepenci, Sitnica dhe Morava e Binçës. Drini i Bardhë derdhet në Detin Adriatik, Ibri dhe Morava e Binçës në Detin e Zi, ndërsa Lepenci në Detin Egje. Liqenet artificiale janë: Gazivoda afër Mitrovicës, Batllava dhe Graçanica afër Prishtinës të cilat janë krijuar për nevojat e centraleve elektrike në Obiliq, për furnizimin e Prishtinës, Mitrovicës dhe të disa qendrave të tjera

• • • •



Harta 1. Harta e Kosovës
(jo e sakt sa i përket vijes së demarkacionit Kosovë – Mali i Zi)

Kosova ka një strukturë komplekse gjeologjike, me shkëmbinj magmatikë, sedimentarë dhe metamorfikë të të gjitha periudhave gjeologjike. Shtresat minerare të Kosovës kanë qenë të njohura qysh para 2.000 vjetësh. Ilirët, keltët dhe romakët këtu kanë nxjerrë plumb dhe argjend, në Kopaonik dhe në Karadak. Kosova në ish- Jugosllavi përmbante rezerva të mëdha të disa xeheve: 38% të thëngjillgurit, 56% të plumbit dhe zinkut, 47% të magnezit, 50% të nikelit. Trepça afër Mitrovicës është një nga minierat më të mëdha të zinkut dhe të plumbit në botë, kurse shtresat e linjtit shtrihen në Obiliq afër Prishtinës. Depozitimet e mëdha të linjtit, nxjerrja e tyre dhe përpunimi i energjisë elektrike në kuadër të ndërmarrjes “Kosova”, paraqesin një kombinat më të madh në vend, i cili ishte më i madhi në ish - Jugosllavi.¹

¹Musa Gashi; “Disa fakte mbi Kosovën”, 1997

Komuna e Pejës në kontekstin e demarkacionit²

Gjatë përcaktimit të vijes kufitare Kosovë – Mali i Zi në gjetësi mbi 60 km, më së shumti do të afektohet rajoni dhe qytetarët e Pejës, por edhe të Deçanit dhe të Istogut. Kjo nënkupton se përcaktimi i vijës kufitare do të reflektohet esencialisht në aspektet politike, ekonomike, demografike dhe etnike të këtyre komunave. Nga kjo rezulton se përcaktimi i kësaj vije kërkon që të mbështetet në argumentet shkencore, në faktet hartografike dhe në aspekte të tjera shoqërore dhe politike.

Komuna e Pejës shtrihet në skajin veriperëndimor të luginës së plleshme të Dukagjinit, para grykës pitoreske, nën shpatet e Alpeve Shqiptare. Peja, së bashku me tërë Rrafshin e Dukagjinit, shtrihet ndërmjet gjerësisë veriore gjeografike 45 - 50 shkallë dhe 42 - 53 shkallë dhe gjatësisë gjeografike lindore 19 shkallë, 58’ 30’ gjer më 21 shkallë.

Qyteti i Pejës është i vendosur në teracën neogjene aluviale në lartësi mbidetare 505 – 520 m. Ky qytet ngrihet në fushën e Rrafshit të Dukagjinit dhe rrëzë bjeshkëve të larta. Peja në pikëpamje gjeomorfologjike përbën një tërësi ekonomike dhe në vete ruan e kultivon traditë të një historie të lashtë. Peja lidhet me qarkullimin rrugor me Prishtinën, Mitrovicën, Gjakovën, Rozhajën e Plavën. Qyteti është i rrethuar me bjeshkët, që janë pjesë e masivit dinamik, që përfshin tërë Ballkanin Perëndimor. Këto bjeshkë formojnë një kurorë majesh të larta, siç janë: maja e Kopranikut (2460 m), Mali Zhlep (2352 m), Hajla (2460 m) Mokna (1932 m), malet e Lumbardhit gjegjësisht Guri i Verdhë (2522 m), maja e Viellakut (2012 m), Peklena, Maja e Hasanit etj.

• • • •

²Instituti për Studime të Avancuara GAP: " Letërnjoftimi i Komunës së Pejës 2013"; <https://www.rks-gov.net/sq-AL/Qytetaret/Shtetesia/Pages/Leternjoftimi.aspx>



Harta 2. Vija kufitare e pretenduar nga Mali i Zi dhe harta e komunës së Pejës e cunguar me Çakor dhe Kullë.

Lumi “Lumbardhi” fillon të gjarpërojë Fushës së Pejës, duke kaluar mesit të qytetit dhe duke e ndarë në dy pjesë. Lumbardhi i cili gjatë rrjedhjes formon fusha pjellore, derdhet në lumin më të madh të quajtur Drini i Bardhë, që buron nga Bjeshkët e Zhlepit në fshatin Radac. Lumbardhi ka një sasi uji prej 300 m - 3 në sekondë. Por malet e Pejës janë të pasura edhe me liqene, si: Liqeni i Neçinatit dhe Liqeni i Ridit. Vetitë klimatike të Dukagjinit, pra edhe të Pejës, karakterizohen me klimë të mesme kontinentale të modifikuar, me komponente të klimës mesdhetare.

Peja - Qendër rajonale e Dukagjinit verior, identike për nga numri i banorëve 181.130 banorë para fillimit të luftës, ka, po ashtu, të përfaqësuar mirë grupin terciaro - kuarter të popullatës, me të cilin qëndron para Prizrenit dhe e dyta pas Prishtinës, ndër qendrat kosovare me (32,6%). Dendësia e popullsisë është e madhe me rreth 300 banorë në 1 (një) km². nataliteti është 34, kurse mortaliteti 7. Peja është qendër e një rajoni të gjerë me (afro 1.500 km²), kurse Peja me fshatrat e saja ka 603 km². Brenda kufijve administrativë të Komunës së Pejës ka 97 vendbanime të organizuara në 28 bashkësi territoriale. Komuna e Pejës kufizohet me: Istogun, Klinën, dhe Deçanin. Ndërsa me Komunën e Plavës, të Beranës dhe të Rozhajës kufizohet me Malin e Zi. Territori i Komunës së Pejës përbehet nga dy tërësi gjeografike: njëra me klimë kontinentale të shprehur klimë mesdhetare që përfshin përafërsisht 30% të sipërfaqes së përgjithshme, dhe vargmalet e Alpeve Shqiptare në veriperëndim, me një rrjet hidrografik të zhvilluar, që ndikon si modifikim i klimës në këtë pjesë.

• • • •

Shqiptare në veriperëndim, me një rrjet hidrografik të zhvilluar, që ndikon si modifikim i klimës në këtë pjesë.

Përcaktimi i vijes së demarkacionit më së shumti do të ketë ndikim në vendbanimet e Rugovës dhe të fshatrave të Podgurit. Nëse demarkacioni mbështetet në argumentet shkencore dhe në fakte hartografike, duhet pritur se kjo do të ndikojë pozitivisht në bashkëpunimin ndërshtetëror dhe të komunave të Kosovës me ato të Malit të Zi.

Në aspektin e organizimit administrativ, jeta administrative në Rugovë, jeta administrative ka një historik të hershëm, por ne me këtë rast po përmendim një organizim të këtillë në kohën ndërmjet dy luftërave botërore e këtej. Komuna si njësi administrative ka ekzistuar në Kuqishtë qysh në kohën e administrimit (pushtimit) italian (1942), e më vonë, pas Luftës së Dytë Botërore, në kohën e regjimit komunist, Rugova kishte dy komuna: Komunën e Kuqishtës (1946 – 1957) me 6 fshata, kur kjo komunë suprimohet me Komunën e Drelajve dhe Komunën e Drelajve (1946 - 1966) me 7 fshata deri kur edhe kjo suprimohet me Komunën e Pejës dhe në Drelaj mbetet vetëm Zyra e Vendit). Këto vendime suprimuese kanë pasur efekte tejet negative ekonomike dhe demografike, respektivisht në depopullimin e këtyre vendbanimeve.

Të dhëna demografike të jetës në Rugovë

Ofrojmë disa të dhëna demografike të periudhës pas Luftës së Dytë Botërore në Rugovë. Statistikat e popullsisë janë të viteve 1981 dhe 1991.

	Numri i banorëve		(Vlerësim)
	Viti 1981	viti 1991	
1. Bogë	167	157	(230)
2. Drelaj	240	207	(79)
3. Dugaivë	251	24	(406)
4. Haxhaj	127	(s'ka statistikë)	
5. Koshutan	89	104	(316)
6. Kuqishtë (kuqlinë)	247	82	(496)
7. Llaz e Bellopaç	119	101	(110)
8. Malaj	73		
9. Pepiq	190	90	(239)
10. Rekë e Allagës me Llutovën	159	218	(66)
11. Stankaj	127	50	(190)
12. Shkrel	328	13	(273)
13. Shtupeq i Madh	184	274	(335)
14. Shtupeq i Vogël	303	56	(317)

Burimi: "RUGOVA - Mografi etnografike-", ASHAK(1987); Dr. Adem Hajdaraj: "E folmja e Rugovës" (1996)

Plani hapësinor i parkut nacional “Bjeshkët e Nemuna”

Kuvendi i Kosovës, në dhjetor të 2012-ës e miraton Ligjin për Parkun Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”³. me çka edhe hapet rruga për hartimin e planit hapësinor për këtë park (2015). Në Kosovë ky park shtrihet në komunat Istog, Pejë, Deçan, Junik dhe Gjakovë dhe ka një sipërfaqe prej 63028 hektarësh. Komunat kanë këtë pjesëmarrje në sipërfaqen e parkut nacional “Bjeshkët e Nemuna”: Istogu (8.1%), Peja (52.1%), Deçani (26.6%) dhe Juniku (8.4%).

Bjeshkët e Nemuna në Kosovë kanë një shtrirje në drejtim veri-jug me gjatësi 50 km dhe gjerësi 26 km. Në anën e Kosovës ngrihen nga fundi i fushës (500 - 600 m) dhe arrijnë lartësinë mbi 2000 m, në disa vende prehen nga lugina të thella lumore, të lumit të Bistricës (Lumbardhit) së Pejës, Deçanit, Erenikut dhe kanë si kufi jugor Drinin. Masivi malor i Bjeshkëve të Nemuna ndahet në tri pjesë:

Me dokumentin e Planit Hapësinor janë definuar orientimet kyçe hapësinore, në të cilin janë dhënë orientimet themelore në drejtim të mbrojtjes dhe të shfrytëzimit racional të Parkut. Plani hapësinor i parkut kombëtar “Bjeshkët e Nemuna” është dokument i cili duhet të promovojë interesat e përbashkëta të banorëve të Kosovës, për një zhvillim më të shpejtë ekonomik, me qëllim që të përmirësohet kualiteti i jetës, por njëkohësisht edhe të mbrohe resurset, trashëgimia natyrore dhe kulturore. Plani përcakton parimet dhe qëllimet afatgjata të planifikimit hapësinor për periudhën, të paktën, 10 - vjeçare, përcakton afatet kohore reale dhe implikimet buxhetore.⁴

Në hapësirën brenda parkut kombëtar “Bjeshkët e Nemuna” janë 20 vendbanime, kurse rreth parkut si vendbanime që kanë ndikim më të drejtpërdrejtë në park, janë 26. Vendbanimet brenda parkut janë vendbanime rurale – fshatra. Prej fshatrave brenda parkut, 16 shtrihen në territorin e Komunës së Pejës, 2 në Komunën e Junikut, 1 në Komunën e Deçanit dhe 1 në Komunën e Gjakovës. Sa u përket vendbanimeve rreth parkut, 11 ndodhen në Komunën e Pejës, 8 në Komunën e Deçanit, 4 në Komunën e Istogut, 2 në Komunën e Gjakovës dhe 1 në Komunën e Junikut. Vendbanimet brenda parkut. Këto vendbanime kanë dallime të theksuara sa i përket numrit të popullsisë. Vendbanimi me numër më të madh të popullsisë është Maja e Zezë me 234 banorë, apo me 49.1 % të numrit të përgjithshëm të popullsisë së këtyre vendbanimeve.⁵

• • • •

³Bjeshkët e Nemuna si identifikim gjeografik është adaptuar nga thirrja “Prokletije” që është falsifikim historiografik i futur nga Cvijiq

⁴Instituti për Planifikim Hapësinor , Parku Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”

⁵Njëjt



Vendbanimet brenda Parkut shtrihen në lartësi të mëdha mbidetare: Malaj (1925m), Pepiq (1813m), Koshutan (1708m) dhe Bogë (1610m). Popullsia e këtij rajoni është e shpërndarë në gjithsej 47 vendbanime (20 prej tyre janë brenda kufirit të parkut, ndërsa 27 të tjera janë jashtë parkut kombëtar "Bjeshkët e Nemuna"), në pesë komuna.

Numri i popullsisë në këtë rajon është 878.006. Numri i popullsisë është shtuar për 48.872 banorë, nga 38.928 banorë sa kishte në vitin 1948 në 87800 banorë në vitin 2011. banorë. Popullsia aktive. Popullsia aktive paraqet një element tjetër demografik që ka rëndësi të veçantë në zhvillimin shoqëroro - ekonomik të një vendi.

Harta 3. Sipërfaqja e Perkut Nacional "Bjeshkët e Nemuna" (Burimi; Instituti për Planifikim Hapësinor, Parku Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna")

Nga përshkrimi i indikatorëve hapësinorë, natyrorë, demografikë dhe ekonomikë vërehet se ky projekt është i ekspozuar nga përcaktimi i vijës së demarkacionit Kosovë – Mali i Zi, duke pasur parasysh se në anën perëndimore ky park shtrihet deri në kufirin me Malin e Zi. Kjo do të thotë se vija e demarkacionit e propozuar në mes Kosovës dhe Malit të Zi, do ta rrezikonte esenacialisht hapësirën e projektit të parkut nacional "Bjeshkët e Nemuna."

Bazuar në hartat e ofruara dhe jo mirë të punuara si dhe nga mospërfundimi i mirë i demarkacionit, MMPH – ja, nuk i është përmbajtur vijës reale, duke pretenduar në zyrtarizimn e saj. Kjo gjë jo vetëm që sjell pasoja në zbatimin e ligjit mbi Parkun Nacional, por do të ketë pasoja edhe në versionin final të demarkacionit në dëm të Kosovës.

Prof. Dr. Zejnullah Gruda⁶

**2.ASPEKTE NDËRKOMBËTARE TË DEMARKACIONIT:
MËSIMET PËR RASTIN E KOSOVËS**

*Konteksti ndërkombëtar dhe
ex - jugosllav i demarkacionit⁷*

Kohën e fundit është hapur një debat i gjerë rreth shënimit të vijës kufitare në mes Kosovës dhe Malit të Zi. Kjo procedurë në gjuhën diplomatike dhe të së drejtës ndërkombëtare njihet me termin demarkacion. Zyrtarët e Kosovës e kanë përmendur Kushtetutën e Kosovës të vitit 1974 si bazë për shënimin e vijës kufitare me këtë shtet fqinj, por edhe Marrëveshjen e Kumanovës, të nënshkruar në vitin 1999 në mes forcave serbe dhe forcave të NATO - s dhe dokumentin e Ahtisarit, në bazë të të cilit është themeluar shteti i Kosovës. Sipas tyre, këto dokumente përbëjnë kuadrin normativ për demarkacion. Opozita në Mal të Zi propozoi që shënimi i vijës kufitare midis Kosovës dhe Malit të Zi të bëhet sipas ndarjes së vendosur nga Serbia dhe Mali i Zi gjatë luftërave imperialiste Ballkanike nga viti 1912 / 1913, ku lumi Drin do të duhej të bënte kufirin midis dy shteteve, që d.m.th. se një pjesë e Dukagjinit me Pejën, Deçanin dhe Gjakovën do të duhej t'i jepej Malit të Zi.

Si do të ndodhë ky shënim i vijës kufitare me malazeztë. Sipas Komisionit të Badinterit kufijtë administrativë midis njësive federale shndërrohen në kufij ndërkombëtarë dhe asnjë ndryshim i kufijve me dhunë nuk mund të prodhojë pasoja juridike. Kjo ishte përgjigjja e Komisionit të Badinterit në pyetjen e Serbisë se “a janë vijat e demarkacionit të brendshëm midis Kroacisë dhe Serbisë, dhe midis Serbisë dhe Bosnjë e Hercegovinës, kufij në kuptimin e së drejtës ndërkombëtare”? Pra e vetmja gjë që ka mbetur e hapur ishte të vërtetohej saktë se ku kanë qenë kufijtë administrativë.

• • • •

⁶Profesor i së drejtës ndërkombëtare, ambasador i ish - Jugosllavisë në Panama dhe ish - anëtar i Këshillit Ekzekutiv dhe Sekretar Krahinor për Marrëdhënie me Botën e Jashtme (1978 - 1981).

⁷Tekst i punuar nga autori në bazë të intervistës të dhënë për “Express Magazinë”, qershor 2015

Zhbërja e shteteve dhe vijat kufitare

Problemi i ndarjes së suksesorëve (trashigimtarëve) të shteteve që shthurren, çfarë është edhe rasti i Jugosllavisë, tërheq shumë çështje serioze ku ndarja e territorit midis pasardhësve (trashëgimtarëve) përbën çështjen më të ndjeshme. Rrjedhimisht, çështja e parë që imponohet është se mbi çfarë parimi ose mbi çfarë baze do të bëhet ndarja territoriale? Në rastet e mëparshme (më të vjetra) janë përdorur disa parime. Ndër to, në të drejtën ndërkombëtare, më i njohuri është parimi “uti possidetis” që është përdorur në rastin e pavarësimit të popujve të Amerikës Latine që ishin kryesisht koloni të Spanjës dhe Portugalisë. Atëherë, me qëllim që t’i evitonin konfliktet midis trashëgimtarëve lidhur me territoret, ata kanë zbatuar parimin “uti possidetis 1810” që d.m.th., se vijat administrative që kanë ekzistuar brenda kontinentit latino-amerikan nga Kolumbia deri në Argjentinë, që i kishin vendosur spanjollët, do të shndërrohen në kufij ndërshtetërorë të shteteve të posaçliruara. Ky kriter më vonë si “uti possidetis 1821” është marrë dhe është zbatuar edhe për Amerikën Qendrore. Ky parim është zbatuar edhe me rastin e pavarësimit të popujve të Afrikës. Kështu, vijat administrative koloniale që kanë ekzistuar janë shndërruar në kufij ndërshtetërorë të shteteve të posaçliruara.

Në rastin e shthurjes së Jugosllavisë, në ndarje rol të rëndësishëm ka pasur Komisioni i Badinterit. Sipas Komisionit parimi “Uti possidetis” njihet sot si “parim i përgjithshëm” dhe “logjikisht është i lidhur me fenomenin e pavarësisë, kurdo që ajo ndodh.” Sipas tij, në rast të pavarësimit të republikave që e kanë përbërë Jugosllavinë, ndarja do të bëhet me kufij që kanë ekzistuar midis njësive federale si kufij administrativë, të cilët janë vendosur dhe kanë ekzistuar nga fundi i Luftës së Dytë Botërore deri në vitet 1991, 1992. Kushtetuta e RSFJ-së e vitit 1974 vetëm përcaktonte se territori i republikave dhe krahinave që e përbënin atë, është i përkufizuar me “kufij” që nuk kanë mundur të ndryshohen pa pëlqimin e Republikës ose të Krahinës Autonome (Neni 5, paragr. 2 dhe 4). Kushtetuta përdorte fjalën “kufij” tekstualisht (në serbokroatisht “granice”) për vijat që ndanin njësitë konstitutive të Federatës, dhe nuk bënte dallim midis republikave dhe krahinave.

• • • •

Pikënisje viti 1945

Sipas kësaj, ndarja territoriale midis njësive federale që është vendosur gjatë dhe menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore, është dashur të shërbejë si kriter themelor për përcaktimin e territorit të të gjithë trashëgimtarëve të RSF të Jugosllavisë. Natyrisht, ajo që është kërkuar nga shtetet suksesore (trashëgimtare) është të pranojnë që ndryshim të kufijve nuk do të ketë. Bashkimi European gjithashtu ka përsëritur se të gjitha shtetet dhe popujt që pretendojnë të pavarësohen nga Jugosllavia, duhet të pranojnë faktin se nuk do të ketë ndryshim kufijsh. Ata kufij që janë, i pëlqyen apo nuk i pëlqyen, “iu qofshin për hair.” Madje, kjo ka qenë kusht për njohje ndërkombëtare. Prandaj, shtetet që pretendojnë të fitojnë njohjen, duhet të reflektojnë në përputhje me këtë. Pra respektimi i parimit uti possidetis 1945 nuk është çështje diskrecionale, por imponohet si çështje imperative dhe për këtë nuk mund të ketë pazare. Përkundrazi, duhet ditur dhe pranuar se s’ka ndryshim të dhunshëm të kufijve, gjë që natyrisht nuk përjashton mundësinë që kufijtë të ndryshohen me marrëveshje ndërkombëtare, diçka që është e pranuar me të gjitha rregullat e së drejtës ndërkombëtare. Definitivisht, është thënë fare qartë se ndryshim të kufijve me dhunë nuk mund të ketë: atë që keni pasur ose zotuar, atë duhet ta keni. Nga kjo del se nuk ka mundur të vihet në diskutim e drejta e Kosovës që ky parim të zbatohet edhe ndaj saj, pavarësisht nga qëndrimi joparimor i Komisionit të Badinterit, me të cilin krahinat (Vojvodina dhe Kosova) ishin përjashtuar nga e drejta e vetëvendosjes, që në esencë ishte shprehje e qëndrimit proserb të Francës dhe presidentit të saj, Francois Mitterand, por edhe rezultat i shantazhit brutal të Serbisë dhe qëndrimit kapitulues të bashkësisë ndërkombëtare.

Prandaj, kur diskutohet çështja e demarkacionit me Malin e Zi domosdo imponohet nevoja për sqarimin dhe argumentimin e ndarjeve të atëhershme. Personalisht, si individ kam qenë kureshtar lidhur me çështjen e demarkacionit me Malin e Zi, por edhe më tepër i brengosur, kur kam parë për afërsisht një kilometër prej Kuqishtës një piramide betoni, e që i bie një 5 apo 6 kilometra nën Çakorr, që nuk përkonte jo vetëm me parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare por as me ato që unë di nga historia.

Për të qenë më i qartë duhet theksuar se në praktikë kufijtë më së shpeshti caktohen sipas relievit (vargmaleve) ose kanë ndonjë mbështetje në faktorë të tjerë gjeografikë (lumenj, kanale, ngushtica). I këtillë është kufiri Francë-Itali (Alpet), Francë-Spanjë (Pirinejet), Kinë - Indi (Himalajet), Kinë - Rusi (lumi Usuri), Iran-Irak (Shat – el - Arab) etj. Kjo vlen për kufijtë ndërkombëtarë, të cilët më së shumti i kanë dashur shtetet, për të cilat janë angazhuar dhe kanë luftuar (po përmend vetëm përpjekjet franceze për vendosjen e kufirit me Gjermaninë në lumin Rin). Unë besoj se në rastin e Kosovës ky kriter është

përdorur historikisht. Rrjedhimisht, sipas këtij kriteri ndarja midis Malit të Zi dhe Kosovës ka shkuar qafës që lidh majat më të larta të vargmaleve, ku Çakorri dhe Qafa e Diellit janë pika dhe vija ujëndarëse. Kështu, ujërat që shkojnë në drejtim të Plavës, shkojnë në lumin Lim, prej Limit shkojnë në Drinë, prej Drinës shkojnë në Savë, prej Savës shkojnë në Danub dhe derdhen në Detin e Zi, d.m.th., krijojnë një tërësi hidrologjike. Çakorri dhe Qafa e Diellit, prej nga shtrihet pamja në Liqenin e Plavës, në Guci, ishin kufij natyrorë. Këto kanë qenë, me sa di unë, dhe me sa pohohet shprehimisht nga Gjilasi, vija administrative kufitare që kanë ndarë Kosovën nga Mali i Zi. Dhe kjo del shumë qartë nga deklarata e Gjilasit dhënë në janar të vitit 1993 ku në pyetjen “kush ka marrë vendim për krijimin e Krahinës dhe kush i ka caktuar kufijtë”? Milovan Gjilas (njëri nga sekretarët e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Jugosllavisë para, gjatë dhe pas Luftës dhe në atë kohë kryetar i Kuvendit Popullor të Jugosllavisë) ishte përgjigjur: “Nuk ka ndonjë vendim të veçantë dhe askush nuk përcakton kufij.” Qysh krijohet pushteti nga komitetet partiake dhe shtabet ushtarake, njashtu edhe vendosen kufijtë. S’ka as mbledhje e as dokument që këto kanë përcaktuar.” Në pyetjen plotësuese: pse për kufirin midis Kroacisë dhe Vojvodinës ka të dhëna si është caktuar, Gjilasi është përgjigjur se atje çështja ka qenë kontestuese, kurse këtu kjo s’ka qenë rasti.

• • • •

Idetë e Luftërave Ballkanike

Gjilasi tregonte se janë zhvilluar biseda midis Malit të Zi dhe Serbisë, që Malit të Zi t’i jepet pjesa të cilën e ka pasur më 1912, d.m.th., ana e djathtë e lumit Drin (Peja, Deçani dhe Gjakova). Diçka e tillë vërtetohet nga procesverbali i mbledhjes së pestë të Kryesisë së AVNOJ - it të mbajtur më 24 shkurt 1945 lidhur me zgjidhjen e çështjes së statusit të Sanxhakut, në të cilën Marko Vujaçiq kishte kërkuar që “Kosova e Metohia duhet t’i jepet Malit të Zi, sepse Metohia historikisht është malazeze.” Atëherë ky propozim ishte kundërshtuar nga Eduard Kardeli (nënkryetar i Komitetit Nacional të Çlirimit të Jugosllavisë) me arsyetim se çështja e Kosovës dhe Metohisë “as nuk është në rend të ditës e as nuk ka ardhur koha që për atë të diskutohet.”

Sipas pohimit të Gjilasit atëherë “kufiri ka mbetur në Çakorr”, por me vërejtje se kësaj çështjeje nuk i është kushtuar kujdes i veçantë, “sepse në perspektivë ka qenë bashkimi me Shqipërinë.” Ajo që përmendet si kontestuese është pylli “Vaganica”, që e shfrytëzonin fshatarët e Velikës (rrethi i Andrievicës), për të cilin fshatarët e Hagjajve

(Adjovica), rrethi i Pejës, pohonin se duhet t'u takojë atyre, “për shkak se u është marrë padrejtësisht në kohën e Jugosllavisë së vjetër me vendim të Gjykatës së Madhe në Podgoricë në vitin 1931.”

Qëndrimi parimor mbi cedimin eventual Shqipërisë të viseve të banuara me shqiptarë haset edhe në Dokumentin mbi kufijtë Shtetërorë (Elaboratin) që Bozhidar Maslariq (luftëtar i Spanjës) dhe Velko Vlahoviq (luftëtar i Spanjës dhe njëri ndër udhëheqësit më të dalluar të Jugosllavisë gjatë dhe pas Luftës së Dytë Botërore) ia kishin dërguar Kryetarit të Komitetit Nacional të Çlirimit të Jugosllavisë, mareshalit Tito, më 25 .IX. 1945, e diç më parë edhe Litvinovit (funksionar i Lartë i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Bashkimit Sovjetik), ku lidhur me kufijtë me Shqipërinë shkruanin: *“Mund të ndodhë që Jugosllavia e re federative, në rast se krijohet shteti demokratik shqiptar, do të duhet të veprojë në drejtim të korrigjimit të kufijve në favor të Shqipërisë dhe cedimit (dhënies) të rajoneve në të cilat jeton popullsia kompakte shqiptare”,* pra të atyre territoreve të banuara tërësisht me shqiptarë e që Jugosllavia i kishte fituar me Paqen e Versajës, dhe ndaj të cilëve *“regjimet reaksionare jugosllave zbatonin politikën e shpërnguljes dhe të zhdukjes së asaj popullsie shqiptare dhe përmes kolonizimit të dhunshëm, arrinin të shtonin përqindjen e popullsisë serbe përgjatë kufirit jugosllavo-shqiptar.”* Këto janë ato që dihen për kufirin e atëhershëm dhe këto lehtë mund të vërtetohen.

Fatkeqësisht, idetë për gllabërimin e pjesëve të Kosovës, që përmendëm më sipër, janë aktualizuar sërish në Serbi gjatë viteve të nëntëdhjeta të shekullit XX përmes përpjekjeve për “ridefinimin e territorit të Kosovës dhe Metohisë” e, tash së voni, edhe në Malin e Zi nga ekstremistë të ndryshëm.

Prandaj, duke u nisur nga rëndësia e madhe që ka çështja, çdo diskutim serioz duhet nisur nga historia, sepse, fatkeqësisht, shumë të dhëna nuk dihen, ose dihen shumë sipërfaqësisht. Personalisht, si individ kam kërkuar (pa sukses) nga disa persona, mes të cilëve edhe zyrtarë, të provojnë të sigurojnë ose të gjejnë të dhënat se si është vendosur në atë kohë për ndarjet në tërë hapësirën e Jugosllavisë. Dhe këtë e kam bërë, përkundër faktit se kjo është detyrë, para së gjithash, e organeve shtetërore e jo e individëve ose e “shpirtrave të shqetësuar.” Por, në mungesë të studimeve të mirëfillta dhe të bëra në mënyrë institucionale, e vetmja përgjigje e mundshme janë reagimet personale ose grupe të individëve ose të partive që artikulojnë interesat e komuniteteve. Ky shkrim, si dhe prononcimi i përmendur, duhet kuptuar kështu.

Kushtetuta e vitit 1974 në kontekstin e kufijve administrative

Kushtetuta e vitit '74 vetëm thotë se Kosova i ka kufijtë e vet dhe kufijtë e Kosovës nuk mund të ndryshohen pa pëlqimin e Parlamentit të Kosovës. Ky parim vlenë edhe për të gjitha njësitë konstitutive të Federatës jugosllave. Kushtetuta federative dhe kushtetutat e njësive federale nuk përcaktojnë ku janë kufijtë, sepse nisen nga supozimi se ata dihen ose janë të njohur. Sipas kësaj, janë vijat administrative që janë vendosur në përfundim ose menjëherë pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore. Ato vija të përcaktuara pas Luftës së Dytë Botërore kanë vazhduar të ekzistojnë edhe më pastaj, pra edhe gjatë viteve të shtatëdhjeta, kohë të cilës i referohen pjesëmarrësit tanë në procesin e demarkacionit. Por, ndryshe nga ç'thonë këta, edhe në vitin 1945, edhe gjatë viteve të '70 - ta, kufiri i Kosovës me Malin e Zi ka qenë në Çakorr, në Qafë të Diellit dhe në Kullë, si kufi historik (që e vërteton qind për qind deklarata e Gjilasit, i cili ka qenë personi më i rëndësishëm në këtë proces), por edhe hartat që mund t'i konsultojë kushdo qoftë pa mund të madh. Mjafton këtu me përmendë se harta e Malit të Zi, që e përmban Enciklopedia e Përgjithshme e Entit Leksikografik të Kroacisë, e botuar në Zagreb në vitin 1977 e ka Bjelluhën brenda Kosovës (Opca Enciklopedija Jugoslovenskog Leksikografskog Zavoda 2, Zagreb 1977, fq. 137), prandaj ata që nuk e njohin këtë territor, respektivisht që nuk e kanë parë dhe nuk e dinë, është mirë t'iu përkujtohet se distanca nga Bjelluha deri në majë të Çakorrit në asnjë rast nuk mund të jetë një kilometër vijë ajrore. E, Enciklopedia e përmendur, është ndoshta botimi më reprezentativ që ka pasur Jugosllavia, përgatitja e së cilës është bërë me kritere më rigorozë profesionale, shkencore e pse jo edhe politike. Prandaj, është e paimagjinueshme që dikush mund ta vërë në dyshim saktësinë e asaj harte.

Ky kufi ka mbështetje të fortë në faktorët gjeografiko - natyrorë, sepse nga aty ujërat e Bistricës së Pejës dhe të Bistricës së Deçanit, bashkë me Drinin, krijojnë një pellg ujqor deri në derdhje në Detin Adriatik, pra krijojnë një tërësi hidrologjike. Si e këtillë kjo vijë përbën kufirin strategjik, hidrologjik dhe etnik, që mund të vërtetohet lehtë, po të shikohen pellgjet e lumenjve (Dri dhe Lim) dhe struktura kombëtare e vendbanimeve (Velikë - Rugovë) etj.

Kjo është ajo që nuk mund të vihet në diskutim. Prandaj, përfundimi i parë dhe më i rëndësishëm është se çfarëdo shmangieje nga vija e Çakorrit, Qafa e Diellit, Kulla etj., jo vetëm që nuk ka mbështetje në faktorë gjeografikë, hidrologjikë, në histori, në parimin etnik, në arsye ekonomike, në arsye strategjike, por, përkundrazi, përbën shkelje të vrazhdë të të gjitha parimeve progresive dhe rregullave elementare të së drejtës ndërkombëtare, dhe s'janë gjë tjetër pos vazhdim i politikave gllabëruese të qarqeve imperialiste të fqinjëve.

• • • •

Rëndësia e dokumenteve për gjykime të drejta

Çështja më e rëndësishme lidhur me demarkacionin nuk janë njerëzit e interesuar drejtpërsëdrejti (sado që edhe këta mund të jenë të rëndësishëm sidomos po që se për përkatësinë e territorit vendoset me plebishit). Këtu duhet shikuar dokumentet. Si individ, kam qenë i interesuar profesionalisht, por edhe shumë më tepër si qytetar i këtij shteti, që të siguroj një pasqyrë të plotë mbi rrjedhën e demarkacionit ose për të plotësuar informacionet që kam pasur. Kam sugjeruar, kurdo që më është dhënë rasti, të kërkoj të dhëna që i kontribuojnë trajtimit adekuat të çështjes, i vetëdijshëm se kjo nuk është punë imja as e individëve si unë. Kjo është punë e atyre që e kanë mandatin.

Atyre iu takon të dinë: a ka dokumente që trajtojnë këto çështje, çfarë janë ato dokumente, ç’përmbajtje kanë, çfarë peshe kanë, a janë në pajtim me të drejtën, a janë të besueshme, a janë objektive etj. Ta zëmë, për çështjen e demarkacionit është e rëndësishme çka thotë Gjilasi për shkak të pozitës që ka pasur, autoritetit që ka gëzuar dhe rolit që ka luajtur në caktimin e vijave administrative e jo ndonjë i ngratë që e ka problemin e kullosave, të pyllit, të pronës private. Tekefundit, problemi i demarkacionit s’është problem i pronave private, por i ndarjes së sovraniteteve.

Vendosja e kufijve nuk e përjashton se edhe ndonjë shtetas yni e edhe ndonjë shtetas i Malit të Zi të kenë pronën përtej kufirit. Në ato raste, normalisht, lidhen marrëveshje ndërshtetërore, me të cilat rregullohet statusi i pronave përtej kufirit. Shtetet mund të vendosin t’i blejnë, t’i ndërrojnë ose të vendosin një sistem të posaçëm të shfrytëzimit të tyre përmes sigurimit të lejeve për pronarët që të shkojnë, p.sh., gjatë ditës prej orës 6 të mëngjesit deri në orën 6 pasdite ta punojnë tokën, t’i marrin frutat etj., dhe me kaq kjo merr fund!

• • • •

Rastet e fërkimeve të mëdha lidhur me demarkacionin

Tëra këto janë thënë për të treguar sa më qartë se problemi i demarkacionit është ndër problemet më të rëndësishme, më të rënda dhe më të ndjeshme. Dhe kjo s’është vetëm këtu, por çdo herë, dhe çdo kund në botë. Unë mund të përmend shumë shembuj që e ilustrojnë këtë, por do të kufizohem në dy ose tri raste.

Kështu, në fund të viteve të ’60 Bashkimi Sovjetik dhe Kina janë grindur për një Ishull të pabanuar në lumin kufitar Usuri, sipërfaqja e të cilit ka qenë më pak se një kilometër

katror, që e përdornin blegtorët për të kullotur bagëtinë. Ky ishull që përmytet në kohën e nivelit të lartë të ujit, ishte bërë arsye e fërkimeve të mëdha midis BRSS, që kishte një sipërfaqe prej afro 22 milionë kilometra katrorë dhe RP të Kinës, që kishte më se 9.5 milionë kilometra katrorë, duke hapur perspektivën e një konflikti me përmasa të mëdha ose madje të një lufte bërthamore. Konflikti është zgjidhur vetëm në vitin 1991. BRSS është pajtuar që ishulli t'i takojë Kinës.

Edhe Egjipti dhe Izraeli janë shtyrë afro 20 vjet për Taba (nja 600 metra breg në Detin e Kuq, ku Izraeli kishte ndërtuar një hotel pas okupimit të Sinajit në vitin 1967).

Pas tërheqjes së Izraelit nga Sinai, ky kompleks është shndërruar në kontest të rëndë, deri kur Komisioni i arbitrazhit ka vendosur (më 1988) që ky territor t'i takojë Egjiptit. Atëherë rojet kufitare izraelite janë tërhequr afro 50 metra nga vendi ku kanë qenë.

• • • •

Rasti i Shqipërisë dhe Greqisë

Rasti i demarkacionit të fundit të detit midis Shqipërisë dhe Greqisë meriton me u përmendë për disa arsye, sepse ai tregon sesi nuk duhet vepruar. Ç'është e vërteta, Marrëveshja shqiptaro-greke nuk ka hyrë në fuqi falë një vendimi të Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë, që e kishte bërë të pamundur ratifikimin e saj. Por jashtë kësaj, ky episod ka lënë shije të hidhur jo vetëm pse pala greke kërkon që Marrëveshja të finalizohet dhe të aplikohet (Jorgos Papandreu, Venizelos), por për shkak të lehtësisë marramendëse me të cilën disa iu qasen punëve publike.

Me këtë Shqipëria ishte vënë në një pozitë të rëndë, sepse grekët kanë nga pak të drejtë kur thonë se shpresojnë që marrëveshja të finalizohet (pra presin finalizimin e saj nga Shqipëria ashtu si është ose me ndonjë ndryshim kozmetik) dhe të realizohet, sepse Shqipëria e ka nënshkruar; shqiptarët gjithashtu kanë të drejtë të refuzojnë ratifikimin e marrëveshjes nëse e konsiderojnë të dëmshme për interesat shtetërore dhe shkel rregullat e së drejtës ndërkombëtare për ndarje të hapësirave ujore ose nënujore. Përndryshe, çfarë kuptimi do të kishte ratifikimi i marrëveshjeve!

Por jashtë kësaj mbetet të diskutohet sesi ka mundur me ndodhë diçka e tillë? Normalisht llogaritet se kurdo që jeni në pozitë të merrni obligime, nuk keni për t'u vënë në lajthim ose, mos o zot, për t'u mashtruar. Për këtë arsye pozitë publike iu besohen personave të kualifikuar, të ndershëm etj. Por meqenëse edhe këta nuk mund t'i dinë të gjitha,

rregullisht marrin me vete këshilltarë, ekspertë, e, në rastet e caktuara, konsultojnë ekspertë të veçantë ose ndonjë institut.

Duke vepruar kështu, zvogëlohet ose përjashtohet mundësia e lajthitjes, rrjedhimisht nuk do të mund të ndodhte që të flitet se janë humbur 354 kilometra të fundit të detit. Fatkeqësisht, kjo ka kaluar sikurse të mos kishte ndodhur asgjë. Në shtete normale personat përgjegjës për këso veprimesh do të përjashtoheshin definitivisht prej politikës, nëse nuk do të pësonin diçka më të rëndë. Por pasojat më të rënda mbesin t'i bartë populli, e kjo është ajo më e keqja!

• • • •

Rasti i Kroacisë dhe Serbisë

Këtij grupi i takon edhe kontesti në mes Kroacisë dhe Serbisë lidhur me kufirin në Danub, ku kufiri i tyre kalon nja 140 herë prej njërit breg, në tjetrin, varësisht prej pronave që kanë kroatët në lindje ose serbët në perëndim. Sipas të dhënave kroatët kanë dyfish më shumë toka në lindje të Danubit, sesa kanë serbët në perëndim të Danubit, prandaj kroatët angazhohen për kufij sipas kadastrës, ndërsa Serbia angazhohet për një zgjidhje që aplikohet rregullisht në raste kur kufiri shkon lumenjve. Në këto raste ku lumi është i lundrueshëm kriter për ndarje merret vija ku lumi është më i thellë (talveg). Në këtë situatë, një ish-ministër i punëve të jashtme të Kroacisë (Mate Graniq) një herë kishte propozuar që çështja të zgjidhet në mes dy shteteve, e nëse kjo del e pamundshme, duhet drejtuar arbitrazhit. Kjo duket se ka mbetur si opsion edhe për Prevlakën në mes Malit të Zi dhe Kroacisë.

Personalisht mendoj se nëse Kosova nuk fiton njohje për qëndrimet e shpalosura më lart, duhet t'i drejtohet arbitrazhit!

• • • •

Prof. dr. Riza Smaka

Delimitacioni dhe demarkacioni kufitar ndërmjet Kosovës, Malit të Zi dhe Serbisë

Abstrakti

Çështja e delimitacioneve dhe e demarkacioneve ndërshtetërore, kurdoherë ishte dhe, gjithnjë mbetet temë delikate, sensitive dhe me rëndësi sociale, ekonomike, politike, historike, kulturore, tradicionale dhe emocionale; në anën tjetër, tematika e delimitacioneve dhe e demarkacioneve kufitare, në përgjithsi e, veçanërisht në dimensione ndërshtetërore, reflekton ndjenja të vetekzistencës, të vetëmbrojtjes dhe të vetëvërtetimit!

Objeti i Punimit konsiston në trajtimin e delimitacioneve dhe të demarkacioneve ndërkufitare kosovare me shtetet fqinje, në radhë të parë me Malin e Zi e, ca më vonë, edhe me Serbinë.

Qëllimi i punimit konsiston në analizën kritike të kriterëve dhe të parimeve të së Drejtës Ndërkombëtare Publike në funksion të përkufizimeve të drejta e të qëndrueshme ndërmjet vendeve të sipërpërmendura.

Metoda të përdorura gjatë përgatitjes së këtij punimi, kryesisht, janë analizat kritike të teksteve të shkruara, krahasimi me raste të delimitacioneve dhe demarkacioneve të ngjashme dhe deduksioni, përkatësisht, konkludimi.

Hipotezë preliminare e Punimit është presumimi i ekzistimit të kufijve formalë - administrativë ndërmjet shteteve në fjalë, të cilët, në parim, do të justifikoheshin të trajtoheshin kufij realë me rektifikacione reciprokisht të balancuara e të pranuar!

Terma kyçe: shtete fqinje Kosova, Mali i Zi, Serbia; kufijtë ndërshtetërorë; delimitacioni dhe demarkacioni kufitar!

Kufijtë e Kosovës me Sistemin Kushtetues të YU II (1945 – 1992), sipas të cilit kufijtë ndërmjet Kosovës, Malit të Zi dhe Serbisë ishin të delimituar dhe të demarkuar qartë dhe të garantuar e të sanksionuar edhe me randin juridik të atij shteti të përbashkët.

Qeveria e Kosovës duhet ta prezantojë për debatim e miratim Projektin e Marrëveshjes për Delimitimin e Demarkimin e Kufirit ndërmjet Kosovës dhe Malit të Zi e, mëpastaj, edhe ndërmjet saj e Serbisë dhe, vijimisht, pas akordit bilateral, të emërojë përbërjen e anëtarëve kosovarë në Komisionin Mikst Kosovar – Malazias për Demarkacion Kufitar! Ekzekutivi i Kosovës gjatë kësaj periudhe duhet t'i përfillë dispozitat e neneve 17 dhe 18 të Kushtetutës, në mënyrë që, ndër të tjera, Marrëveshjen Kosovare - Malaziasë e më pastaj Kosovare - Serbe për Delimitimin dhe Demarkacionin Kufitar, t'ia prezantojë Kuvendit të Kosovës për ratifikim!

Çështja e delimitacioneve dhe e demarkacioneve ndërshtetërore, kurdoherë ishte dhe, gjithnjë, mbetet temë delikate, sensitive dhe me rëndësi sociale, ekonomike, politike, historike, kulturore, tradicionale dhe emocionale; në anën tjetër tematika e delimitacioneve dhe e demarkacioneve kufitare, në përgjithësi e, veçanërisht, në dimensione ndërshtetërore, reflekton ndjenja të vetekzistencës, të vetëmbrojtjes dhe të vetëvërtetimit!

• • • •

Kufijtë shtetërorë dhe demarkacioni kufitar

Kufiri shtetëror është vija që i ndan territoret e shteteve fqinje përbrenda të cilave shtrihet sovraniteti i tyre.

Në rrethanat normale, gjatë delimitacioneve dhe demarkacioneve kufitare ndërshtetërore përfillen këto parime:

Përderisa territori shtetëror përbrenda vijave kufitare përcakton integritetin shtetëror, ushtrimi i pushtetit shtetëror në atë territor reflekton dhe krijon sovranitetin shtetëror! Integriteti shtetëror, pos përreth shtetit të caktuar, delimitohet edhe në linjen vertikale në dimensione të delimituara sipas standardeve dhe parimeve juridike ndërkombëtare. Kufijtë shtetërorë, zakonisht, përcaktohen me kontrata – marrëveshje për paqen, përkatësisht, me marrëveshje ndërshtetërore. Në raste të caktuara, kufijtë shtetërorë përcaktohen me aktgjykim të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë apo të gjykatës së caktuar të arbitrazhit.

- ***i kufijve natyrorë të determinuar nga konfiguracioni territorial, ujëndarjet dhe ujërëniet, vargmalet;***
- ***i kufijve strategjikë të determinuar nga faktorët në favorin e mbrojtjes së shtetit të caktuar;***
- ***i kufijve historikë;***
- ***i kufijve etnikë;***
- ***i kufijve etnikë të balancuar.***

Kufijtë shtetërorë markohen me piramida apo shenja dallues të standardizuar të përcaktuar nga komisionet mikste ndërshtetërore. Shtetet, sipas legjisllacioneve të veta dhe standardeve ndërkombëtare, i përcaktojnë dhe i delimitojnë zonat kufitare dhe regjimet e tyre.

• • • •

Demarkacioni shtetëror

Demarkacioni trajtohet në aspektin: (a). ushtarak – teknik dhe (b), kufizimin ndërshtetëror të përkohshëm deri në përcaktimin e kufijve finalë me kontratë – marrëveshje ndërshtetërore (ndërkombëtare). Demarkacioni ushtarak – teknik, zakonisht, përcaktohet nga autoritetet ushtarake të autorizuar të palëve nderluftuese dhe ka karakter të përkohshëm, i cili kërkohet të përfillet nga entitetet në relacione të ndersjella, ndryshe, shkaktohet shkelja e arritur e paqes së përkohshme!

Vija e demarkacionit tërhiqet edhe ndërmjet aleatëve në territore të pushtuara për t'i identifikuar zonat e okupuara, sikundër ishte rasti (pas Luftës së Dytë Botërore, në vitin 1945) me Gjermaninë dhe Austrinë, përkatësisht me Gjermaninë. Ka edhe raste në të cilat linja e përkohshme e demarkacionit ndërmjet dy shteteve, që në ndërkohë është shndërruar në delimitim ndërshtetëror virtuelisht përfundimtar, çfarë ishte situata e ndarjes së Koresë nëpërmjet paraleles 38 në dy shtete, madje tejet antagoniste edhe në aktualitet!

Në rast të marrëveshjes për paqen, vija e demarkacionit, në parim, mbetet e pandryshuar, por e përkohshme deri në delimitimin definitiv kufitar - nga komisioni mikst për kufizimin ndërshtetëror! Përcaktimi i linjes së demarkacionit nuk e tërheq humbjen as fitimin e sovranitetit shtetëror, kështu që ato attribute realizohen nëpërmjet delimitacionit definitiv të kufijve shtetërorë!

Linjat e demarkacionit, gjithnjë të padelimituara, do të duhej të përfilleshin konform me:

- *Kontratat – marrëveshjet ndërmejt palëve,*
- *Konceptet juridike bashkëkohore dhe me*
- *Deklaratën e OKB - së për Parimet e të Drejtës Ndërkombëtare për Marrëdhëniet Miqësore ndërmjet shteteve në mënyrën e përcaktuar me Kartën e OKB - së – rez .2625 - XXV të Asamblesë së Përgjithshme!*
- • • •

Delimitacioni dhe demarkacioni shtetëror

Delimitacioni shtetëror, në aspektin juridik – formal, është raport juridik – ndërshtetëror (ndërkombëtar), ndërsa në pikëpamjen juridike – materiale është shteti i delimituar me kufij ndërkombëtarisht të njohur përbrenda të cilëve e ushtron pushtetin shtetëror! Për njohje ndërkombëtare të kufijve shtetërorë, nder të tjera, kërkohet *Condictio Sine Qua Non*, njohja e tyre nga shtetet respektive!

Kufijtë shtetërorë, fillimisht, kërkohet të delimitohen me kontratë – marrëveshje ndërshtetërore (ndërkombëtare) e rrjedhimisht të demarkohen nga komisioni mikst nga shtetet respektive!

Përderisa kontrata - marrëveshja ndërshtetërore duhet të përmbajë vullnetin politik ndërshtetëror të harmonizuar për delimitacionet kufitare, t'i përshkruajë linjat kufitare *Grosso Modo* dhe të mbështetet në të dhënat nga terreni, të skicuara në elaborate e harta adekuatë e të qarta, demarkacioni bëhet, rrjedhimisht, në sajë të asaj marrëveshjeje dhe të markimeve të quotave e trigonometrave konkrete në terren!

Së këndejmi, delimitimet ndërshtetërore (kosovare, malaziasë e serbe) duhet të bëhen, fillimisht, me marrëveshje ndërshtetërore e, rrjedhimisht, me delimitacione reale në terren!

- *Botëkuptimet akademike e bashkëkohore të së drejtës ndërkombëtare publike,*
- *Deklaratën e OKB - së për Parimet e së Drejtës Ndërkombëtare për Marrëdhëniet Miqësore Ndërmjet Shteteve,*
- *Kartën e OKB - së referuar përfilljes Bona Fidei të kufijve ndërshtetërorë,*
- *Parimin natyror duke i përfillur konfiguracionet tokësore ndërkufitare, rrjedhat e lumenjve, ujërrjedhat dhe ujëndarjet, quatat dhe trigonometrat më të dalluar,*
- *Parimin strategjik reciprok,*
- *Parimin historik,*
- *Parimin etnik,*
- *Parimin etnik të balancuar si dhe,*
- *Duke u pikënisur dhe mbështetur në kufijtë e Kosovës me Sistemin Kushtetues të YU II (1945 – 1992), sipas të cilit kufijtë ndërmjet Kosovës, Malit të Zi dhe Serbisë ishin të delimituar dhe të demarkuar qartë dhe të garantuar dhe të sanksionuar edhe me Randin Juridik të atij shteti të përbashkët!*

Qeveria e Kosovës duhet t'ia prezantojë për debatim e miratim Projektin e Marrëveshjes për Delimitimin e Demarkimin e Kufirit ndërmjet Kosovës dhe Malit të Zi e, pastaj edhe ndërmjet saj e Serbisë dhe, vijimisht, pas akordit bilateral, të emërojë përbërjen e anëtarëve kosovarë në Komisionin Mikst Kosovar - Malazias për Demarkacion Kufitar!

Qeveria e Kosovës gjatë kësaj periudhe duhet t'i përfillë dispozitat e neneve 17 dhe 18 të Kushtetutës, në mënyrë që, ndër të tjera, Marrëveshjen Kosovare - Malaziasë e më pastaj Kosovare - Serbe për Delimitimin dhe Demarkacionin Kufitar t'ia prezantojë Kuvendit të Kosovës për ratifikim!

• • • •

Prof. dr. Muharem Cërabregu:
3.ASPEKTE GJEOGRAFIKE DHE HARTOGRAFIKE
TË DEMARKACIONIT

Parimet e përgjithshme dhe të veçanta në përcaktimin e kufijve shtetërorë të Republikës së Kosovës

Analiza e temës në fjale ka për bazë dy terma primarë: termin demarkacion dhe hinterland.

Definicioni i termit demarkacion në pikëpamje logjike dhe gjeografike, ka të bëjë me shqyrimin e vijës kufitare mes dy shteteve të pavarura. Biseda zhvillohet sipas metodës analistike të gjeografisë ushtarake. Me vijën e demarkacionit përcatohen definitivisht kufijtë ose kufijtë mes shteteve. kurrizet e maleve që ndajnë rrjedhat burimore të Drinit të Bardhë me rrjedhat e epërme të Limit dhe të Ibrit.

Definicioni i termit hinterland⁸ ka të bëjë me viset që gravitojnë në një qendër metropolitike ose qendër kulturore, në rastin tonë malësitë e Pejës. Duke filluar nga Qafa e Pejës (në shkrepat e Karanfilit), Plava dhe Gucia, Morina dhe Sanxhaku.

Ky aspekt ka të bëjë me gjeografinë historike: hartat e vjetra, së paku me shqyrtimin e Enciklopedisë së Jugosllavisë të botuar në fillim të viteve 1950, ku gjenden hartat topografike 1:100.000. Pastaj atlasit me format të librit të rëndomtë të titulluar Gjeografia Ushtarake të botuar rreth viti 1960, ku ekzistojnë kufijtë e republikave dhe të krahinave. Vijat kufitare shtetërore përcillen me komente tekstuale. Gjithsesi, ketu duhet pasur parasysh hartat e Enciklopedisë së Jugosllavisë të botuar nga Enti i Enciklopedisë në Zagreb.

• • • •

⁸Më përgjithësisht hinterlandi i refren hapësirat rurale ekonomikisht të lidhura me përkatësi të një qendre urbane, të qyteteve të mëdha ose të aglomeracioneve. Mashësia e hinterlandit varë nga gjeografia, por edhe nga lehtësia, shpejtësia dhe me koston e transportit. Nga shfrytëzimi ekonomik analog, termi "hinderland" i referohet hapësirës së tregut.

Transhumansa Ilire

Dy terma: ngjitja dhe zhdjergja: Transhumansa është bartje sezonale e banorëve, bagetive të fshatrave të caktuar në bjeshkët e tyre të përhershme duke u ngjitur në verë dhe duke u zhdjergur në dimër. Dalja në bjeshkë dhe ardhja në fshat është traditë qysh në kohët më të vjetra në Gadishullin e Ilirisë. Edhe familjet mbretërore ilire kanë dalë në bjeshkë. Duhet të përmendet se familja mbretërore e Teutës nga Kotori - Agronium, ka dalë në Bjeshket e Kelmendit. Në Bjeshkën e Jenegut (pjesa e eperme e lumit të Bistricës), ka kullë (e një familjeje të Carrabregut), shtëpi dhe stane.

Ndër ne shqiptarët kullotat malore thirren thjesht bjeshkë. Kurse, hartografët e shekullit XIX këto bjeshkë i identifikojnë me emrin e banorëve. Bjeshkët Shqiptare (Albanian Alps: alp = bjeshkë).

“Fina Lana del Albania” feaza Venedikase dhe Raguziane (Leshi i kualitetit të lartë shqiptar), vjen nga Malësia e Pejës deponohej në magazinat e qytetit. Qilimi shqiptar (Albanian carpet) po ashtu i kualitetit të lartë dhe të njohur ndër tregetarët e Perandorisë Otomane dhe qytete në shtete të Mediteranit, punoheshin në Pejë. Siç shihet definicionet e termave të lartpërmendur kanë të bëjnë me koncepte me madhësi të ndryshme hapësinore.

• • • •



Figura 1. Vija kufitare e pretenduar ndanë Liqenin e Leçinatit në dy pjesë (absurde)

Kjo analizë gjeografike bazohet në Hartën topografike të seksionuar të Pejës e publikuar në Enciklopedinë e Republikës Popullore të Jugosllavisë, botuar në vitin 1962. Në shikim të parë të vijës kufitare në mes Kosovës dhe Malit të Zi, në hartë sugjerohen këto aspekte gjeografike:

- *Fizike,*
- *Transhumanca,*
- *Vendbanimet e përkohshme / stanet,*
- *Vendbanimet e përhershme / kullat,*
- *Emrat gjeografikë,*
- *Dokumentacioni hartografik,*
- *Ekonomia,*
- *Etnografia,*
- *Administrimi e të tjera.*

Demarkacioni është një term i sofistikuar multidimensional. Në vijim duhet të sqarohet dhe të zhvillohet tema.




Fig. 2. Pamje e masivit malor që është objekt i vijës së demarkacionit

Valorizimi i hartës

Sipas çfarëdo standardi të kriterëve, në esencë është një produkt i kriterëve natyrale dhe logjike të demarkacionit. Në fakt, ajo ka qasje të një logjike të thjeshtë: malet, majat dhe kurrizet në mes tyre që janë të akvatorëve (ujëmbledhësve) të Drinit të Bardhë. Vija kufitare fillon në Lindje të Majës së Shpatit (2.207 m) dhe prej nga shkon në drejtim të Veriut përgjatë kurrizit që ndan pjesën e Epërme të Bistricës së Pejës duke përfshirë disa bjeshkë edhe të Jelenkut duke arritur te maja më e lartë e Lumbardhit / Starac (2.476 m). Nga këtu vija kufitare ndryshon pak drejtimin nga perëndimi duke arritur në Qafen e Çakorrit (1.854 m), nga ku del kroji rrjedhja e të cilit nga lindja përbën origjinën perëndimore të Bistricës së Pejës. Nga kjo qafë vija kufitare vazhdon në drejtim të veriut duke lënë nga ana e djathtë Malin e Vogël (2.077 m), prej nga vazhdon kah veriu duke arritur në Majën Usovishte (1.932 m).


Nga këtu vija kufitare ndryshon drejtimin nga verilindja përgjatë kurrizit të malit Mokna duke mbërritur pikën te Maja e Dremidollit (2.119 m). Nga këtu vazhdon përgjatë kurrizit të Hajlës / Maja e Hajlës (2.400 m) dhe e Shtedit (2.272 m). Nga këtu drejtimi ndryshon kah verilindja nëpër bjeshkën e Dubovikut prej nga shkon në veri duke lënë në të djathtë malin e Zhlebit (1.501 m). Nga këtu vija kufitare vazhdon kah lindja mbi Rozhajë duke ndarë akvatorin verior të Drinit të Bardhë me atë të Ibrit.

Vija kufitare në këtë hartë zyrtare është në demarkacion normal, që duhet të merret parasysh si bazë e besueshme për demarkacionin definitiv për çfarë është duke u bërë fjalë.



Harta 4. Harta e vendbanimeve dhe kvotave malore me kufi real (Burimi; Enciklopedija NR Jugoslavije, Naklada Leksikografski Zavod FNRJ, Zagreb 1962)

PEĆ



Harta 5. Harta fiziko – gjeografike me kufi real (Burimi; Enciklopedija NR Jugoslavije, Naklada Leksikografski Zavod FNRJ, Zagreb 1962)

Drejtësi në balance: Shkenca e demarkacionit

Duhet të theksohet se përfaqësuesit e Kosovës asnjëherë nuk kanë marrë pjesë në vendimmarrje në shekullin XX lidhur me përcaktimin e vijave kufitare. Kjo është një praktikë ilegale dhe joetike e qeverive të mëparshme, thjesht për shkak se Kosova ka qenë territor i okupuar. Një hulumtim i dokumentacionit hartografik i zbulon këto padrejtësi duke përfshirë rolin e kësaj teme në periudhën e pasluftës së dytë botërore. Në rastin e demarkacionit të Kosovës, nuk gjen zbatim një standard i arsyeshëm për demarkacion, por vetëm manipulimi i shkencës. Demarkacioni thjesht do të thotë “fiksime të vijës kufitare në mes dy shteteve”, që do të thotë fokusim i kësaj teme. Pra, ky është interpretimi i definicionit të demarkacionit sipas parimit të drejtë. Ballafaqimin e civilizimeve në Raportin e Komisionit, personalisht e konsideroj si ballafaqim të qytetërimeve. Bota gjeodezike dhe bota shkencore mbështeten në logjikën të ndryshme sa i përket demarkacionit në fjalë.

Mesazhi i dhënë nga komisioni është i qartë si kristali: shkencëtarët të rrinë në shtëpi. Meqenëse metoda e tyre nuk kërkon të vërtetën relative e as absolute, çka do të thotë se “neve nuk i duam bjeshkët tona.” Dhe kjo është e kundërshtueshme jo vetëm nga banorët, por edhe nga njerëzit e arsyes.

Kriteri i pronësisë

Imponimi i vijës kufitare me kriter të pronësisë nuk ekziston fare në çështjen e demarkacionit ndërshtetëror. Ky kriter nuk është primar ose sekondar dhe aspak në demarkacionet ndërkombëtare.

Duhet të theksohet se faktori kosovar, kurrë nuk është konsultuar për caktimin e vijës kufitare të vendit. Kjo ka qenë si pasojë e kushteve okupuese dhe gjenociduese të ushtruar nga dominuesit. Prandaj kufijtë ekzistues të Kosovës janë arbitrare dhe se Kosova është e cingëruar.

Meqë biseda është me temën e demarkacionit, atëherë duhet t'i përmbahem konceptit të termit, që ka të bëjë me specializues të problemit. Në rastin tonë kjo duhet t'i jetë adresuar një komisioni adekuat ndërkombëtar të nivelit të KB-së ose të Bashkësisë Europiane që nënkupton edhe NATO - s.

Impakti ekonomik dhe demografik i okupimit të bjeshkëve si pasojë e ndalimit të daljes në bjeshkë qysh nga viti 1981

Okupimi i bjeshkeve qysh nga viti 1981 nga grupet e armatosura të sigurimit malazez, shkaktoi shkatërrimin e transhumanses tradicionale ilire, duke shkaktuar pasoja të rënda ekonomike për dukagjinast. Me këtë okupim, njëkohësisht u muar hapësira jetësore e vendësve. Qysh nga viti i përmendur më lart i okupimit, kullosat bjeshkore mbetën të shkreta. Ato mbetën të zbrazëta nga barinjët dhe bagëtitë. Për këtë mungesë nuk ekzitonte ndonjë alternativë e kompensimit të kësaj humbjeje.

Tëbanishtet si dhe tëbanet mbetën të vetmuara, torishtat dhe kullosat mbetën të shkretëruara. Udhët dhe shtigjet e bagëtive nëpër kullotat i ka mbuluar bari. Me këtë u zhduk prodhimi i leshit të cilësisë së lartë që eksportohej në Venedik, Raguzë, dhe në pjesë të tjera të Europës dhe të Perandorisë otomane.

Prodhimi i bylmetit bjeshkor, i djathit, e mazës nuk gjenden më. Shkatërrimi ekonomik dhe demografik është humbje e madhe për banorët vendës të lidhur me aktivitetet bjeshkore. Në Çarshinë e Pejës u zhduk Lama e leshit dhe Lama e qylymave. Nuk ka më prodhime të zhgunit dhe të plisave që ishin veshje tradicionale ilire qysh nga kohët klasike. Kështu një ekonomi vitale mijëravjeçare u shua.



Fig. 3. Pamje e Bjeshkëve të Rugovës

Si pasojë emigrimi i dukagjinasve u shtua shpejt dhe me hov, meqë aktivitetet ekonomike bjeshkore u zhdukën. Duhet të theksohet se pas shumë mijëra vitesh, ringjallja e hordhive barbare e bëjnë këtë shkatërrim në fund të shekullit XX. Pra, çfarëdo lloj demarkacioni i imponuar nuk i përgjigjet zgjidhjes së këtyre problemeve ekonomike dhe demografike. Para së gjithash, ringjallja e bjeshkeve dhe e Rrafshit të Dukagjinit, mund të bëhet vetëm me tërheqjen e vijës së demarkacionit që determinohet nga majat dhe kurrizet prej nga rrjedhin degët burimore të Drinit të Bardhë (Që në hartat e vjetra shpesh e hasim në identifikimin gjeografik Drini shqiptar). Integriteti i degëve burimore të Drinit të Bardhë është i paprekshëm me çfarëdo kriteri ndërkombëtar të demarkacionit.

• • • •

Pozita gjeografike dhe gjeostrategjike e Kosovës

Pushteti jugosllav në vitin 1959 kishte bërë ndryshime, respektivisht këmbime territoriale në mes Kosovës dhe Serbisë, me synim që të krijoheshin balanse të reja demografike dhe strategjike. Kështu në këtë vit, pa konsultime me palën kosovare, Leposaviçi, Leshaku dhe Zubib-Potoku i bashkohen Kosovës, ndërsa nga Kosova shkëputet dhe i bashkohet Serbisë Lugina e Preshevës (Medvegja, Bujanoci dhe Presheva). Përderisa veriu i Kosovës ishte i populluar 100 % me popullatë serbe, Kosova Lindore banohej kryesisht me shqiptarë. Me pikën strategjike të Leposaviqit, bëhet ndërprerja e lidhjeve dhe e komunikacionit në mes Europës dhe Lindjes së Aferme (Vjenë - Zagreb – Banja Llukë - Sarajevë - Vishegrad - Mitrovicë - Prishtinë - Shkup - Selanik. Bashkimi i Kosovës së Lindjes me Serbinë kishte për qëllim që shqiptarët të mos i bllokonin korridoret e Serbisë në drejtim të Maqedonisë dhe të Greqisë. Mbanin nën kontroll të gjitha pikat strategjike (Bjelluha, Leposaviqi, Mitrovica, Kosova e Lindjes). Si synim kishin ekspansionin pansllav.

Pikë tejet strategjike mbetet edhe bjeshka e Bjelluhës, e cila në hartat e vitit 1958 dhe të publikuara zyrtarisht në Encikolpedinë e Jugosllavisë të vitit 1962 ishte brenda territorit të Kosovës. Tani Mali i Zi pretendon pikërisht në këtë pikë strategjike, e cila nëpërmjet Qafes së Diellit, Pejën e lidh me Plavën dhe Gucinë të banuara me shqiptarë.

Kosova me një sipërfaqe relativisht të vogël, shtrihet në brendësi të Gadishullit Ilirik. Sipërfaqja e saj gjason me një rrafshlartë të rrethuar me male, ku janë gërshetuar vendburimet e degëve të Drinit të Bardhë, që shkon në drejtim të jugut në Adriatik. Pastaj të lumit të Limit (e Drinës), Ibri (Moravës Perëndimore) dhe të asaj jugore që shkon në Detin e Zi. Kah jugu rrjedh Lepenci, që nëpërmes Vardarit del në Egje. Ky gërshetim i vendburimeve që rrjedhin në drejtime të kundërta, ishte edhe problemi i hartografimit ndër shekuj, që u zgjidh nga mesi i shekullit të 19-të të topografeve Austro - Hungarezë, kur edhe prodhohet harta e parë topografike e territorit kosovar në shkallën 1:200.000.

Pikat gjeostrategjike të Kosovës

Ato janë të rangut më të lartë, që lidhen me Europën Qendrore dhe me Mediteranin. Pika e parë strategjike është Mitrovica nga duhej të vazhdonte Projekti i Hekurudhës së shekullit të 19-të, nga Europa Qendrore (Vjena) për në Lindjen e Aferme nëpërmes Stanbollit. Kjo pikë gjeostrategjike e Mitrovicës është bllokuar në vitin 1959, kur territorit kosovar i është shtuar Komuna e Leposaviqit për të forcuar zhvillimin e kolonive të Zveçanit dhe të Mitrovicës Veriore. Nga ana tjetër Kosova Lindore (Medvegja, Ternovci, Presheva) është pika e dytë gjeostrategjike kosovare, nga kalon magjistralla e Europës Qendrore për Selanik, i është marrë territorit kosovar, me çka është eliminuar faktori shqiptar me rol kyç. Akademiku Ivo Andriq, që më vonë e fitoi çmimin Nobël në programin e tij “Dëbimi i shqiptarëve”, në mënyrë specifike i referohej hapësirës së Moravës jugore si pikë me rëndësi gjeostrategjike e që është e banuar nga shqiptarët. Ai thotë se për hir të sigurimit të komunikacionit, duhet të bëhet spastrimi etnik nga shqiptarët, për çka duhet të merret aprovimi nga Anglia, gjë që do të arrihej me vështirësi. Kjo do të thotë se Rusia dhe Franca nuk do të paraqesin ndonjë problem!

Pika e tretë gjeostrategjike e Kosovës lidhet me bllokimin e komunikimit kryesor të Kosovës me krahinat perëndimore të Bjeshkëve Shqiptare. Kjo pikë është Bjelluha në qendër të Bjeshkëve tona, që është pikë e gravitimit të Plavës e Gucisë e më tej nëpërmes Qafës së Diellit për në Pejë. Me këtë pikë lidhet edhe komunikimi i Zetës nëpërmes Qafës së Çakorit për në Pejë. Kjo pikë e komunikacionit, tani po i merret Kosovës.

Përcaktimi i vijes së demarkacionit lidhet edhe me gjeo - linguistik. Si shifet, vija e demarkacionit se pari i takon kriterit gjeo - strategjik e pastaj te asaj natyror, historik, etnografik etj.

Përparësitë e hartës së Enciklopedisë së botuar në vitin 1962, gjë që është kyç i temës sonë:

- *Kjo hartë është produkt i zvogëlimit fotografik të hartave topografike me shkallë më të madhe, ku ruhen detajet.*
- *Ajo ofron një pamje të rëndësishme të vijës së demarkacionit në mes Kosovës dhe Malit të Zi.*
- *Harta (Enciklopedia) është shpërndarë në bibliotekat kryesore të botës.*
- *Harta është një shembull që tregon se ka pasur kohëra kur vijat e demarkacionit kanë qenë të qarta dhe reale..*
- *Meqë kjo hartë është botuar nga një institucion prestigjioz federal në një projekt kaq të madh.*
- *Vlera e hartës shumëfishohet dhe mbetet e përhershme për shkak të attributeve të lartpërmendura.*
- *Bashkëngjitja e hartave topografike me shkallë më të madhe të kohës, është një suplliment që plotëson përmbajtjen e temës së demarkacionit në fjalë.*
- *Duhet theksuar se metoda e përparshme e aplikimit të qasjes ndaj demarkacionit është joadekuate.*
- *Shumë biseda në lidhje me demarkacionin me një terminologji joekzistente, janë amatore dhe jashtë kontekstit të demarkacionit të vërtetë.*
- *Është absurd që asnjë anëtar i Komisionit nuk është ekspert, as që ka fare experiencë të demarkacionit ndërkombëtar. Madje asnjë prej tyre nuk është nga rajoni që të kenë njohuri të bjeshtëve përkatëse.*

Konkluzioni

Prandaj, çfarë demarkacioni duhet të kemi? Tërheqja e vijës me përshkrim të kualitetit të vijës natyrore sipas një ecurie reale duhet të kuptohet koncepti i përgjithshëm i demarkacionit, me ç'rast duhet të merret parasysh një demarkacion i mëparshëm që përputhet me kriterin e vijës kufitare, në rastin tonë harta e botuar në Enciklopedinë e Jugosllavisë të viti 1962. Kjo pikënisje ndihmon zbulimin e specifikës së temës. Pra, demarkacioni e ka metodën e vet të analizës dhe të sintetizimit në këso rastesh konkrete si ajo në mes shtetit të Kosovës dhe shtetit të Malit të Zi.

Duhet theksuar se majat si pika dhe korrizet si vija të ndarjeve ujore janë determinuar për një demarkacion të natyrshëm. Mbi të gjitha vendbanimet sezonale dhe të përhershme si dhe etnike dhe etnografike, kurorëzohen në vijën e demarkacionit të natyrshëm.

Mbajtja nën kontroll e të gjitha pikave strategjike (Bjelluha, Leposaviqi, Mitrovica, Kosova e Lindjes). Për synim kishin ekspansionin pansllav. Edhe tani gjatë demarkacionit Kosovë

Mali i Zi dhe i demarkacionit të ardhshëm Kosovë – Serbi, do të manifestohen tendenca të tilla ekspansioniste.

Prof. dr. Florim Isufi & Prof .dr. Shpejtim Bulliqi

Të dhëna hartografike mbi kufirin Kosovë - Mali i Zi

Një ndër problemet më të vështira për vendet e dala nga lufta është përcaktimi i drejtë i vijës kufitare me shtetet fqinje. Ky përcaktim në të shumtën e rasteve bëhet me marrëveshje ndërshtetërore, ku protagonistë janë komisionet e formuara nga qeveritë për të përgatitur projektpropozimet finale.

Tendencë e qeverive është formimi i komisioneve profesionale në mënyrë që raporti final të jetë i saktë, i pranueshëm dhe jo i kontestueshëm nga institucionet qeveritare dhe joqeveritare, si dhe opinionin në përgjithësi e me theks të veçantë për banorët lokalë (të brezit kufitar). Shpesh herë ndodh që për shkaqe të panjohura në komisione të mos emërohen njerëzit adekuatë dhe me njohuri të mira gjeohapësinore dhe hartografike. Në raste të tilla lindin probleme të cilat mund të rrezikojnë kredibilitetin e komisionit, si dhe mos pajtueshmëri me raportin final, e që mund të manifestohet edhe me probleme tjera deri te mos pajtueshmëri qytetare dhe refuzimi i solucionit final.

Duke parë diskutimet e vazhdueshme të shoqëruara edhe me shqetësime të vazhdueshme të opinionit kosovar, të qytetarëve si dhe të shoqërisë civile, i është kushtuar vëmendje analizës dhe përpunimit shkencor të problemit të përcaktimit të kufirit Kosovë - Mal i Zi. Me qëllim që ky hulumtim yni të sjellë rezultate të sakta, të vërtetuara shkencërisht dhe të paanshme, jemi mbështetur në dy objektiva kryesorë:

1. Në karakterin shkencor gjeografik, morfohidrologjik e hartografik;
2. Në mosndikim nga politika ditore që do të ndikonin në vërtetësinë e rezultateve.

Këta dy objektiva lehtësuan punën tonë në grumbullimin dhe analizën e të dhënave shkencore gjeografike, morfologjike, hartografike dhe tekstuale së bashku me vizitat në terren për të detektuar pozitat e sakta të pikave dhe të vijës kufitare.


Që rezultati të jetë shkencërisht i pranueshëm dhe i qartë, janë përdorur edhe metodat tradicionale shpesh të përdorshme në rastet e demarkacionit kufitar. Së pari është bërë mbledhja e materialit hartografik (i hartave topografike) sidomos i hartave të cilat kanë të paraqitur vijat kufitare të njësive të atëhershme administrative brenda ish-Jugosllavisë. Gjithnjë është bërë përpjekje që të sigurohen hartat zyrtare që përfaqësojnë (janë produkt) institucionesh të autorizuar për përpilimin e tyre.

Puna në terren ka ndihmuar në identifikimin e problemeve fiziko-gjeografike – me theks të veçantë mbi ato morfohidrologjike si një nga metodologjitë më të preferuara në demarkacionet kufitare, sidomos në vendet me vlera e parametra të copëtimit relievor dhe me rrjetë të qartë hidrik.

Metoda kohore-historike ka ndihmuar që të përcillet kontinuiteti historik, kohor i paraqitjes së vijës kufitare në mënyrë që të gjenden defektet e mundshme në krijimin e paqartësive, gjithmonë duke u bazuar në vërtetësinë e të dhënave primare dhe duke i vënë në korrelacion me burimin e të dhënave sekondare.

**Hartat
topografike**

**Elementet
Fiziko-**



Vazhdimësia

Analiza

Që të kemi një pasqyre më të saktë dhe më të pranueshme të mënyrës së përcaktimit të vijës kufitare, jemi bazuar në definicionet e dhëna në fjalorët më eminentë ndërkombëtarë. Nga këto definicione mund të nxirret përfundim i përbashkët se: **Kufiri** nuk është asgjë tjetër veç vija që ndan dy tërësi mes tyre. Vija zyrtare që ndan dy vendet, shtetet, rajonet ose tersitë. Vijë tokësore apo detare që ndan dy shtete fqinje (fjalori drejtshkrimore, Rilindja 1981). E kjo në rastin tonë do të thotë se **Kufiri** është vijë e padukshme, që ndan shtetet e pavarura Kosovë - Mali I Zi.

Megenëse sipërfaqja e tokës nuk është uniforme (e njëtrajtshme) edhe vijat kufitare në rruzullin tokësor nuk janë të përcaktuara me metoda të njëjta dhe uniforme. Varësisht nga kushtet fiziko - gjeografike dhe koha e përcaktimit, vija kufitare në mes dy njësive territoriale mund të jetë:

Kufi natyror

Kufij të cilët janë të determinuar nga kushtet morfologjike, hidrike, funksionale, historike, socio-gjeografike etj. Këta kufij janë të vendosur përgjatë vargmaleve, grykave, maleve-ujendarësve, lumenjve, liqeneve, kanaleve, shkretëtirave, shkëputjeve tektonike etj. (p.sh. Pirinejet mes Francës dhe Spanjës, Lumi Rio Grande mes SHBA dhe Meksikës etj.).

Kufi etnik – social

Kufijtë të cilët janë të determinuar nga elementet kulturore dhe sociale të hapësirave të caktuara. Këta kufij ndajnë territore sipas gjuhës, religjionit, racës etj. Këto lloje të kufijve janë më të pakët dhe shpesh janë përcjellë me probleme ndërkufitare. Këto lloje të kufijve i gjemë sidomos në vendet e lindjes se afërme dhe të mesme, disa vende afrikane etj.

Kufi gjeometrik

Këto lloje të kufijve janë të vendosur me marrëveshje ndërshtetërore dhe në hapësirat ku kushtet fiziko - gjeografike (relievi dhe hidrografia) nuk janë lehtë të identifikuar dhe mundësojnë përshkrim detal. Këto lloje të kufijve janë vija të drejta apo harkore të cilat në shumicën e rasteve përcjellin meridianët apo paralelet. Kufi të tillë gjemë në mes shumë shtete në Afrikë etj.

Kufi relikt

Janë kufij të dikurshëm që më vonë shuhen dhe nuk ekzistojnë. Kryesisht janë kufij të cilët shkrihen me bashkimin e territoreve. P.sh. kufiri mes Gjermanisë Perëndimore dhe lindore.

Gjatë analizave kronologjike të kufijve në mes shteteve të Ballkanit dhe të Kosovës me shtetet fqinje, është konstatuar se asnjëri nga kufijtë nuk prezanton plotësisht kufi etno - social. Nga kjo mund të përfundojmë se në Gadishullin Ballkanik, pas përfundimit të Luftës II Botërore nuk ka dominuar ideja e krijimit të kufijve etnikë, e si rrjedhojë e tillë në shumicën e rasteve janë të bazuar në aspektin morfohidrologjik me theks të veçantë në konturat e morfologjisë së terrenit, me ç'rast janë krijuar kufij natyrorë.

Në këtë kontekst malet periferike, ujëndarëset dhe pëllgjet lumore kanë luajtur rolin kyç në përcaktimin e kufijve të Kosovës. Duke u bazuar në këtë dhe pas shpërbërjes së Jugosllavisë e sidomos pas luftës së fundit në Kosovë, u shpreh interesimi i madh mbi diskutimin për kufijtë e Kosovës me shtetet fqinje, gjithnjë duke tentuar që të arrihet një solucion sa më i pranueshëm. Analizat mbi këto aktivitete nxjerrin përfundime se në shumicën e rasteve propozimet dhe diskutimet nuk bazoheshin në fakte shkencore po më tepër prezantonin opinione personale të bazuara në faktografi dhe në metodologji të paqartë dhe të pakuptueshme. Pavarësisht nga kjo gjithë ky aktivitet mbi kufijtë e Kosovës pas vitit 1999 ka në vete dy komponentë të rëndësishëm e që duhet pasur për bazë gjetjen e solucionit adekuat. Aktivitetet e zhvilluara deri më sot lidhur me problematikën e kufijve të Kosovës me vendet fqinje, në vete kanë pasur këto dy anë të medaljes:

<i>Anët negative</i>	<i>Anët Pozitive</i>
1. Vonesat e vendosjes së kufijve shtetërorë dhe aspekti shkencor i qasjes 2. Mosekzistimi i një entiteti që merrej me probleme gjeohapësinore 3. Mosharmonizim detyrash mes shkencës, politikës vendimmarrëse dhe opinionit të gjerë në lidhje me demarkacionin e kufirit Kosovë - Mali i Zi	1. Njohja e mirë e çështjes nga disa anëtarë të komisionit shtetërorë 2. Aspekti natyror morfohidrologjik I terrenit, 3. Dokumentacioni i mjaftueshëm i shfrytëzimit dhe lehtësia në qasje etj. 4. Materiali i mjaftueshëm gjeohapësinor e hartografik real që lehtëson punën rreth demarkacionit

Në Kosovë vonë është krijuar Universiteti i Prishtinës, i cili ka nxjerrë kuadro të përgatitur me arsim të lartë e të cilët janë marrë me këtë problematikë. Ekspertët e parë me njohuri hartografike dhe gjeohapësinore janë nga fundi i viteve të 60 - ta dhe fillimi i viteve të 70 - ta të shekullit të kaluar, prandaj edhe kontributi i tyre në qartësimin e kufijve në mes njësive administrative duhet kërkuar nga kjo kohë duke u bazuar në publikimet shkencore dhe në raportet e ndryshme të punuara me tematika të ndryshme.

Gjatë hulumtimit është konstatuar se për kufi të Kosovës u vendos menjëherë pas Luftës II Botërore, shumë më parë se formimi i Universitetit të Prishtinës. Nga kjo rrjedhimisht mund të thuhet se që nga ajo kohë e deri në luftën e fundit, për kufijtë e Kosovës, por edhe të njësive të tjera të ish-Jugosllavisë, janë përkujdesur institucionet e ndryshme relevante të kohës. Deri në pavarësinë e Kosovës (2007) me një problematikë të tillë në të shumtën e rasteve janë marrë organizatat ndërkombëtare e që shpesh kanë përfunduar pa ndonjë rezultat adekuat dhe shkencërisht të pranueshëm. Kësaj mund t'i shtohet edhe problemi institucional që me vite të tëra e përcjell Kosovën.

Në këtë kontekst në Kosovë nuk ekziston një entitet, i cili do të merrej me çështje gjeografike, hartografike dhe gjeohapësinore për interes shtetëror, ku produktet e tyre do të jenë të bazuara në fakte shkencore dhe kredibile e të pranua nga opinioni vendor dhe ndërkombëtar. Padyshim ka pasur tendenca të ndryshme dhe të shpeshta të formimit të institucioneve të tilla, por në shumicën e rasteve të paplanifikuara mirë apo edhe jo shumë bindëse për institucionet vendore dhe ndërkombëtare. Në vitin 2004 për herë të parë është bërë propozimi i krijimit të një entiteti të tillë me emrin MIS - Sistemi i Informatave Ministrore, në MTPT të asaj kohe. Përkundër prezantimit detaj me përshkrim të detyrave dhe të obligimeve të qarta e me skemë organizative funksionale, ky propozim nuk u përkrah dhe mbeti vetëm si një prezantim.

Më vonë në vitin 2006 pas analizave dhe nevojave imediate bazuar në një analizë detale shkencore dhe me përmirësime më të avancuara, prapë u bë propozimi i krijimit të një entiteti të tillë që për bazë kishte teknologjinë informative dhe profesionalizmin e stafit. Bazuar në idenë lidhur me nevojën për një entitet të tillë në vitin 2008, kryeministri i atëhershëm i Republikës së Kosovës merr vendim (Nr. 3 / 20 datë 15.05. 2008) për krijimin e një entiteti të tillë, e që, fatkeqësisht, nuk arriti të krijohej e të bëhej funksional sot e kësaj dite.

Analiza detaje e bërë sjell në përfundim se ekzistojnë dy hipoteza në lidhje me mundësinë e mospërputhjes së mundshme të vijës kufitare Kosovë - Mali i Zi e që do të jetë problem në pajtueshmëri në mes dy komisioneve dhe dy qeverive. Këto dy hipoteza duhet hulumtuar në detaje në mënyrë që propozimi final të jetë i saktë dhe l pranueshëm.

1.Hipoteza e parë bazohet në mosseriozitetin shkencor të të gjitha aktorëve (individualë dhe institucionalë), të cilët në publikimet e tyre, qofshin libra universitarë, punime shkencore, revistave, monografi, projekte, tema të doktoratave dhe magjistraturave, librave të shkollave të mesme dhe fillore, kanë prezantuar gabimisht sipërfaqen e Kosovës duke mos u bazuar asnjëherë në verifikimin e saj.

•Kjo do të ketë ndodhur përkundër faktit se secili nga autorët e këtyre punimeve ka pasur aftësi profesionale dhe metodologjike që para publikimit, të bëjë vetë matjen dhe verifikimin e sipërfaqes nga hartat topografike me shkallë të ndryshme (nga ato 1:50 000 deri te ato 1:200 000).

•Publikimet dhe literaturat e tjera nga institucionet e ndryshme të niveleve të ndryshme akademike e shkencore, por edhe institucionet e tjera, po thuaj në të gjitha rastet publikuan sipërfaqen e gabuar nga 10800 km² përmes 10877 km² deri tek 10887 km², e që nuk korrespondon me sipërfaqen reale të Kosovës pas vitit 1956.

•Për çudi gjatë analizës së bërë për këtë punim nuk dihet asnjë rast i tentimit të llogaritjes dhe të verifikimit të kësaj sipërfaqeje.

•Duke u bazuar në këtë neglizhencë shkencore të ekspertëve kosovarë dhe vetë pajtueshmërisë profesionale me këtë sipërfaqe, mund të konstatohet se njësitë administrative fqinje me vetëdije dhe në mënyrë mjeshtërore e perfide kanë tentuar ta bëjnë rrudhosjen e territorit të Kosovës deri në barazimin me sipërfaqen e publikuar më herët.

•Llogaritjet matematike të bëra me vone kanë kalkuluar dhe verifikuar këtë proces. Vetëm me aplikimin e GIS - it dhe digjitalizimin e hartave pas luftës së vitit 1999 u konstatua se Kosova ka sipërfaqe më të madhe se ajo e publikuar më parë.

2.Hipoteza e dytë rrjedh nga hipoteza e parë dhe dyshimet tona bazohen në mundësinë e ndonjë marrëveshjeje të fshehtë mes Serbisë dhe Malit të Zi për këmbim territoresh në dëm të Kosovës mes viteve 1981-1999. Kjo mund të vërtetohet nëse gjendet material hartografik të vijës kufitare mes Serbisë dhe Malit të Zi në dy periudha kohore, të vitit 1958 dhe 1986.

Shikuar në kronologjinë e përpilimit të hartave topografike ku prezantohen kufijtë e njësive administrative, konkludohet se ato janë punuar në kohën e gjeneralit Aleksander Ranković (1945 - 1966) i cili në atë kohë ishte ministër i punëve të brendshme të Jugosllavisë. Duke analizuar të gjitha veprimtaritë shkencore dhe publike lidhur me kufirin Kosovë - Mal i Zi është konstatuar se: sikur të kishte pasur një koordinim më të madh mes aktorëve të ndryshëm shkencorë, politikë dhe opinionit të gjerë, me siguri se nuk do të kishte kaq shumë paqartësi mbi mundësitë e gabimeve në përcaktimin e kufirit Kosovë - Mali i Zi. Një koordinim i tillë me të gjithë aktorët do të ofronte kushte më të mira dhe më përmbajtjesore mbi të gjitha sfidat në aktivitetet rreth demarkacionit kufitar. Organizimi i konferencave, diskutimeve publike e takimeve me organet vendimmarrëse dhe popullsinë vendëse do të krijonin mundësi më të mira që të sqarohen të gjitha problemet, paqartësitë e mundshme si dhe mundësia e mbledhjes së fakteve praktike nga terreni.

Duke ua bërë një analizë aktiviteteve shkencore dhe profesionale të disa anëtarëve të komisionit mund të konstatohet se përgatitja profesionale e tyre jep shpresë se nuk do të ndodhin gabime në lidhje me demarkacionin e kufirit. Puna shkencore dhe praktike e tyre jep mundësi të analizimit me kujdes të të gjithë dokumentacionit hartografik dhe elementeve shkencore që vendimi të jetë i drejtë dhe i qartë, por e gjithë kjo varet nga metodat e aplikuara në fazën përgatitore dhe në procesin vijues të demarkacionit.

Morfologjia e terrenit, dokumentacioni i shfrytëzuar, lehtësia në qasje etj., janë komponentë të rëndësishme që vërtetojnë vijën kufitare mes Kosovës dhe Malit të Zi. Majat e maleve, kurrizet e tyre - ujëndarësit, qafat malore determinojnë qartë kufirin. Këto elemente morfologjike dhe hidrike janë të përshtatshme për dy palët dhe kanë një vazhdimësi historike.

Pronësia e staneve të ndryshme të shfrytëzuar nga popullsia vendëse, varrezat e ndryshme, historia e shfrytëzimit në kullota me bagëti nga popullata kosovare, dokumentacione të tjera janë faktografi të mjaftueshëm për identifikimin e vijës kufitare në të kaluarën e që do të ishte një nga ndihmesat për përcaktimin aktual.

Territori i Kosovës për nga aspekti i qasjes në terren, sipas vijës kufitare të vitit 1958, është shumë më i lehtë sesa nga ana malaziasë. Pjerrtësia e terrenit, ekspozicioni, infrastruktura etj., anojnë në anën Kosovare.

Edhe pse u shpërbë një shtet i madh në disa shtete të tjera, për identifikimin dhe

përcaktimin e vijave kufitare ekziston materiali i mjaftueshëm hartografik që lehtëson punën rreth demarkacionit. Pas përfundimit të Luftës II Botërore, territori i Kosova kishte një fat në fatkeqësi.

Fatkeqësia qëndron në atë se territori i Kosovës, pa dashje, mbeti nën juridiksionin e Jugosllavisë se atëhershme, ndërsa fat, sepse në atë shtet të atëhershëm kishte institucione të forta hartografike të licencuara edhe për të përcaktuar kufij në mes njësive administrative të asaj kohe bazuar në metoda shkencore. Shfrytëzimi i këtyre hartave, të cilat nuk janë punuar nga autorët shqiptarë, shkojnë në dobi të Kosovës dhe prezantojnë sipërfaqe më të madhe, sesa ajo e publikuar në literaturën Kosovare. Për këtë arsye shfrytëzimi i këtyre fakteve nga komisioni në bisedime me komisionin malazias do të ishte dobiprurës dhe i pranuar. Njëri ndër institutet më të rëndësishme, që merrej me përpilimin e hartave topografike, ishte V.G.I. (Vojno Geografski Institut - Instituti Ushtarak Gjeografik), që ishte garantuesi primar i përputhshmërisë së botës reale (terrenit) me pjesën grafike në hartat topografike duke përfshirë edhe vijën kufitare mes njësive administrative.

Këto vija kufitare në këto materiale hartografike, fatkeqësisht, nuk përputhen me shpërndarjen hapësinore të popullsisë sipas etnicitetit që në fakt nuk përcjellin vijën e kufirit etnik, por përputhen me kufij natyrorë. Ky është element i mjaftueshëm që komisioni ynë lidhur me demarkacionin duhej të ishte këmbëngulës, duke u mbështetur në këto disa fakte të rëndësishme:

- Kjo kushtëzon dhe obligon që pala kosovare të shfrytëzojë këto harta, të cilat nuk i ka përpiluar vetë, por, për çudi, ruajnë qartë integritetin territorial e kualitativ të Kosovës.

- Faktet nga këto harta topografike arrijnë në përfundime se çfarëdo intervenimi në kufirin Kosovë - Mali i Zi në periudha të mëvona, pa prezencën e grupit punues kosovar, duhet të jenë të papranuara dhe të papërfillshme, duke përfshirë edhe ndonjë vijë kufitare në vitet e 80-a (pas demonstratave të vitit 1981) të shekullit të kaluar, edhe nëse bazohen në Kushtetutën e vitit 1974.


- Secili ekspert, grup punues, komision i formuar nga qeveria, shoqëria civile dhe opinioni në përgjithësi, që merret me këtë çështje, duhet të ketë parasysh edhe vazhdimin kohor të lëvizjes së mundshme të vijës kufitare.

Gjatë analizave të bëra u konstatua se vite me rëndësi në përcaktimet e kufirit të Kosovës, janë:


- 1945 ... Fundi i Luftës së II - të Botërore
- 1948 ... Publikimi i hartave topografike me kufij të rinj të njësive administrative të ish-Jugosllavisë, shkalla 1:100 000, të punuara nga I.GJ.U (V.G.I.)
- 1956 ... Ndryshimi i vijës kufitare (sipërfaqes) së Kosovës?
- 1958 ... Azhurnimi i hartës topografike me kufij të rinj të njësive administrative të ish - Jugosllavisë shkalla 1:100 000 dhe 1: 50 000, të punuar nga I.GJ.U (V.G.I.)
- 1962 ... Publikimi i hartave topografike me kufij të njësive administrative të ish-Jugosllavisë në Enciklopedinë e Jugosllavisë (shih hartat në shtojcë)
- 1999 ... Çlirimi i Kosovës nga të gjithë okupuesit gjatë historisë.
- Tani ... Demarkacioni i kufirit Kosovë - Mali i Zi.

Shikuar në kronologjinë e përpilimit, hartat topografike, ku prezantohen kufijtë e njësive administrative, janë punuar në kohën e gjeneralit Aleksandër Rankoviq (1945 - 1966), i cili në atë kohë ishte ministër i punëve të brendshme të Jugosllavisë. Ai njihet edhe si një antishqiptar shumë i madh dhe kishte informata dhe informatorë të panumërt në lidhje me çështjen shqiptare.


Sikur të kishte ndonjë gabim në përpilimin e këtyre hartave dhe se vija kufitare nuk do të përputhej me realitetin në terren, ai i pari do të reagoonte dhe do ta ndërpriste përdorimin e hartave të tilla. Bazuar në këtë dhe në shumë argumente të tjera, mund të konkludohet se hartat topografike me vijat kufitare të publikuara në vitet 1948, 1958 dhe 1962 janë të sakta dhe të pranuar për atë kohë.



Harta 6. Dallimi në mes kufirit Kosovë Mali i Zi në pjesën perëndimore të Kosovës. Vijat kufitare janë të vendosura sipas prezantimit në hartën topografike të vitit 1948 / 58 / 62 të punuar nga I.Gj.U.J. dhe gjeoportaleve, si dhe nga institucionet e Kosovës të publikuar në Web. Harta paraqet devijimin e vijës kufitare dhe sipërfaqja e mbetur jashtë territorit të Kosovës në drejtim të Qafës së Çakorrit. Vija me katror prezanton vijën nga hartat topografike, ndërsa vija me ndërprerje prezanton vijën e publikuar në Web nga institucionet e ndryshme. Asnjëra vijë kufitare nuk është bazuar në ndonjë propozim të ndonjërit komision për demarkacion të kufirit Kosovë - Mali i Zi.



Harta 7. Dallimi në mes kufirit Kosovë - Mali i Zi në pjesën veriperëndimore të Kosovës. Vijat kufitare janë të vendosura sipas prezantimit në hartën topografike të vitit 1948/58/62 të punuar nga I. Gj. U. J. dhe gjeoportalet si dhe nga institucionet e Kosovës të publikuar në Web. Harta paraqet devijimin e vijës kufitare dhe sipërfaqja e mbetur jashtë territorit të Kosovës në drejtim të Kullës në malin Zhleb. Vija e trashë prezanton vijën nga hartat topografike, ndërsa vija me ndërprerje prezanton vijën e publikuar në Web nga institucionet e ndryshme. Asnjëra vijë kufitare nuk është bazuar në ndonjë propozim të ndonjërit komision për demarkacion të kufirit Kosovë - Mali i Zi.



Harta 8. Fakte statistikore në brezin kufitar Kosovë - Mali i Zi. Analizat janë bërë me MapInfo (GIS aplikacion) nga autoret.

Pas analizës së bërë për mospërputhshmërinë e vijës kufitare të digjitalizuar nga hartat topografike dhe asaj të botuar në gjeoportale, mund të konstatohet se 18 herë ka ndërhyrje të territorit mes dy palëve, nga 9 herë për secilën palë. Me ndihmën e softuerit kemi kalkuluar të gjitha sipërfaqet e secilit poligon për të pasur një analizë më të saktë statistikore të kësaj ndërhyrjeje. Sipërfaqja e territorit nga kufiri i gjeoportaleve del jashtë territorit të Kosovës (nga hartat topografike) në 9 raste me një sipërfaqe të përgjithshme

prej 761.18 hektarësh. Kjo mund të konsiderohet si sipërfaqe që e fiton Kosova në raport me vijën kufitare të fituar nga hartat topografike. Sipërfaqja më e madhe është 303.15 hektarë në pjesën verilindore të kufirit me Malin e Zi e që, në aspektin morfologjik dhe gjeografik, është e pakuptueshme dhe e pashpjegueshme, sepse ndërhyr në pjesën jugore të pellgut të lumit të Zhupës me ekspozicionin verior në drejtim të Malit të Zi dhe pa asnjë lidhje rrugore me territorin e Kosovës. Edhe rastet e tjera, në përjashtim të atyre me sipërfaqe nën 1 hektar, kanë të njëjtin element morfologjik dhe gjeografik.

Shikuar nga aspekti i qasjes në terren, i shfrytëzimit dhe i monitorimit, këto sipërfaqe janë të panevojshme dhe më shumë janë pengës, sesa sjellin ndonjë dobi për komunitetin lokal apo edhe për shtetin. Janë shumë të vështira për monitoruesit e kufirit dhe aq më shumë për shënimin e vijës kufitare në terren (shih. Hartën). Sipërfaqja më e vogël që “fiton” Kosova është 0.393 hektar.



Harta 9. Sipërfaqja që e fiton Kosova në raport me Malin e Zi dhe kualiteti morfologjik e gjeografik i kësaj sipërfaqe. Ekspozicioni dhe qasja e terrenit është në anën e Malit të Zi çka është vështirë e qasshme për palën Kosovare.

A map of Kosovo with its administrative regions highlighted in orange. The regions are labeled: Obiliqi in the northwest, Shkabaj in the north-central area, Prishtina in the northeast, Zona Industriale in the south-central area, and Fushë Kosova in the southwest. A red line outlines the border of Kosovo.

Gjatë analizave hartografike të bëra, u konstatua se sipërfaqja e Kosovës është më e madhe se ajo e publikuar. Deri te kjo e dhënë u arrit pas gjeoreferencimit të hartave topografike ku është prezantuar vija kufitare Kosovë-Mal i zi, dhe vektorizimi i asaj vije. Gjithashtu u konstatua se ka dallime në mes hartës së Kosovës të prezantuar në portale si Google, Earth dhe në disa harta të tjera të portaleve gjeohapësinore dhe kufijve realë të dalë nga hartat topografike të ish - Jugosllavisë.

Pellgu i Lumit Bjelluha



Harta 11. Pellgu i Lumit Bjelluha në hartën e Enciklopedisë së Jugosllavisë (dëshmi tritoriale e Kosovës)

Ky pellg shtrihet në perëndim të Kosovë dhe ka sipërfaqe prej 3.132 hektarë (më shumë se 15 shtete të OKB). Gjendet në pjesën burimore të Lumëbardhit të Pejës dhe në vete ka disa burime të rëndësishme ujore. Ka ekspozicion kryesisht verior çka kushtëzon mbajtjen me të gjatë të shtresës së borës gjatë periudhës së dimrit. Shkrirja e saj e ngadalshëm mundëson ushqimin e ujërave nëntokësore dhe mban në vazhdimësi prurjen e ujit në lumin e Lumëbardhit të Pejës. Në aspektin morfologjik është e izoluar nga të gjitha anët me male të larta. Vetëm përmes rrjedhës së lumit Lumbardhë dhe Grykës së Rugovës është e lidhur me Kosovën, ndërsa për tu lidhur me Malin e zi duhet të kalohet lartësia 1849 në qafën e Çakorrit. Lartësia më e ulët mbidetare është 1359 metra në grykëderdhje të lumit Bjelluha në Lumëbardhin e Pejës, ndërsa lartësia më e madhe mbidetare është 2392 në pjesën jugore të pellgut. Pellgu në këtë sipërfaqe ka një denivelim relievor prej 1033 metra që e bën shumë atraktiv. Pasuria e madhe me rrjedhje ujore, biodiversitet dhe shpatë të zhveshura pa pengesa natyrore e bëjnë pellgun e Bjelluhes mjaft atraktive dhe tërheqëse për zhvillimin e turizmit të llojeve të ndryshme sidomos për ekoturizëm dhe turizëm dimëror. Sipas hartave topografike të vitit 1958 / 62 dhe Enciklopedisë së Jugosllavisë pellgu i Bjelluhës i takon Kosovës. (Shih hartën nga Enciklopedia e Jugosllavisë).

Me qenë se në një sipërfaqe kaq të vogël ka një denivelim të madhe relievorë analizën e thyerjes së terrenit e kemi bërë në çdo 250 metra lartësi mbidetare. Nga analizat morfologjike të bëra mund të konstatohet se pellgu Bjelluha ka vetëm 2,72% të territorit nën 1500m lartësi mbidetare, ndërsa mes 1500 dhe 1750 metra të l.m.d. ka 25.20%, që do të thotë se nën 1750m ka më pak se 1/3 e sipërfaqes, vetëm 27.92%. Pellgu i lumit Bjelluha sipërfaqen më të madhe e ka mbi 1750m gjithsej 2257.55 hektar prej së cilës 45.96% mes lartësisë 1750 dhe 2000m, ndërsa rreth 1/4 apo 26.12% mbi 2000 m l.m.d.

Tabela 1. Pjesëmarrja e sipërfaqes sipas lartësisë mbidetare

Lartësia mbidetare	Nën 1500 m	1500-1750 m	1750-2000 m	Mbi 2000 m	Gjithsej
Sipërfaqja hektar	85.193	789.25	1439.3	818.25	3131.993
Sipërfaqja në %	2.72	25.20	45.96	26.12	100

Burimi: Rezultatet janë kalkuluar nga MDR me saks 20m/pixel

Ajo çka e bënë pellgun e lumit Bjelluha mjaft atraktive dhe shumë joshëse për palët e interesuara është ekspozicioni i terrenit. Rezultatet e fituara nga përpunimi i MDR vërtetojnë se afër gjysma e sipërfaqes apo 45.94% e territorit ka ekspozicion Verior (të hijesuar). Ky lloj ekspozicioni në gjerësitë gjeografike të mesme veriore me një lartësi të tillë mbidetare garanton numër më të madh të ditëve me mbulesë bore, shkrirje të ngadalshëm, furnizim me ujë rezervarët nëntokësor dhe burime ujore gjatë gjithë vitit. Rreth 1/5 e sipërfaqes së pellgut të Bjelluhës ka ekspozicion lindorë (gjysmë e ndriçuar), ndërsa 17.88% e territorit ka ekspozicion jugorë (e ndriçuar) e që është e ekspozuar më shumë ndaj rrezeve të diellit. Pjesa e mbetur e territorit prej 14.80% ka ekspozicion perëndimor (gjysmë e ndriçuar).

Tabela 2. Pjesëmarrja e ekspozicionit në pellgun e Bjelluhës

Ekspozicioni	Verior	Lindor	Jugor	Perëndimor
Sipërfaqja në hektar	1438.94	669.66	559.94	463.46
Pjesëmarrja në %	45.94	21.38	17.88	14.80

Burimi: Rezultatet janë kalkuluar nga MDR me saks 20m/pixel

Analizat e bëra tregoj se pellgu i lumit Bjelluha ka rrjet të dendur lumorë. Pellgu i lumit Bjelluha ka rrjet mesatar lumorë 1.373 km/km². Në territorin e pellgut të Bjelluhës në 10 raste ka mbi 2 km gjatësi lumore për km², ndërsa 5 raste prej 1 deri 2km/km², për këtë arsye në aspektin hidrik pellgu i lumit Bjelluha është interesant dhe një pasuri e madhe me resurseve ujore për gjeneratat e ardhme. Lumi Bjelluha mesatarisht në vit ka prurje 0.8-0.9 l/s, e në raste ekstreme deri 1.35 l/s.

Tabela 3. Sipërfaqja dhe kapaciteti i liqenit artificial në lumin Bjelluha sipas lartësisë së pendës

Lartësia e pendës	50 m	100 m	150 m	200 m	250m	300 m
Sipërfaqja e liqenit në hektar	8.44	33.92	74.19	141.66	249.10	396.04
Sasia m3	2108750	8435000	31245000	68252500	128837500	219287500

Burimi: Llogaritjet i kanë bërë autorët duke aplikuar programe aplikative të GIS-it dhe MDR me saktësi prej 20m/pixel




Figure 8 Pellgu i Bjelluhës me liqenin artificial të simuluar mbi MDR dhe imazh satelitor (ideja, analiza dhe modelimi është bërë nga autorët)

Për ta arsyetuar rendësin e këtij pellgu i cili sipas hartave të institucioneve të Kosovës dhe gjeoportaleve mbetet jashtë territorit të Kosovës në po japim vetëm një segment të shfrytëzimit dhe rëndësisë praktike që mund ta ketë për vendin tonë.




Figure 9. Profili i kalimit të vijës kufitare dhe problemi në qasje. Për të dy palët kufiri në qafën e Çakorrit është më natyror, praktik, identifikues dhe lehtë i qasshëm, ndërsa nëse vendoset afër Kuqishtës duket se është absurde.

E gjithë kjo ngrit idenë e akumulimit të ujit në pellgun e lumin Bjelluha. Morfologjia e terreni është shumë e përshtatshme sepse i tërë pellgu rrethohet me male të larta ndërsa daljen e ka nëpër një grykë të ngushtë në perëndim të pellgut në anën e Kosovës me një gjerësi në bazë prej 80-100m. Nëse penda do të ngrihej 100m liqeni artificial i Bjelluhes do të kishte kapacitet akumulimi prej 8,4 milion m³ ujë, ndërsa nëse ngrihet në lartësi 150m do të zë një sipërfaqe prej 33.9 hektarësh dhe do të akumulonte 31.2 milion m³ ujë. Sasia e ujit të akumuluar dhe sipërfaqes së liqenit rritet me rritjes e lartësisë së pendës (shih tabelën). Nëse lartësia e pendës arrin 300 metra, sasia maksimale e ujit të akumuluar do të ishte rreth 219 milion m³. Për të pas një pasqyrë më të qartë të akumulacioneve të tilla kemi konsultuar tabelën me të dhëna në rangun botërorë.

Tabela 7. Disa liqe artificial në botë me lartësi të pendës mbi 200m, sipërfaqja në ha dhe sasia e ujit të akumuluar në m3.

Emri i Liqenit	Lartësia e pendës	Shteti	Lumi	Sipërfaqja hektar	Sasia m3
Jinping I Dam	305 m	Kinë	Yalong	8255	4910000000
Nurek Dam	300 m	Tagjigistan	Vakhsh	9800	10500000000000
Grande Dixence Dam	285 m	Zvicër	Dixence	400	400000000
Mica Dam	243 m	Kanada	Columbia		
Luzzone Dam	225 m	Zvicër	Lago di Luzzone	127	108000000
Kölnbrein Dam	200 m	Austri	Streams in upper Malta	254	205000000

Burimi: https://en.wikipedia.org/wiki/List_of_tallest_dams_in_the_world 23.08.2015

Analiza e bërë e këtyre hartave sjell në përfundim se:

- *Vija kufitare mes Kosovës dhe Malit të Zi shkon përgjatë vijës ujëndarëse dhe qafave malore e kurrsesi nuk shkon nëpër terrene të veshtira dhe të padefinuara në aspektin fiziko - gjeografik.*
- *Nga hartat topografike vërehet qartë se vija kufitare kalon nëpër Qafën e Çakorrit dhe Qafën e Kullës, që lë përshtypjen se vendosja e punkteve dhe e pengesave nga malazeztë është thellë në territorin e Kosovës.*
- *Kah ana e Qafës së Çakorrit distanca ajrore lëviz rreth 4100 m në brendi të territorit të Kosovës, duke lënë jashtë territorit të Kosovës pellgun e Bjelluhës, Vaganicën dhe Shipovicën.*
- *Ndërsa kah ana e Kullës rreth 4000 m në brendi të territorit të Kosovës duke lënë jashtë anët veriperëndimore të Zhlebit, të banet e Loqanit dhe një pjesë të të baneve të Glogjanit.*
- *Këto fakte nuk shprehin pretendime territoriale kur dihet se përcaktimii kufijve administrativ brenda territorit të ish - Jugosllavisë ishte nën monitorimin e Gjillasit dhe se hartat janë përviju dhe publiku në kohen e Rankoviqit.*

Konkluzion


Nga analizat e bëra dhe nga dokumentacioni hartografik i shqyrtuar me kujdes, rrjedh se:

- *Vija kufitare në mes Kosovës dhe Malit të Zi është punuar shumë më herët sesa Kushtetuta e vitit 1974, prandaj nuk mund të merren qëndrime përfundimtare në lidhje me demarkacionin kufitar pa analizuar historikisht ndryshimet e mundshme të kufirit.*
- *Kufiri mes Kosovës dhe Malit të Zi, i prezantuar në hartat topografike të vitit 1958, nuk është përpiluar nga ekspertët dhe politikanët shqiptarë, por nga qendrat e specializuara hartografike ushtarake të ish-Jugosllavisë, prandaj nëse kërkohet që shpërbërja e ish- Jugosllavisë duhet të bëhet me kufi që kanë qenë gjatë ekzistimit të saj, atëherë këto harta duhet të jenë vendimtare.*
- *Edhe pse ky kufi i dëmshëm në aspektin etnik, sepse popullatën shqiptare e ndan në dy njësi administrative, ai është i përshtatshëm në aspektin morfologjik dhe i plotëson të gjitha kushtet shkencore dhe praktike që të pranohet për propozim final të demarkacionit kufitar mes Kosovës dhe Malit të Zi.*
- *Bazuar në këto fakte, duhet të bëhet presion në Komisionin malazias që këto harta topografike patjetër të inkorporohen si bazë mbi të cilat do të rivizatohet vija kufitare Kosovë - Mali i Zi!*


Fakte hartografike



Fig. 4. Sfaruesit e hartave topografike ku dëshmohej vija kufitare mes Kosovës dhe Malit të Zi.




Harta 12. Harta topografike me vijën kufitare në Qafën e Çakorrit. Harta është e punuar në vitin 1946.



Harta 13. Harta topografike me vijën kufitare në Kullë. Harta është e punuar në vitin 1946. Shihet qartë se vija përcjell kuotat më të larta malore.



Harta 14. Harta topografike me vijën kufitare në Qafën e Çakorrit. Harta është e punuar në vitin 1958. Në këtë hartë shihet distanca ajrore dhe rrugore e futjes së pengesave të Malit të Zi në brendi të territorit të Kosovës duke përvetësuar edhe pellgun e Lumit Bjelluha.



Harta 15. Harta topografike me vijën kufitare në Kullë. Harta është e punuar në vitin 1958. Në këtë hartë shihet distanca ajrore dhe rrugore e futjes së pengesave të Malit të Zi në brendi të territorit të Kosovës duke përvësuar edhe pjesë veriperëndimore të Zhlebit.

Prof dr. Zymer U. Neziri:

4. SPEKTE HISTORIKE TË KUFIRIT KOSOVË - MALI I ZI

Kufiri Kosovë - Mali i Zi në Luftën e Dytë Botërore

Hyrje

Kufiri shtetëror me Malin e Zi, si pjesë e indentitetit të Shtetit të Kosovës, është për shqyrtim. Ka lloje e lloje kufijsh, por tash veçoj kufirin e vendosur me dhunë, me marrëveshje ose me ndërmjetësim. Presim që për dy variantet e fundit të mbizotërojë, sot, arsyeja për vijën e demarkacionit, e kontestueshme për rreth 12 mijë ha, duke pasur parasysh së paku edhe vitet 1912 - 1999.

Rugova në Luftën e Dytë Botërore

Lidhur me këtë kumtesë timen, Aspekte të kufirit Kosovë - Mali i Zi në Luftën e Dytë Botërore, me theks të veçantë në mbrojtjen e kufirit të Rugovës, paraprakisht bën të shtrohen tri pyetje: 1. Cili ishte kufiri Kosovë - Mali i Zi në Luftën e Dytë Botërore? 2. Si është mbrojtur ky kufi në Luftën e Dytë Botërore? 3. Kush e ka mbrojtur këtë kufi në Luftën e Dytë Botërore? Në pyetjen e parë, kemi këtë përgjigje: Kufiri Kosovë-Mali i Zi, në Luftën e Dytë Botërore, në krahinën e Rugovës, ishte në pikat Çakorr - Mokna - Gilloxi - Murgash - Smilevicë. (Dëshmi: Arkivi i Kosovës, Procesverbali i hetimeve ndaj Zhukë Haxhisë, komandant ushtarak i Rugovës, Pejë, më 14.3.1947). Dy. Ky kufi është mbrojtur ushtarakisht në Luftën e Dytë Botërore. (Dëshmi: AK, Proc. i hetimeve ndaj Zhukë Haxhisë, Pejë, më 14.3.1947). Tre. Këtë kufi në Luftën e Dytë Botërore, në krahinën e Rugovës, e kanë mbrojtur gjashtë grupe të armatosura: Grupi i Zhukë Haxhisë, Stakaj, Grupi i Rizë Zymerit, Koshutan, Grupi i Salih Ramës, Bogë, Grupi i Isuf Mehmetit, Shtupeq i Vogël, Grupi i Haxhë Mustafës, Shtupeq i Math, Grupi i Sak Fasilisë, Koshutan.

Gjashtë grupet kishin një komandë të përbashkët. Zhukë Haxhia ishte komandant ushtarak, kurse Rizë Zymeri ishte komandant politik. (Dëshmi: AK, Proc. i hetimeve ndaj Zhukë Haxhisë, Pejë, më 27.2.1947). Forca ushtarake e këtyre gjashtë grupeve të armatosura përbëhej nga 600 vullnetarë gjithsej. (Dëshmi: AK, Proc. i hetimeve ndaj Zhukë Haxhisë, Pejë, më 14.3.1947). Pjesën tjetër të kufirit e kanë mbrojtur njësitë nga Rr. i Dukagjinit. Këto grupe të armatosura të Rugovës kanë pasur edhe disa beteja me grupet e armatosura të M. të Zi. Madje, kanë luftuar edhe për mbrojtjen e Pazarit të sulmuar. Ndonëse pati edhe humbje në këto beteja, të plagosur e të vrarë, e ndër ta ra dëshmor edhe Sak Faslja, Rugova doli fitimtare. Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, Zhukë Haxhia u zgjodh kryetar i Rugovës, por shpejt gjendja politike ndryshoi. Pushteti synonte t'i burgoste prijësit. Në Shtupeq të Vogël u pushkatuan pesë burra në lagjen Nilaj. Zhuka me bashkëluftëtarët e vet doli në mal e jetoi në mal deri në shkurt 1947, kur pushteti e dënoi me vdekje, pasi ra në dorë, kurse Rizë Zymerin e pushkatoi.

Shembuj burrërie në Luften e Dytë Botërore

Në luftë me Malin e Zi, përveç betejave, që fillonin edhe me dyluftime, si ai dyluftimi i trefishtë i të famshmit Adem Isufi në Betejën e Nokshiqit, më 1879, kishte edhe burrëri, krahas trimërisë. E burrëri ishte respektimi i ndërsjellë i kodit moral të luftës: se malli i kundërshtarit bën të plaçkitet, se shtëpia bën t'i digjet, por jeta dhe nderi i familjes nuk bën t'i preket, si andej, si këndej kufirit.

Kështu ishte para e pas Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, por vetëm deri më 1912, kur Mali i Zi e theu këtë kod burrërie në Rugovë. Kështu veproi Mali i Zi, bashkë me Serbinë, edhe më 1919, më 16 shkurt, kur masakroi 432 fëmijë, gra e pleq, e shumë prej tyre i dogji të gjallë në Hanin e Isufit në Shtupeq të Math. (Z. U. Neziri, ELR, I, IAP, 2006, f. 261 - 273).



Fig. 5. Biodiversitet i pasur i Rugovës

Por, Rugova nuk e theu kodin e burrërisë, se rast të mirë për hakmarrje kishte kur në LDB kaluan duke ikur nëpër Rugovë rreth 30 mijë njerëz, gra e fëmijë, kryesisht malazias, që i solli pushteti jugosllav dhe i vendosi në tokat e në shtëpitë e shqiptarëve. (Dëshmi: AK, Proc. i hetimeve ndaj Zhukë Haxhisë, Pejë, më 5.II. 1947). Por, Rugova tha: nuk e çburrnojmë pushkën n'ta! Pra, ajo nuk e theu kodin e burrërisë, sepse nuk i ndali dhe nuk u hakmor në ata 30 mijë njerëz, gra e fëmijë, kryesisht malazez. Ajo fisnikërisht u hapi rrugë atyre, madje edhe njerëzisht u ofroi ndihmë nënave me fëmijë të vegjël, atyre me këmbë të mërdhira, po edhe një lehone, që lindi fëmijën e saj në katundin Drelaj. Në historinë e dy popujve është dëshmi në përmasa europiane për shpirtin fisnik e bujar të shqiptarëve, për burrërinë e madhe të tyre. Natyrisht, nuk harrohet edhe lejimi i kalimit të të shpërngulurve tanë në Mal të Zi, në vitet 1998 - 99, dhe vendosja e tyre atje, në familjet shqiptare.

Rugova pas Luftës së Dytë Botërore

Vija Çakorr - Mokna - Smilevicë, pra, ishte vija e kufirit të Rugovës me Malin e Zi në LBD edhe -pas saj. (Dëshmi: Fjala hyrëse e Komisionit të Besëlidhjes së Rugovës: Guri i Vajzit, Qafa e Diellit, Moknat, Livadi i Turkut, Hajla, 40 km², 13 katunde, më 20.11.1970).

Shumë rugovas kanë vepruar kundër robërisë jugosllave, sidomos në NDSH dhe më 1968 e 1981. Janë ndjekur e janë burgosur. Disa kanë vdekur burgjeve.

Edhe pesëdhjetë vjet më vonë, në luftën me Malin e Zi, në vitet e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, 1997 - 1999, brigada 136 "Rugova" e ka konsideruar linjën Çakorr - Mokna-Smilevice - Hajlë, vijë e kufirit me M. e Zi, ku ranë dëshmorët e lirisë: Selman B. Lajçi, Besnik M. Lajçi, Ramush M. Lajçi, Xhavit S. Lajçi, Ramë A. Lajçi, Tone Lajçi - Husaj, Sokol Z. Nikçi. Ashtu konsiderohet edhe sot. Mirëpo, edhe duhet të dihet saktësisht se M. i Zi ishte në bashkësi shtetërore me Serbinë dhe kjo bashkësi e fundit jugosllave e humbi luftën me Kosovën.



Fig. 5. Bjeshkët e Deçanit



Harta 16. Harta shkollore fiziko – gjeografike në kufi real me Malin e Zi

Pra, M. i Zi e plaçkiti, e dogj dhe e masakroi Rugovën edhe më 1999, po edhe Pejën e anën veriore të Rr. të Dukagjinit, por doli humbës bashkë me Serbinë, e fitmtarit, Kosovës, i takon vija e mbrojtur e kufirit Çakorr - Mokna - Smilevicë -Hajllë, po edhe pjesa tjetër e bjeshkëve deri në Kullë.

Përfundim: Kjo është gjendja me Malin e Zi, pra vija Çakorr - Mokna - Smilevicë, ndonëse historikisht as etnikisht kjo nuk është e drejtë, sepse edhe ky ishte kufi i dhunshëm i M. të Zi, i treti me radhë, i vendosur me pushtime në territoret shqiptare në dy shekujt e fundit, natyrisht, me lejen e Europës dhe me ndihmën e saj, sidomos në prag të Kongresit të Berlinit e pas tij, në Tivar e Ulqin, e pastaj në Sanxhakun e Pazarit, si dhe më 1912, në Plavë e Guci, Beran e Rozhajë dhe në pjesën e Malësisë së Madhe, ku nuk kishte fare popullsi malaziasë. Në këto territore të pushtuara nga M. i Zi, për rreth një shekull, u asimilua popullsia shqiptare, pra ajo është tjetërsuar gjuhësisht, sidomos në qytete, përveç Ulqinit, dhe tash flet kryesisht boshnjakisht. Kjo çështje mbetet e hapur, kurse problemi i vijës Çakorr - Mokna-Smilevicë-Hajllë, deri në Kullë, duhet të mbyllet si punë e tashme ndërmjet qeverive në Podgoricë e Prishtinë, e nëse duhet, edhe me ndihmën e bashkësisë ndërkombëtare, duke e lënë derën të hapur për diskutim edhe për çështje të tjera, sipas standardeve europiane të fqinjësisë së mirë. Kufiri shtetëror me Malin e Zi, si pjesë e indentitetit të shtetit të Kosovës, është për shqyrtim. Ka lloje e lloje kufijsh, por tash veçoj kufirin e vendosur me dhunë, me marrëveshje ose me ndërmjetësim. Presim që për dy variantet e fundit të mbizotërojnë sot arsyeja për vijën e demarkacionit, e kontestueshme për rreth 12 mijë ha, duke pasur parasysh, së paku, edhe vitet 1912 - 1999.

Sylë Osmanaj

Konteksti historik i kufirit ndërshtetëror në mes Kosovës e Malit të Zi

Kufiri ndërshtetëror në mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Malit të Zi (po edhe me njësitë e tjera shtetërore të ish - Jugosllavisë) ka një historik të vetin, i cili vjen që nga koha e parapushtimit turk të trojeve shqiptare (shek. XV). *Ky kufi qëndronte që në gjenezë mbi kriteret e ditura të ligjeve të brendshme kombëtare dhe të jashtme ndërkombëtare, siç janë: kriteri historik, kriteri etnik dhe kriteri gjeomorfologjik (natyror).*

Në bazë të këtyre kriterëve edhe Kongresi i Berlinit dhe konferencat ndërkombëtare që merreshin me përcaktimin e këtyre kufijve, Çakorrit (bjeshtë e lartë rreth 2000 m) dhe Lumin Lim, i njihnin si pika kufitare ndërmjet Malit të Zi dhe Shqipërisë / Kosovës. *(Karakteri administrativ autonom i vilajetit, sipas të cilit, për nevojat e organizimit të administratës së shtetit pushtues otoman për të zbatuar më lehtë sundimin pushtues)* ishin ndarë në disa vilajete e sanxhaqe shqiptare: Vilajeti i Kosovës, Vilajeti i Shkupit, Sanxhaku i Prizrenit, Sanxhaku i Shkodrës, Sanxhaku i Janinës...

Qëndron këtu parimor dhe i drejtë edhe faktori etnik, i cili legjitimon fuqimisht të drejtën e Kosovës për ta caktuar për kufi pikën e Çakorrit. Pika historike kufitare e Çakorrit kishte fuqinë zyrtare administrative edhe në kohën e sundimit mbi Shqipërinë të Austro - Hungarisë (territori shtetëror gjithëshqiptar njëhej me emrat Shqipëria etnike dhe Shqipëria e Vjetër – 1928 - 1941), si dhe të sundimit “paralel” të Gjermanisë dhe të Italisë mbi tokat etnike shqiptare – 1941-1944!).

Ky territor, Bjelluha (sipas antroponimit Bel Uka, Bali Uka, të cilin e tjetërsoi administrata e pushtimit sllav në – Bjelluha; mbi këtë bazë u formua edhe toponimi Kërshi i Bajukës - / Bali Ukës/, që tash gjendet në pjesën e poshtme të Vraçevës - bjeshtë kjo e Nokshiqit) dhe Çakorri - Qafa e Çakorrit (me uzurpimin e arbitraritetin shtetëror të Jugosllavisë komuniste pas Luftës së Dytë Botërore), u uzurpua, më 1945 (si gjithë Kosova dhe territoret e tjera etnike shqiptare që mbetën nën pushtimin administrativ të saj) nga Jugosllavia (Serbia, Mali i Zi e Maqedonia). Që të dyja këto pika territori, Çakorri dhe Bjelluha, ishin prona – me tapi - të kuqishtasve - të Kosovës (toka e Bjelluhës / Balukës ishte, në anën e djathtë të lumit Bistrica të Bjelluhës, e dy familjeve të mëdha kullake të Kuqishtës së Rugovës - Zekë Haxhisë dhe e Sali Turkajve dhe populloheshin e menaxhoheshin, qysh në kohën e pushtimit turk, nga vetë banorët - shqiptarë të Kuqishtës - të visit të Rugovës e të Vilajetit të Kosovës, edhe si bjeshtë, edhe si pronë e ligjshme që në kohë të hershme. Regjimi jugosllav/malazias (menjëherë pas Luftës më 1945 / 46) arbitrarisht bëri ekspropriimin dhe uzurpimin e tokave të shqiptarëve të këtyre zonave dhe banorët/pronarë legjitimë, që nga kjo kohë, i dëboi me dhunë dhe administroi

pa asnjë të drejtë ligjore dhe pa asnjë akt ligjor, kombëtar as ndërkombëtar, pronat e tyre legjitime! *(Në Konaqet e Zekë Haxhisë që vendosur vejusha e quajtur Marija, e cila sa që gjallë i menaxhonte kënaqet dhe tokat duke i dhënë ato prona me qira).*

Pas Luftës së Dytë Botërore kufijtë e brendshëm të ish - Jugosllavisë u caktuan, pra, sipas kriterit të qejfit, do të thotë me arbitraritet e me dhunë të regjimit komunist jugosllav! Në këtë pikë etno - historike “njësia administrative-autonome e Kosovës” e pësoi më së keqi, duke u rrudhur dhe duke u hedhur kufijtë e saj sipas lapsit të direktivës nga qendra - Beogradi!

Me Kushtetutën e vitit 1974 qenë caktuar kufij të rinj, kur Kosovës iu njoh statusi i ri i autonomisë shtetërore i barasvlershëm me statusin e republikës. *(Harta e demarkacionit të këtij kufiri mbeti e arkivuar në arkivat shtetërorë republikanë/krahinorë të kohës, pa u publikuar hapur për opinionin e gjerë, edhe pse Kosova dhe pronarët i dinin kufijtë e vet!).*

Në kushtet e sotme të menaxhimit dhe të administrimit të kufijve ndërshtetërorë veprimet dhe deklaratimet e realizuara gjatë kontakteve zyrtare të liderëve shtetërorë të Kosovës dhe të Malit të Zi, liderët malazias shfaqin hapur pretendimet hegjemoniste të uzurpimeve të territorit të Kosovës në të gjitha pikat kufitare të saj!

Ka rëndësi të theksohet, në këtë kontekst, edhe aspekti i menaxhimit administrativ të kësaj zone: që nga Kuqishta deri në Bjelluhë, gjithë ky brez toke, është kultivuar, menaxhuar, kullotur e shfrytëzuar nga qytetarët e Kuqishtës, të Rugovës dhe të Pejës – gjatë gjithë vjetëve të pasluftës së Dytë Botërore e këtej⁹ Në anën e majtë të Bjelluhës gjendet pllaja e Jelenkut, që bashkë me Dëbanishtën e Malësorëve, edhe pas LDB - së, shfrytëzohej si bjeshkë - kullosë me Bagëti nga Carrabregu i Deçanit... Në gjithë këtë zonë, pra në Bjelluhë dhe në Bjeshkët e Çakorrit, jetonin vetëm dy shtëpi malazias, të cilat ishin vendosur të jetonin këtu vetëm pas Luftës së Dytë Botërore, pra, në kohën kur Jugosllavia komuniste vendosi arbitrarisht ta uzurponte këtë zonë, pa kurrfarë të drejte, dhe ndoqi nga kjo tokë pronarët legjitimë të Kuqishtës!

⁹Shtëpia e Bjeshkatarëve në Bjelluhë, terrenet e skitarëve të “Gjeravicës” së Pejës në Bjelluhë, shfrytëzimi i kullotave me bagëti, prerja dhe shfrytëzimi i pyjeve, mirëmbajtja e rrugëve etj.

Toponimet shqiptaree

Karakteri i këtij shkrimi e do që të trajtohet, shkurtazi, edhe aspekti gjuhësor onomastik - toponimik i territorit të këtij krahu, të zonës së Kuqishtës, që në kohën e ish - Jugosllavisë ishin në administrimin e saj. Përmbi pikën e kufirit, në territorin e pushtuar nga ish - Jugosllavia/Mali i Zi - nga Bjelluha (!) dhe Çakorri, shtrihen:

Qafa e Çakorrit, e lidhur në një kurorë malesh me Qafën e Diellit, Qafa e Pejës (nga ana e Metehit dhe e Vuthajve), Gryka e Bjelluhës (Gryka e Balukës, Gryka e Bali - Ukës), Çeta e Pishës, Tëbanishta e Malësorëve, Lugu i Ortegut, Qafa e Vraqevës, Shejtan Tepja, Lugu i Osmanit, Konaqet e Zekë Haxhisë, Kodra e Halilit, Sheu i Çakorrit, Livadet e Saliturkë, Llazi i Bjelluhës (Bali - Ukës), Kërshi i Bajukës (Bali - Ukës), Sheu i Rug's (Sheu i Keq) etj. Në këtë zonë tokash, në tokën administrative të Republikës së Kosovës, shtrihen: Ura e Elezit, Kërshi i Qelit (mu mbi "Kërsh të Qelit shtrihet pllaja e 'Tbanishtës së Malsorëve'), Lugu i Shkodrës, Kërshi i Çamë, Maja e Zezë, Bregu i Gjollë, Çetat, Gjytetat, Shpella e Pllumave, Bregu i Gjollave, Lugu i Brez's, Brija e Halilit, Vija e Lop've, Vija e Dhive, Otërgjet, Ana e Neqinatit (Leqinatit-toponim i rrugicave për t'u ngjitur malit ose emër mali - çelësinë mali!), Bregu i Arush's, Lqeni (Liqeni) i Neqinatit, Neqinati i Drelë, Shpati i Sheut, Sheu i Leqes, Gropa e Pajës, Çardaku etj.; katundi Kuqishtë me të katër lagjet e tij: Gjevukajt, Barajt (nga bar-i, fushë bari), Bregu i Kuqishtës dhe Bardhajt. Nga kjo që u tha shihet e kuptohet qartë semantika shqipe, e ndjekur edhe në vijën historike, e toponimeve të theksuara.).

Nga i gjithë ky brez, e tërë Gryka e Bjelluhës / Balukës / e vetë Bjelluha /Baluka/, nuk ka asnjë lokalitet a vendbanim malazias, nuk ka asnjë shenjë etnike, as historike, as ndonjë shenjë historike a gjeografike malazias! Në ç'pika, atëherë, e do e drejta e caktimit të pikave kufitare me Malin e Zi?! Që këtu rrjedh i pakuptueshëm edhe qëndrimi i theksuar, ato ditë kur delegacionet e dy shteteve "biseduan" për zonën kufitare ndërmjet dy shteteve, duke theksuar se Kosova njih kufijtë zyrtarë të Kosovës të përcaktuar me Kushtetutën e vitit 1974 (!), pa definuar qartë karakterin (historik, etnik as gjeografik), të drejtën ndërkombëtare, përmbajtjen, pikën, zonën dhe gjenezën e caktimit të këtij kufiri dhe pa qartësuar e pa theksuar saktësisht e prerë as pikat e shtrirjes së këtij kufiri! Mali i Zi, ndërkaq, ka thyer thellë, arbitrarisht, kufirin shtetëror të Kosovës në të dyja pikat e territorit të saj: nga Qafa e Çakorrit (Kulla e Çakorrit) dhe nga Kulla e Rozhajës - pa qenë asnjëherë legjitimë as të pranuar zyrtarisht, kombëtarisht as ndërkombëtarisht, këta kufij - vijën e të cilëve e pretendon ai! E gjithë Rugova, në të gjitha anët e saj kufitare, sipas variantit që propozohet tashti, u rruddh e shkelur edhe me kilometra në brendi të pronave të saj, ashtu si u veprua edhe me rastin e propozuar të vijës kufitare nga pika kufitare e Kullës me Komunën e Rozhajës, si dhe nga ana e Podgurit të Komuns së Istogut!

E drejta mbyll kontestet

Gjatë kësaj kohe, kur Kosova shpalli pavarësinë e vet, Republika e Malit të Zi hapi rrugën nëpër malet e Kosovës - të Kuqishtës - nëpër tokat e Shtetit të Kosovës – të Rugovës tutje nga nuk kishte pasur kurrë rrugë, preu qindra kubikë lëndë bredhi, dhe i zbriti e i shiti në tregun e Pejës, pa bërë kush as reagimin më të vogël publik zyrtar – pos reagimit të popullatës vendore, edhe pse Kushtetuta e shtetit të Kosovës garanton sigurinë dhe sovranitetin shtetëror të Kosovës!).

Mbështetet me inkurajim të fuqishëm demokratik besimi dhe ngulmimi në drejtësinë parimore ndërkombëtare dhe në syçeltësinë dhe parimësinë e marrëveshjeve ndërshtetërore, se kjo zonë e “brishtë” (historikisht dhe etnikisht e ligjërisht e shëndoshë) ndërshtetërore, do të ketë zgjidhje të drejtë e të qëndrueshme të kufijve, pa lënë pas ngatërresën që do të shkaktonte kontestime të reja! Këtë kërkesë të drejtë demokratike e të ligjshme, shtetasit e Kosovës e artikuluan në mënyrë të fuqishme e me ngulmim edhe

Prof. dr. Muhamet Sadiku

5.REAGIMI NSTITUCIONAL DHE QYTETAR

Puna e komisionit qeveritar

Qeveria e Republokës së Kosovës më 21 mars 2012 ka formuar Komisionin Shtetëror për Shënimin dhe Mirëmbajtjen e kufirit Shtetëror.¹⁰ Në përberja të këtij komisioni kanë hyrë ekspertë të fushave të ndryshme, por jo edhe ekspertë të Gjeografisë – Hartografisë, të cilët i disponon Kosova. Mungesa e këtij profile është refektuar edhe në cilësinë e bisedimeve dhe pozicionimin e palës kosovare ndaj kësaj çështjeje të rëndësishme. Në një raport të komisionit qeveritar thuhet se Kosova përveç me Serbinë nuk ka kurrfarë kontesti kufitar. Kjo situatë sipas raportit ka të bëjë edhe me shtetet e tjera të rajonit. Sipas informatës së komisionit të dates 12.05 / 2015 në veprim është retorika folklorike. Sipas kësaj informate kjo retorikë folklorike është duke e dëmtuar seriozisht procesin.

Ky kualifikim sigurisht se u mëveshet organizatave dhe lëvizjeve qytetare, të cilat në kohë të fundit janë duke e kontestuar punën e komisionit qeveritar për demarkacionin Kosovë – Mali i Zi. Komisioni thekson se ka “përgjegjësi para institucioneve qendrore të Republikës së Kosovës sipas ligjit për kufij dhe marrëveshjes ndërkombëtare për shënimin e vijës ekzistuese të kufirit nga Krahina Socialiste Autonome e Kosovës”. Pra, ky komision nuk e thekson edhe përgjegjësinë ndaj qytetarëve dhe komuniteteve që afektohen në këtë proces. Komisioni e shton dozën ironike duke theksuar se “nuk mund të shndërrohet në instrument për plotësimin e dëshirave personale”. Këtu qëndron edhe konfuzioni më i madh, ngase reagimi qytetar konsiderohet si reagim personal.

“Komisioni shtetëror sipas mandatit që ka, realizoi detyrën me përkushtim profesional, me dinjitet, me ndërgjegje të pastër dhe me përgjegjësi të plotë kombëtare dhe shtetërore. Komisioni gjatë procesit të shënimit të vijës kufitare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi, ka pasur në konsideratë kujdesin maksimal ndaj pronave në zonën kufitare, duke kërkuar nga secili pretendues të bëjë kufizimin e pronës në terren sipas dokumentacionit që ka, pasi disa herë ka mbajtur takime me banorët e zonës kufitare, së bashku duke shqyrtuar shqetësimet e tyre. Në këtë aktivitet, qytetarët e komunave të Junikut, Deçanit dhe Istogut në territorin e Malit të Zi, për të cilët kishte dokumentacion, janë përkufizuar atje, andaj duke i falënderuar bashkëpunimit të qytetarëve tani ata kanë pronat në pronësi dhe janë duke i shfrytëzuar pa asnjë pengesë” (Pjesë nga “*Informata e Komisionit shtetëror për shënimin dhe mirëmbajtjen e kufirit shtetëror*”, 17 janar 2015)

Nga kjo informatë, në njerën anë, Komisioni kritikon debatet folklorike, ndërsa në anën tjetër vetes i jep të drejtë të mbështetet në përgjegjësi kombëtare dhe shtetërore. Nga kjo informatë vërehet qartazi se vija e përcaktimit të demarkacionit është shndërruar në një çështje tejet kadastrale. Harrohet se çështjet kadastrale ndërlidhën me qartësinë e pronave në mes njësive administrative dhe se demarkacioni në mes dy shteteve duhet të vihet në korniza të parimeve të përgjithshme ndërkombëtare.

¹⁰Prof. dr. Murat Meha - Kryetar, Dr. Sylë Ukshini, Prof. dr. Tefik Basha, Shaban Guda, Besim Kajtazi

Reagimi qytetar

Sa më tepër që dilnin në opinion informata për rrjedhën e bisedave mbi demarkacionin Kosovë - Mali i Zi, aq më shumë dilnin në sipërfaqe shqetësimet për epilogun e këtij procesi. Tani kur paralajmërohet përfundimi i procesit dhe inicimi i marrëveshjes mbi demarkacionin Kosovë - Mali i Zi, situata bëhet edhe më shqetësuese. Kjo ka të bëjë, në radhë të parë, me shqetësimet profesionale dhe të komunitetit dhe të komunave që do të afektohen (Peja, Juniku, Deçani dhe Istogu). Në një situatë të tillë ka ndikuar edhe përcaktimi i vijës kufitare në mes Kosovës dhe Maqedonisë, me ç'rast Kosova ka bërë koncesione territoriale të papranueshme. Në një periudhë kohore përfaqësues të Komisionit Shtetëror kanë dhënë deklarata se Kosova nuk do të humbë asnjë pëllëmbë toke në këtë proces. Në këtë ton ishin edhe deklaratimet e disa përfaqësuesve të Qeverisë në seancat e Kuvendit të Kosovës.



Fig. 6. Vija kufitare pretenduese e Malit të Zi

Megjithatë, të parët që ngritën zërin kundër kësaj mënyre të funksionimit të Komisionit Shtetëror ishin banorët e Rugovës. Ata në protesta të organizuara në Pejë dhe rrethinë paralajmëruan edhe reagime të ashpra, nëse procesi shkon në dëm të Kosovës dhe nëse takimet vazhdojnë të bëhen sipas propozimit të palës malaziasë. Qytetarët besojnë se sipas propozimit malazias, Kosova do të humbasë rreth 9.000 hektarë tokë të veten. Brengë tjetër e komunitetit është se me këtë proces do të rrezikohen faktorë të rëndësishëm ekonomikë lokalë (malet, bagëtia, ujërat dhe bota bimë). Komuniteti sugjeron që procesi të ndërpritet, ngase nuk mund të sjellë vijë natyrore në pajtim me hartat e verteta të Kosovës. Çështja e përcaktimit të vijës kufitare nga të gjitha palët e interesuara ndërlidhet me Kushtetutën e vitit 1974. Në të vërtetë, Kushtetuta e vitit 1974 e

sanksionon vijën kufitare të përcaktuar në vitin 1945 dhe 1958 dhe e zyrtarizuar me publikim në Enciklopedinë e Jugosllavisë, viti 1962. “Kërkohet nga institucionet e Republikës së Kosovës, presidentja, Kuvendi i Kosovës dhe Qeveria, që me rastin e demarkacionit të kufirit në mes Kosovës dhe Malit të Zi, çështja të trajtohet konform me Kushtetutën dhe me ligjet e Republikës së Kosovës, që procesi i demarkacionit të jetë plotësisht transparent për qytetarët e Republikës së Kosovës dhe posaçërisht për zonat që përfshihen dhe janë pjesë e demarkacionit. Kuvendi i Komunës së Pejës iu bën thirrje institucioneve qendrore që të rishikojnë punën e deritanishme të Komisionit për shënimin dhe mbikëqyrjen e kufirit” (Pjesë nga konkluzionet e Kuvendit Komunal të Pejës, maj 2015)

(Pjesë na konkluzionet e Kuvendit komunal të Pejës, maj 2015) Në reagimet e tyre, qytetarët e zonave të prekura janë të shqetësuar me pretendimet e palës malaziasë, e cila tregon aspirata për lëvizjen e kufirit të Kosovës deri në 5 – 6 kilometra në thellësi të Kosovës. Në këtë aspekt duhet theksuar edhe pengesat që u bëjnë autoritetet malaziasë në shfrytëzimin e resurseve lokale dhe në veçanti të mbajtjes së bagëtive në kullosat e tyre. Kjo ka të bëjë edhe me presionet e pushtetit malaziasë që të largohen banorët nga pronat e tyre. Kjo ndërhyrje në territorin e Kosovës ka shkuar aq larg, sa që janë dëmtuar edhe varrezat shqiptare. Të ndodhur në një situatë të mungesës së transparencës së procesit dhe të mungesës së komunikimit të aktorëve, banorët disa herë kanë vizituar institucionet e Kosovës për të parandaluar ndërhyrjen e Malit të Zi në integritetin territorial të Kosovës. Sa më tepër që paralajmërohet përfundimi i bisedimeve lidhur me demarkacionin, aq më tepër janë duke u ashpërsuar qëndrimet e qytetarëve dhe të komuniteteve të afektuara. Edhe tani në disa fashatra të Rugovës dhe të Podgurit janë duke u mbajtur tubime me qytetarë me kërkesa për ndërprerjen e këtyre bisedimeve dhe vendosjen e tyre në një platformë të qëndrueshme profesionale. Në anën tjetër dëgjohen deklarata se Kosova dëshiron të krijojë marrëdhënie të mira me Malin e Zi. Edhe qytetarët janë në favor të marrëdhënieve të mira me Malin e Zi, por jo duke bërë koncesione territoriale.

Edhe komunat e Kosovës, që afektohen nga përcaktimi i vijës kufitare Kosovë - Mali i Zi, kanë reflektuar shqetësimet lidhur me punën e deritanishme të Komisionit qeveritar. Ato vlerësojnë se nuk janë përfshirë sa duhet në rrjedhën e bisedave lidhur me këtë çështje! Kështu, në maj 2015, Kuvendi Komunal i Pejës ka aprovuar një Konkluzion me të cilin kërkohet që të merren në konsideratë ligjet dhe Kushtetuta e Kosovës, që Komisioni të shfytëzojë të dhënat arkivore, të merren parasysh shqetësimet e banorëve, dhe të rishikohet puna e deritanishme e Komisionit qeveritar.

Konkluzionet

Në kuadër të angazhimeve të veta institucionet e Kosovës tre vjet më parë kanë formuar Komisionin shtetëror, i cili ka mbajtur shumë takime me palën malaziasë për të vendosur vija kufitare të pranueshme për të dy palët. Tani kur paralajmërohet përfundimi i këtyre bisedave, sa vijnë e shpërfaqen pakënaqësi nga ana e opinionit të gjerë mbi kredibilitetin e këtij procesi! Në kohë të fundit këto shqetësime janë shndërruar në reagim refuzues të hapur të qytetarëve. Kjo ka ndodhur si rezultat i mungesës së komunikimit të aktorëve institucionalë e të shoqërisë civile dhe i mungesës së transparencës. Kjo ka krijuar paqartësi edhe në opinion të gjerë lidhur me ecurinë e bisedave.

Pala malaziasë në takimet e deritanishme ka ofruar një propozim për vijën e Demarkacionit në bazë të, gjoja, pronësisë, gjë që nuk është esenciale në lidhje me çështjen në fjalë. Tërheqja e vijës kufitare është e domosdoshme dhe me rëndësi ndërshtetërore dhe ndërkombëtare. Është e nevojshme që institucionet shtetërore të Kosovës të krijojnë një pozicionim të qartë të vetin si bazë të diskutimeve të mëtejme.

Me qëllim që të tejkalohen situatat e pakëndshme, situata këto që mund t'i dëmtojnë raportet miqësore, është e nevojshme që sa më parë pala malaziasë të ndërpresë punimet në infrastrukturë (rrugët, urat), në vendosjen e shenjave të kufirit, të komunikacionit dhe çfarëdo intervenimi me projekte që e cenojnë vijën kufitare të Kosovës). Me këtë rast, me qëllim që të evitohen konfliktet potenciale, të largohen forcat policore nga zonat pretenduese të Malit të Zi.

Meqë vija kufitare në mes Kosovës dhe Malit të Zi është punuar

shumë më herët, sesa Kushtetuta e vitit 1974, komisioni duhet t'iu përmbahet dokumentacioneve hartografike relevante të kohës. Aq më tepër, kur dihet se në atë kohe kufiri nuk është përpiluar nga ekspertët shqiptarë, por nga qendrat e specializuara hartografike ushtarake të ish - Jugosllavisë! Këto harta topografike duhet të inkorporohen në vendimin përfundimtar të Demarkacionit kufitar Kosovë – Mali i Zi, duke plotësuar të gjitha kërkesat e të dy palëve në bisedime. Çfarëdo intervenimi në kufirin Kosovë - Mali i Zi në periudha të mëvonshme, pa prezencën e grupit punues kosovar, duhet të jetë i papranuar dhe i papërfillshëm, duke përfshirë edhe ndonjë vijë kufitare në vitet e 80 - ta (pas demonstratave të vitit 1981). Prandaj i rekomandohet Komisionit përkatës shtetëror, që të konsultojë Enciklopedinë e Jugosllavisë të botuar në fillim të vitit 1963, ku gjenden hartat topografike 1:100 000.

Tërheqja e vijës me përshkrim të kualitetit të vijës natyrore sipas një ecurie reale duhet të kuptohet koncepti i përgjithshëm i demarkacionit, me ç'rast duhet të merret parasysh një demarkacion i mëparshëm që përputhet me kriterin e vijës kufitare, në rastin tonë harta e botuar në Enciklopedinë e Jugosllavisë të viti 1962. Kjo pikënisje ndihmon zbulimin e specifikës së temës. Pra, demarkacioni e ka metodën e vet të analizës dhe të sintetizimit në këso rastesh konkrete si ajo në mes shtetit të Kosovës dhe shtetit të Malit të Zi.

Duhet theksuar se majat si pika dhe korrizet si vija të ndarjeve ujore janë determinuar për një demarkacion të natyrshëm. Mbi të gjitha vendbanimet sezonale dhe të përhershme si dhe etnike dhe etnografike, kurorëzohen në vijën e demarkacionit të natyrshëm.

Mbajtja nën kontroll e të gjitha pikave strategjike (Bjelluha, Leposaviqi, Mitrovica, Kosova e Lindjes). Për synim kishin ekspansionin pansllav. Edhe tani gjatë demarkacionit Kosovë -

Mali i Zi dhe i demarkacionit të ardhshëm Kosovë – Serbi, do të manifestohen tendenca të tilla ekspansioniste.


Vija kufitare në mes Kosovës dhe Malit të Zi është punuar shumë më herët sesa Kushtetuta e vitit 1974, prandaj nuk mund të merren qëndrime përfundimtare në lidhje me demarkacionin kufitar pa analizuar historikisht ndryshimet e mundshme të kufirit. Kufiri mes Kosovës dhe Malit të Zi, i prezantuar në hartat topografike të vitit 1958, nuk është përpiluar nga ekspertët dhe politikanët shqiptarë, por nga qendrat e specializuara hartografike ushtarake të ish - Jugosllavisë, prandaj nëse kërkohet që shpërbërja e ish- Jugosllavisë duhet të bëhet me kufi që kanë qenë gjatë ekzistimit të saj, atëherë këto harta duhet të jenë vendimtare.

Edhe pse ky kufi i dëmshëm në aspektin etnik, sepse popullatën shqiptare e ndan në dy njësi administrative, ai është i përshtatshëm në aspektin morfologjik dhe i plotëson të gjitha kushtet shkencore dhe praktike që të pranohet për propozim final të demarkacionit kufitar mes Kosovës dhe Malit të Zi.

Bazuar në këto fakte, duhet të bëhet presion në Komisionin malazias që këto harta topografike patjetër të inkorporohen si bazë mbi të cilat do të rivizatohet vija kufitare Kosovë – Mali i Zi!

Nëse palët kanë pozicione të papajtueshme dhe nëse nuk shihet përfundimi i suksesshëm i përcaktimit të vijës së Demarkacionit, propozojmë që kjo çështje të bartet për zgjidhje në Arbitrazhin Ndërkombëtar. Kjo nuk do të ishte asgjë e re, ngase, ndër të tjera, një kontest kufitar në mes Kroacisë dhe Sllovenisë pritet të ketë epilog në këtë vit nga Arbitrazhi ndërkombëtar. Porse edhe në rrethana të këtij kontesti, Sllovenia nuk e ka penguar anëtarësimin e Kroacisë në NATO dhe në BE!

SHTOJCAT



Burimi; Enciklopedija NR Jugoslavije,
Naklada Leksikografski Zavod FNRJ, Zagreb 1962



Burimi: Enciklopedija NR Jugoslavije, Naklada Leksikografski
Zavod FNRJ, Zagreb 1962



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government
Komisioni Shtetëror për Shënjimin dhe Mirëmbajtjen e Kufirit Shtetëror
Državna Komisija za Obeležavanje i Održavanje Državne Granice
State Commission for Demarcation and Maintenance of State Borders

Datë: 12.05.2015

Nr. prot.17-1/2015

INFORMATË

nga

KOMISIONI SHTETËROR PËR SHËNJIMIN DHE MIRËMBAJTJEN E KUFIRIT SHTETËROR.

(REPUBLIKË E KOSOVËS - MALI I ZI)

1. Hyrje

Debati i ngritur së fundi rreth kufijve të Kosovës, që është ngrehur nga njerëz të caktuar, është një temë me të cilën as nuk mund të bëhet politikë ditore dhe as nuk mund të bëhet patriotizëm, por kjo është çështje që duhet trajtuar publikisht nga profesionistët mbi bazën e dokumentacionit relevant. Çështja e përcaktimit të kufijve është një kriter i shtetësisë edhe sipas të drejtës ndërkombëtare. Siç dihet, një ndër tri kriteret themelore për shtetësi sipas së drejtës ndërkombëtare është territori i përkufizuar qartë, kriter ky të cilin Kosova e plotëson. Kufijtë e Kosovës janë të përcaktuar me Kushtetutën e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës (KSAK) të vitit 1974, sipas së cilës, kufijtë administrativ brenda RSFJ janë shndërruar në kufijtë ndërkombëtarë që është duke u zbatuar në këtë proces.

Që nga qershori 1999 kufijtë e Kosovës kontrollohen bashkërisht nga autoritetet e Kosovës (IPVQ), UNMIK-u dhe KFOR-. Korniza kushtetuese për vetëqeverisje të përkohshme e vitit 2001 më tutje përkufizon Kosovën si "territor i pandashëm". Grupi i Kontaktit ka përjashtuar opsionin e ndarjes së Kosovës si mundësi e zgjidhjes së statusit (Grupi i Kontaktit 2006: Neni 6).

Një fakt i tillë është kodifikuar edhe me Planin e Ahtisarit, i cili përbënë bazamentin e pavarësisë dhe të kushtetutës së Kosovës. Shumë vende të botës kanë paqartësi të kufijve rreth territorit të kontestuar, Kosova ka pasur përherë qartësi të kufijve dhe me përjashtim të Serbisë, asnjë vend tjetër në rajon nuk ka ndonjë kontest kufitar me Kosovën, madje në këta kufinjë të gjitha shtetet fqinje e kanë njohur pavarësinë e Kosovës. Prandaj, pavarësisht pretendimeve të Serbisë për korrigjim të kufijve, një gjë e tillë nuk ishte pranuar as nga Komisioni i Badinterit. Për më tepër, kufijtë e Kosovës nuk janë historik dhe që kanë kontinuitet nga koha e pushtimit të saj nga Serbia me 1912. Pas Luftës së Dytë Botërore

pushteti komunist, vendosi njësinë historike administrative-geografike Kosovën sikurse edhe për njësitë tjera kufiri i Kosovës, njihet si kufi administrativ nga Jugosllavia. Në këtë aspekt, kufiri Kosovë-Mali i Zi pas vitit 1945 është kryesisht i njëjtë.

sipas Kushtetutës së fundit jugosllave të vitit 1974 dhe i verifikuar nga marrëveshjet ndërkombëtare.

Prandaj, ndryshimet e supozuara se ka shmangie nga kufiri i vitit 1974, nuk janë të dokumentueshme me dokumente përkatëse legale, politike e historike. Retorika folklorike nuk bënë punë në këtë çështje, përkundrazi dëmtton realizimin e detyrës institucionale të palës kosovare. Komisioni shtetëror ka përgjegjësi para institucioneve qendrore të Republikës së Kosovës sipas ligjit për kufij dhe marrëveshjes ndërkombëtare, për shënjimin e vijës ekzistuese të kufirit nga Krahina Socialiste Autonome e Kosovës. Ky komision nuk mund të shndërrohet në instrument për plotësimin e dëshirave personale. Po ashtu, duhet qartësuar se Komisioni Shtetëror i Kosovës nuk ka mandat për "korrigjim" të kufijve të vendosur gjatë historisë në kongrese dhe konferenca ndërkombëtare, pavarësisht se asokohe këto vendime kanë qenë të padrejta dhe kanë lënë jashtë kufijve shtetë shqiptar një pjesë të madhe të territorit shqiptar.

Tani që Kosova është shtet i pavarur dhe që nga dita në ditë po bëhet pjesë e institucioneve ndërkombëtare, është detyrim kushtetues dhe obligim ndërkombëtar që të shënojnë vijën kufitare me çdo shtet fqinjë dhe në këtë drejtim, pos me Serbinë, me shtetet tjera, në këtë mes edhe me Malin e Zi, mund të thuhet se nuk ka asnjë kontest.

Republika e Kosovës dhe Mali i Zi, si dy shtetet fqinje të etabluara gjatë procesit të shpërbërjes së Jugosllavisë, janë dy vende që kanë synime dhe aspirata të përbashkëta për integrimin e rajonit si parakusht për integrimin Euroatlantik. Në këtë kontest, duke u mbështetur në normat kushtetuese vendore dhe ndërkombëtare, dy shtetet kanë marrë si detyrim çështjen e shënimat të vijës kufitare në mes veti, si dy shtete sovrahe dhe të pavarura, domethënë për shënjimin e vijës kufitare së dikurshëm administrative në kufi ndërkombëtar. Komisionet e ngritura nga dy Qeveritë, duhet të shënojnë vijën kufitare në mes tyre, në kufijtë e dikurshëm administrativ, krahinor e republikan të cilët shndërrohen në kufij shtetëror ku do të pranohen ndërkombëtarisht.

2. Mandati i Komisionit shtetëror dhe përgjegjësitë.

Qeveria e Republikës së Kosovës, në pajtim me Nenin 40 të Ligjit Nr. 04/L-072 për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror, më 21 mars të vitit 2012, ka themeluar Komisionin Shtetëror për Shënjimin dhe Mirëmbajtjen e Kufirit Shtetëror. Gjithashtu, në Mbledhjen e 140 të Qeverisë së Republikës së Kosovës me Vendimin nr. 03/140 me datë 17.07.2013 Qeveria ka miratuar Rregulloren QRK - nr. 17/2013 për Punën e Komisionit Shtetëror për Shënjimin dhe Mirëmbajtjen e Kufirit Shtetëror. Komisioni shtetëror për Shënjimin dhe mirëmbajtjen e Kufirit shtetëror është i emëruar nga Qeveria e Republikës së Kosovës me mandatin, për shënjimin dhe mirëmbajtjen e kufirit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi në pajtim me marrëveshjen ndërkombëtare. Marrëveshja ndërkombëtare është pakjoja e Ahtisari 2007, Aneksi VIII, Sektori i Sigurisë në Kosovë, Neni 3 alineja 2. Kufiri i KSAK 31 Dhjetor 1988. Kjo vijë kufitare sipas Pakos së Ahtisarit dhe në bazë të deklaratës mbi shpalljen e pavarësisë së Kosovës, me 17. Shkurt 2008, është në përputhje të plotë me Kushtetutën e vitit 1974. Kjo përputhshmëri e të dhënave për vijën kufitare në periudhat e lartcekura vërtetohet në bazën e të dhënave në Kadastrin dhe në



ALEANCA PËR ARDHMËRINË E KOSOVËS
ALLIANCE FOR THE FUTURE OF KOSOVO

ZYRA E KRYETARIT / OFFICE OF THE CHAIRMAN

Për:

Znj. Atifete Jahjaga, Presidente e Republikës së Kosovës
z. Kadri Veseli, Kryetar i Kuvendit
z. Isa Mustafa, Kryeministër i Qeverisë
z. Hashim Thaçi, Ministër i Jashtëm dhe Zv/Kryeministër i Qeverisë

Nga:

Ramush Haradinaj, Deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës

Lënda: Kërkesë për pezullimin e nismës për lidhjen e Marrëveshjes mes Kosovës dhe Malit të Zi për demarkacionin e kufirit

Data: 5 gusht 2015

Vendi: Prishtinë

Të nderuar znj. Presidente Jahjaga, Kryetar i Kuvendit z. Veseli, Kryeministër z. Mustafa dhe Zv/kryeministër z. Thaçi,

Kërkoj nga ju që ta pezulloni Nismën për lidhjen e marrëveshjes për demarkacionin e kufirit ndërmjet Kosovës dhe Malit të Zi, për shkak të korrupsionit të këtij procesi. Njëkohësisht kërkoj që të përdorni autoritetin tuaj, menjëherë ta shkarkoni Kryetarin e Komisionit Qeveritar për Demarkacionin e Kufirit, për shkak të shpërdorimit nga ana e tij të këtij procesi si dhe përfshirjes së tij në afëra korruptive në cilësinë e Kryetarit të Agjencisë kadastrale të Kosovës.

Druaj se çështja është tepër e ndjeshme dhe kërkon masa urgjente institucionale.

Më poshtë po i jap disa arsye të kërkesës sime:


- I. Territori i shtetit paraqet kategori kushtetuese të përcaktuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, respektivisht Kapitullin I mbi Dispozitat Themelore, neni 2, paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në të cilën theksohet pacenueshmëria dhe mbrojtja, me çdo mjet të paraparë me Kushtetutë dhe ligj, të integritetit territorial të Republikës së Kosovës.



ALEANCA PËR ARDHMËRINË E KOSOVËS
ALLIANCE FOR THE FUTURE OF KOSOVO

ZYRA E KRYETARIT / OFFICE OF THE CHAIRMAN

- II. Çështja e demarkacionit të kufirit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Malit të Zi, në bazë të zgjidhjes së propozuar nga Kryetari i Komisionit qeveritar për shënjimin e kufirit, është plotësisht në dëm të Republikës së Kosovës.
- III. Megjithatë kërkesat e vazhdueshme për ta zgjidhur këtë çështje në mënyrë të drejtë, ofrimit të dokumenteve të vlefshme, si dhe argumenteve të arsyeshme e të parashtruara në rrugë institucionale, miratimi i nismës nga ana e Qeverisë së Kosovës për arritjen e marrëveshjes mes Kosovës dhe Malit të Zi, për shënjimin e kufirit mes dy shteteve, siç është propozuar aktualisht, bie ndesh me Kapitullin I mbi Dispozitat Themelore, Neni 2, Paragrafi 2 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
- IV. Me këtë akt është cenuar dhe tjetërsuar sovraniteti dhe integriteti territorial i Republikës së Kosovës.
- V. Ne disponojmë të dhëna të besueshme se i tërë procesi i ndërlidhur me demarkacionin kufitar ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Malit të Zi, në bazë të zgjidhjes së propozuar nga Kryetari i Komisionit qeveritar për shënjimin e kufirit me Malin e Zi, është jokredibil, i shantazhuar dhe po rezulton mbi bazën e favoreve dhe përfitimeve personale e grupeve.
- VI. Për më tepër ky proces i udhëhequr nga z. Murat Meha, i cilësuar publikisht si i inkriminuar në korruption, zhvatje dhe keqpërdorime në cilësinë e Kryeshefit të Agjencisë Kadastrale e Kosovës, është plotësisht i papranueshëm dhe jo kredibil.
- VII. Ne besojmë se dëshmitë e paraqitura në opinion, qoftë për shpërdorimet nga ana e z. Meha në Agjencinë Kadastrale të Kosovës, qoftë me manipulimin e hartave për demarkacionin e kufirit me Malin e Zi, janë argumente të mjaftueshëm që Institucionet e Republikës së Kosovës, urgjentisht ta shkaktojnë z. MURAT Meha nga funksioni që ka.
- VIII. Ju njoftoj se njëkohësisht do të kërkojmë që Prokuroria e Shtetit të fillojë hetimet ndaj z. Meha, për shpërdorim detyre, inkriminim, korruption, zhvatje dhe keqpërdorime si kryeshef i Agjencisë Kadastrale e Kosovës dhe shpërdorim detyre në cilësinë e Kryetar i Komisionit Qeveritar për shënjimin e vijës kufitare me Malin e Zi, për çka ne si Aleancë do të inkurojojmë të gjithë ata që posedojnë dëshmi inkriminuese t'i dorëzojnë në Prokurori.

Sinqerisht,

Ramush Haradinaj
Kryetar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës
Deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEÇ

Në bazë të nenit 11 të Ligjit Nr.03/L – 040 Për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28.datë: 04.qershor 2008") dhe nenit 8 të Statutit të Komunës së Pejës, 01.Numër: 09 – 8103 datë: 29.shtator 2008, Kuvendi Komunal Pejë, në takimin e jashtëzakonshëm të mbajtur me datë: 13.Mars 2015, pas informimit dhe diskutimit lidhur me çështjen e Demarkacionit të kufirit mes Kosovës dhe Malit të zi, për pjesën që përfshin me demarkacion Komunën e Pejës, nxjerrë këtë

KONKLUZION

- I. Kërkohej nga institucionet e Republikës së Kosovës, Presidentja, Kuvendi i Kosovës dhe Qeverija, që me rastin e demarkacionit të kufirit mes Kosovës dhe Malit të zi, çështja të trajtohet konform Kushtetutës dhe ligjeve të Republikës së Kosovës, që procesi i demarkacionit të jetë plotësisht transparent për qytetarët e Republikës së Kosovës dhe posaqerisht për zonat që përfshihen dhe janë pjesë e demarkacionit.
- II. Kërkohej që Komisioni shtetror për shënimin dhe mirëmbajtjen e kufirit shtetror, që gjatë procesit në zbatim të demarkacionit të kufirit të marrë parasysh të gjitha të dhenat shtetrore dhe arkivore, kadatsrale si dhe të dhenat që disponon Komuna e Pejës, dhe qytetarët e saj, e që janë relevante për shqyrtim dhe vendosje të drejtë të vijës kufitare, që të mirren në shqyrtim nga komisioni dhe që njëkohësisht të interpretohen drejtë e të njoftohen qytetarët dhe institucionet komunale lidhur me qendrimin e komisionit për faktet e ofruara.
- III. Gjatë procesit të demarkacionit të kufirit Komisioni duhet të marrë parasysh seriozisht shqetësimet e banorëve, respektivisht të pronarëve të paluajtshmerive dhe pronat publike që gjenden në zonat që përfshihen me demarkacion.
- IV. Me rastin e shenimit të kufirit tani ndërshtetror në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Malit të zi, Komisioni njëkohësisht duhet të ketë parasyshë ndarjen administrative kufitare nga vitit 1974 dhe të ketë varijantin e tij për demarkacion të kufirit, duke respektuar të drejten universale mbi të drejten e pronës.
- V. Kuvendi i Komunës së Pejës, Ju ben thirje institucioneve qendrore që të rishikojnë punën e deri tanishme të Komisionit, për shënimin dhe mirëmbajtjen e kufirit.
- VI. Nëse vendoset demarkacioni në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të zi, në demë të qytetarëve, për në si Komunë, do të jetë I pa pranushëm një vendim i till.
- VII. Ky konkluzion hynë në fuqi ditën e miratimit nga kuvendi.

I.Numër: 06 - 34000


Pejë, date: 13. Mars 2015.

KUVENDI KOMUNAL PEJË



KRYESUESI,
Dr. Islam Husaj

FTESË PËR TUBIM INFORMUES



Demarkacioni i kufirit me Malin e Zi

**Për shkak të situatës së krijuar rreth kufirit me Malin e Zi
ftojë qytetarët e Podgurit dhe Fshatërave për rreth
(Novosellë, Radac, Jabllanicë e Madhe, Jabllanicë e Vogël)
Tubimi do të mbahet me datën 09.08.2015 në
Restaurant "Antika" në Vitomiricë
prej orës 19:00 zgjatë 1 orë
Pjesmarrja masovike e juaja tregon shqetësimin për këtë
tokë të bukur dhe të vlefshme të Kosovës**

**Këshilli organizativ
Ju faleminderit përmirëkuptim!**

ËSHTË MBAJTUR DISKUTIMI ME TEMËN "DEMARKACIONI KOSOVË-MALI I ZI: SFIDAT, KOMUNIKIMI DHE TRANSPARENCA"

Banorët paralajmërojnë "luftë" nëse Qeveria pranon vijën e Malit të Zi

Në diskutimin "Demarkacioni Kosovë-Mali i Zi: sfidat, komunikimi dhe transparencja", banorët e zonave kufitare me Malin e Zi kanë paralajmëruar "luftë" në rast se institucionet e Kosovës pranojnë vijën teknike të kufirit që është prezantuar nga Mali i Zi, e që, sipas tyre, cenon më shumë se 12 mijë hektarë tokë të Kosovës. Ndërkohë që njëra nga konkluzionet e kësaj tryeze ka qenë që nëse çështja e demarkacionit me Malin e Zi nuk zgjidhet me pajtueshmëri, atëherë të dërgohet në Gjykatën e Arbitrazhit

Norë Shabani

Peshkopi, 24 qershor – Banorët e zonave kufitare me Malin e Zi kanë paralajmëruar "luftë", në rast se institucionet e Kosovës pranojnë vijën teknike të kufirit në mes të Kosovës dhe Malit të Zi, që është prezantuar nga Republika e Malit të Zi, e që, sipas tyre, cenon më shumë se 12 mijë hektarë tokë të Kosovës, që shtrihen kryesisht në Komunën e Pejës, Isogut dhe atë të Deçanit.

Në diskutimin "Demarkacioni Kosovë - Mali i Zi: sfidat, komunikimi dhe transparencja", që është organizuar nga Qendra për Promovimin e Zhvillimit, fondacioni "Friedrich Ebert" dhe kolegji evropian "Juridica", banorët kanë kërkuar ndërrim të anëtarëve të Komisionit Shtetëror për shënjimin dhe mirëmbajtjen e kufirit shtetëror, të cilit, sipas organizatorëve, nuk i janë përgjigjur hësës për pjesëmarrje në këtë diskutim.

Ndërkohë që njëra nga konkluzionet e kësaj tryeze ka qenë që nëse çështja e demarkacionit me Malin e Zi nuk zgjidhet me pajtueshmëri, atëherë çështja të dërgohet në Gjykatën e Arbitrazhit. "Nëse palet kanë pozicione të pajtueshme dhe nëse nuk shihet përfundimi i suksesshëm i përcaktimit të vijës së demarkacionit, propozojmë që kjo çështje të bartet për zgjidhje në Arbitrazhin Ndërkombëtar. Kjo nuk do të ishte asgjë e re, ngase, ndër të tjera, një kontest kufitar në mes Kroacisë dhe Sllovenisë pritet të jetë epilog në këtë vij nga Arbitrazhi Ndërkombëtar", thuhet në konkluzionet e tryezës.

Banori i Rugovës, Daut Morina, ka thënë se deputetët e Kuvendit duhet ta dinë se banorët e atyre zonave nuk do të pajtohen me vijën e prezantuar nga Mali i Zi. "Me harat që po i qesin në internet m'u kanë afër aty tek stani im, që dal unë që 60 vjet aty. A thua kujt i kemi borxh ne? Kush janë ata persona që i kanë borxh Malit të Zi për me folë kufirin. Zotërinjtë kanë luftuar më herët, kanë luftuar edhe viteve të fundit. Mali i Zi na ka djeg historikisht dhe ne tash i falim tokë. Nuk i kemi ne borxh askujt dhe na vranë Zoti me ba një gjë të tillë", ka thënë Morina.

Morina ka paralajmëruar institucionet të mos e miratojnë vijën e propozuar. "Nëse kjo qeveri merret vesh me atë qeveri, neve do të na shpëjë në luftë. Nuk i kemi borxh na Qeverisë, nëse Qeveria i ka borxh dikujt le t'ia japë borxhin e vet. Populli nuk ka t'ia një hak me tokë. Ne çdo ditë jemi aty dhe në momentin që ata (policia malazeze vj.) vijnë, na kemi me u vra me ta. Nëse doni të na leni me u vra, paçi faqen e zezë i pari dhe i fundit", ka thënë Morina.

Banori tjetër i kësaj zone, Sali Lukaj, është shprehur i bindur se nëse nuk ndërrohet kryetari i Komisionit, Murat Meha, kërkesat e tyre, sipas tij, të bazuar në faktë, nuk do të pranohen. "Kur ai ka qenë në Kuvendin e Pejës, në një seancë ai më shumë e ka mbrojtur Malin e Zi. Krijonte përshytyrje se mos është i paguar nga Mali i Zi që ta mbrojtë atë sesa palën e vet shqiptare. Unë mendoj që deputetët duhet të kërkojnë që të ndërrohet ai, sepse pa ndërrim të tij nuk ka asgjë. Po të ishin këtu, do të ishin blasfuar me

fjalë e tij", ka thënë Lukaj.

E anëtarët e Komisionit Shtetëror për shënjimin dhe mirëmbajtjen e kufirit shtetëror nuk kanë marrë mundin që t'i dëgjojnë kërkesat e banorëve të këtyre zonave. Ata fshesë për të marrë pjesë në diskutim i janë përgjigjur me një "informa" të shkruar, prej nëntë faqesh, në të cilën kanë shkruar për debatin që është ngritur për demarkacionin e kufirit me Malin e Zi.

"Debati i ngritur së fundmi rreth kufijve të Kosovës, që është ngritur nga njerëz të caktuar, është një temë me të cilën as nuk mund të bëhet politike ditore dhe as nuk mund të bëhet patriotizëm, por kjo çështje duhet trajtuar publikisht nga profesionistë mbi bazën e dokumentacionit relevant", thuhet në hyrje të informatës, që është e nënshtuar nga anëtarët e Komisionit: Murat Meha, Sylë Ukshini, Tefik Basha, Shaban Guda dhe Besim Kajazi.

Më tej thuhet se kufijtë e Kosovës janë të përcaktuar me Kushtetutën e Kroshirës Socialiste Autonome të Kosovës të vitit 1974. Në këtë informata më tej thuhet se Komisioni është emëruar nga Qeveria me mandatin për shënjimin dhe mirëmbajtjen e kufirit në mes të Kosovës dhe Malit të Zi, siç thuhet në pajtim me marrëveshjen ndërkombëtare. Në këtë pjesë citohet kufiri i KSAR-së i vitit 1985. "Marrëveshja ndërkombëtare është pakjoja e Abhtisatit 2007, Anexit VIII, Sektori i sigurtisë në Kosovë, Neni 3, alineja 2. Kufiri i KSAR-së 31 dhjetor 1988", thuhet në informatë. Pas kësaj thuhet se kufiri i vitit 1988 është i njëjtë me atë të vitit 1974, gjë me të

cilit nuk janë duke u pajtuar banorët e zonave kufitare me Malin e Zi.

Përfaqësuesi i banorëve të këtyre trevave, Ali Lajçi, ndryshimet që sipas tij përbëjnë këto hara i ka parqitur në fillim të muajit edhe tek kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli.

Ndërkohë që në tryezën e mbajtur të mërkurës, Lajçi ka parqitur dy hara, nëpërmjet të cilave ai ka sipërgjeguar dallime, sipas tij, në mes të asaj se si ka qenë kufiri dhe se si po pretendon Mali i Zi.

"Krejt prona shtetërore, prona e karakterit... pastaj prona me certifikata pronësie, prona me besim në suadër të Malit të Zi, kriter ky që është jashtë mase i veçkulluar. Pra, prona shtetërore po merret direkt, komplet nga Mali i Zi, që të jetë kufi nacional. Komisioni ynë thotë se ka edhe një shkarje, thotë se ka marrë bazë kadastrat nacionale, sigurisht, por këtu nuk janë kufi komunalë por shtetërore", ka thënë Lajçi.

Edhe Lajçi ka kërkuar që përberja e Komisionit Shtetëror të ndryshohet. "Kuvendi kurrsesi ta mbështetë atë raport, se unë jam që kjo të mos shkojë në Kuvend, duhet Komisioni Shtetëror të reflektonte, kryeministri i cili është padron i tij ta ndalë, dhe në qoftë se Mali i Zi nuk e do këtë propozim, atëherë të shkojmë në Arbitrazh t'i shpërzojmë mekanizmat e tjerë të mundshëm... kufijtë nuk mund të lëvizin jashtë kësaj harte", ka thënë Lajçi.

Deputeti i "Vetëvendosjes", Rexhep Selimi, ka thënë se ai nuk beson që një marrëveshje e tillë çesuese do të votohet në Kuvendin e Kosovës. "Bëhet fjalë për 7 mijë

hektarë në pjesën e Rugovës, për 5 mijë e 300 hektarë në pjesën e Podgutit, pra nuk bëhet fjalë për një kodër e për një livadhi. Besoj që një marrëveshje e tillë nuk do të rritet në Kuvendin e Kosovës, shpresoj shumë, unë jam njëri prej tyre, por jo i vetmi, ka edhe kolegë që nuk do ta pranojnë, por do të ishte mirë që të mos një deni aq", ka thënë Selimi.

Ai e ka kritikuar edhe informatinë e dërguar nga Komisioni Shtetëror "E lexova një informata të Komisionit dhe u ndjeva keq, sepse qysh në hyrje thuhet se 'debati i ngritur në fundin rreth kufijve' nuk është debat i ngritur së fundmi rreth kufijve. Thotë që është ngritur nga disa njerëz të caktuar, nuk janë disa njerëz të caktuar është një komunitet, është një e drejtë e jona", ka thënë Selimi. "Kur e shoh këtë informata të Komisionit, më duket që ai është një avokat i mirë i qendrimeve që ka Mali i Zi karshi Kosovës. Kjo është keq, është shqetësues për mua, është shqetësues për të gjithë dhe mendoj që Mali i Zi nuk ka çka të flasë më shumë se që paska folur Komisioni", ka shtuar ai. Selimi ka thënë se ata i kanë dëgjuar qëndrimet e Malit të Zi, duke përfutur edhe atë të ambasadorit, që thotë se nuk kanë pretendime territoriale ndaj Kosovës, por, sipas tij, duhet ditur se nga cili pozicion po flet ambasadori. "Ai po flet nga pozicioni që tashmë e konsideron si të arritur, marrjen e 7 mijë, respektivisht 5 mijë e 300 hektarëve të tjerë", ka thënë Selimi.

© KOHA Ditore

NJOHJA E DITËS KËTË VËREJËM SE...

LIDERI I AAK-SË ORGANIZOI TRYEZË PËR DEMARKACIONIN

Cërabregu: Kufiri me Malin e Zi sipas hartës së vitit 1962

"Demarkacioni kufitar duhet t'u përmbahet majave malore, kurrizeve, ujëndarësve. Harta e vetme e besueshme që duhet të merret për bazë për caktimin e kufirit me Malin e Zi është ajo e vitit 1962, e botuar në Enciklopedinë e Jugosllavisë", ka thënë Muharrem Cërabregu, profesor dhe ekspert ndërkombëtar i Ajro Grafikës, gjatë debatit për demarkacionin me Malin e Zi, që e organizoi lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj

Leonora Aliu

Prestigj, 29 korrik - Profesori i Hartografisë në Universitetin e Prishtinës, njehësish ekspert ndërkombëtar i Ajro Grafikës, Muharrem Cërabregu, ka hequr poshtë idenë që kufijtë me Malin e Zi të caktohen në bazë të kufijve administrativë të vitit 1974.

Cërabregu të mërkurën gjatë një debati të organizuar nga lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, për demarkacionin me Malin e Zi, ka thënë se vetnija hartë që mund të merret e besueshme nga institucionet shtetërore është ajo e vitit 1962, e botuar në Enciklopedinë e Jugosllavisë. "Shkenctarët që merren me studimin e maleve, beshkët tona i kanë quajtur Alpet Shqipëtare. Kjo region se është një varg apo njësi malore që është e banuar prej shqiptarëve", ka thënë ai gjatë një prezantimi të tij para pjesëmarrësve në debat, ku ishin edhe ekspertë të tjerë të hartografisë, përfaqësues të banorëve të Rugovës, kryetari i Pejës, Gazmend Muhaxhi, dhe ai i Degutit, Rasim Selmanaj, si dhe deputetë nga parti të ndryshme.

Cërabregu ndër tjerash prezantoi hartën për të cilën tha se tregon saktësisht kufirin natyror mes Kosovës dhe Malit të Zi. Ai regjoi se ajo u punua nga Instituti Ushtrikë i Gjeografisë në kuadër të ish-Jugosllavisë.

Cërabregu ka folur për një situatë të ngjashme të caktimit të demarkacionit në rastin e caktimit të kufijve mes Sllovenisë dhe Italisë pas Luftës së Dytë Botërore.

"Është një qytet në Slloveni në kufi me Italinë, Gorici në Itali, kurse Nova Gorica në sllovenisht. Demarkacioni ka rënë nësej që bënë e trenit me qenë në Slloveni, kurse stacioni i trenit në Itali, edhe asaj ka mbetur", ka treguar profesori.

Cërabregu ka shprehur edhe një rast tjetër iu vija e demarkacionit në Slloveni ka rënë në oborin e një shtëpie private dhe e banuar me tëj problemet që mund të dalin nga pro-

cesi i caktimit të kufijve mes shteteve. Mirëpo, sipas tij, Kosova nuk e ka këtë problem me Malin e Zi, meqë kufijtë mes këtyre të dyjave shtetëve në vije malore.

"Kur është demarkacioni në vjetër maleve është shumë më e lehtë me u gjel vijat sesa në rrahisht apo vendbanime. Në rastin tonë demarkacioni ka qenë i lehtë, sepse filloi prej majës malore me Shqipërinë deri në Mal të Zi dhe Kosovë", ka thënë ai. "Demarkacioni kufitar duhet t'u përmbahet majave malore, kurrizeve, ujëndarësve", ka shtuar Cërabregu.

Lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, njehësish anëtar në Komisionin parlamentar për punë të jashtme, ka sqaruar se tryeza të cilën ka ftuar të mërkurën nuk ka qëllime politike, porse ka për synim të veprimtari të cilët zgjidhen për problemin e caktimit të kufirit të saktë me Malin e Zi, duke e quajtur temë të ndjekshme.

"Kemi hulumtuar për të konstatuar një gjendje reale, për të cilin të vërtetën dhe për të arritur që këtë të vërtetë t'ia përcjellim votës, institucioneve tona. Kjo nuk është temë partiake, nuk e përfaqësoj partinë në këtë rast. Për të mundësuar një korrigjim të një gjendjeje çfarë jemi do të thotë për të caktuar kufizimin me Malin e Zi", ka thënë ai, duke shtuar në tej se saktësimi i kufirit nuk dënton marrëdhëniet me Malin e Zi, por i forcuan ato.

Javë më parë Haradinaj ka kështë hequr në pyetje hartën e vitit 1974 kryetarin të Komisionit shtetëror për caktimin e demarkacionit, Murat Mehish, gjatë raportimit të tij në Komisionin për punë të jashtme.

Haradinaj, duke mos u pajtuar me kufijtë në bazë të asaj harte, meqë pretendohet se humbin disa hektare tokë të Kosovës, e kishte quajtur Mehish gënjeshtrë dhe bërëlot.

Shumë detaje e shumë përgjigje Mehish dësh t'u jepje edhe anëtarëve të tjerë të Komisionit që u interesonte nëse janë të vërteta shqiptarësit e banorëve dhe nëse vërtet Mali i Zi synon të marrë pjesë nga territori i Kosovës. Por i bindur kryetari i Komisionit për demarkacion, ka thënë se nuk ka lëvizje në territorin e Republikës së Kosovës.

Me raportimin e Komisionit është realizuar vetën një nga pifat e rezolutës të miratuar më 25 qershor në Kuvendin e Kosovës, ndërsa me rezolutë gjithashtu

banorëve të zonës së Rugovës rreth caktimit të kufijve me Malin e Zi. Sipas tij, kufijtë e prezantuar nga Murat Mehish në Komisionin për punë të jashtme tregojnë se kufiri është zhdukur për disa metra.

"Jemi të brengosur se kufiri u zhduk për 5 mijë e 500 metra edhe pse ne e kemi asfaltuar atë pjesë të rrugës ndëse pas vitit 2000, do të thotë është asfaltuar deri në kufirin me

mevi fterën në këmbë të shëndoshë. I kemi ato materialet, janë ato fakte dhe harta topografike, po të diskutojmë tash u për 74, 80 kilometra, ka thënë kufi. Mbledhjet argumente të tij i ka dhënë deputetit i LDK-së, njehësish profesor i gjeografisë, Shqipëri Ballgji.

"Është fat i madh që ato harta nuk i kemi bërë në shqipërisë, por e ka bërë Instituti Ushtrikë Gjeografik i Jugosllavisë, që ka qenë ndër më të njohurit ndoshta edhe në Evropë. Ky është argument i njëkësishëm", ka thënë ai.

Në diskutim e iniciativë nga Haradinaj mori pjesë edhe Mulla Sadriu, një hoxhë i njohur nga Rugova, i cili foli në emër të banorëve të asaj zone për problemet në të cilat kanë hasur për shkak të moscaktimit të kufijve.

"Ka pasur raste kur banorët i kanë blerë buqetë, e pasi i kanë blerë i kanë hequr i kanë shfrytëzuar edhe varrezat, i kam edhe emrat që i kanë shfrytëzuar me baget. Mali i Zi i ka mbyll varret me baget", ka treguar ai.

Çështja e demarkacionit me Malin e Zi është parashikuar të përmbillet tash këtë vit nga ana e përfaqësuesve shtetërorë. Mirëpo deputetë të opozitës në vazhdimësi janë debatuar parlamentare e kanë ngritur këtë çështje si problem, meqë, sipas kërkesave malazeze, Kosova rrezikon të humbë tokë.

Për çështjen e demarkacionit është ftuar në interpelancë ministri i Pushtet të Jashtme, Hasliu Thaçi, i cili tashun nga grupi parlamentar i AAK-së se ka bërë pazare me tokën e Kosovës.

Pas disa shtytjeve në interpelancën që u mbaj më 25 qershor të këtij viti, Thaçi kishte garantuar se Kosova nuk do të humbë as edhe një pëllëmbë toke. Mirëpo, pasi deputetët kishin filluar t'ia argumentonin rrezikun, ai nuk ishte këtyre fare në pjesën e dytë të interpelancës, e cila vazhdoi pa të.

© KOHA Ditore



kërkohej që caktimi i kufijve me Malin e Zi të jetë vija kufitare sipas Rrethit të vitit 1974, bazuar në statusin politik të Kosovës.

All Lajçi, që është kryetar i Komisionit komunal për demarkacionin me Malin e Zi, e quajti hartën e 1974-s komulim të një shtate politike.

"Murat Mehish thotë kur bëjnë debate se të 74-të janë reale dhe asnjë pëllëmbë nuk e humbin. Ky është komulim nëse marrim për bazë hapësirën tokësore dhe malore, beshkët etj. Kjo është në kundërshtim të plotë me realitetin", ka thënë Lajçi.

Kryetari i Pejës, Gazmend Muhaxhi, shprehu shqetësimin e

Malin e Zi, ku duket prej anës së Republikës së Kosovës", ka treguar Muhaxhi.

Ai ndër tjerash tha se janë munduar të gjejnë fakte se bashku me banorët dhe ia kanë përcjellë që të gjitha Komisionit shtetëror për demarkacion.

Ligjvuesi i hartografisë në Universitetin e Prishtinës, Florim Isufi, duke kritikuar konfuzionin që po krijohet në opinion, me harta të kufijve të ndryshme, ka thënë se kufijtë nuk caktohen në periudhë të ndryshme kohore.

Sipas tij, kufijtë më realë janë ata që u caktuan pas Luftës së Dytë Botërore, e që përkojnë me të dhejat që janë botuar edhe në hartën e 1962-s të prezantuar nga profesor i tij Muharrem Cërabregu.

"Ne s'hemi se çka të shtojmë në tujë, sepse është bërë prej ushtarëve të ish-Jugosllavisë. Pse

Banorët e
zonave kufitare
kundërshtojnë
demarkacionin
me Malin e Zi

www.kosovo-sol.info



Shteti fqinj gllabëron 12 mijë HEKTARË TOKË TË KOSOVËS

LAJÇI: Shteti duhet t'i mbrojë interesat e veta

Ali Lajçi, përfaqësues i komunës së Pejës si vëzhgues në Komisionin shtetëror për demarkacionin me Malin e Zi, thotë se ky komision nuk po tregon gatishmëri që të mbrojë interesat e Republikës së Kosovës, sepse askush nuk i di më mirë kufijtë se si vetë banorët e brezit kufitar

Banorët e Rugovës së Pejës, ata të Anadimit, Rojnë deputetët e Parlamentit të Kosovës të mos e ratifikojnë marrëveshjen për demarkacionin e kufirit në mes të Republikës së Kosovës dhe asaj të Malit të Zi, sipas propozimit të Komisionit shtetëror të Kosovës të prirë nga Murat Meha, dorëheqjen e të cilit e kërkojnë me ngulm. Ata thonë se Murat Meha asnjëherë nuk deshi të degjonte kërkesat, faktet dhe

argumentet që banorët ua ofruan se pika kufitare me Malin e Zi shtrihet prej Qakorr në Kullë. Shtojnë se Meha nuk degjoi e as që i mori në konsideratë as konkluzionet e Asamblesë komunale, për të mos bërë kompromise me Malin e Zi në dëm të pronave të shtetit të Kosovës, përpos vijës kufitare të vitit 1974 në pikat kufitare në Qakorr dhe Kullë, e jo ato të modifikuara nga pala malazeze të viteve 2002 dhe 2008.

"Çenohen tokat tona"

Çështja e demarkacionit të kufirit në mes të Kosovës dhe Malit të Zi është çështje nacionale, e nivelit shtetëror, dhe nuk duhet dhe nuk guxon të minimizohet vetëm si çështje e Komunës së Pejës, apo vetëm e banorëve të trevis së Rugovës dhe atyre të Anadimit, të cilët në këtë rast rrezikohen me gllabërimin nga Mali i Zi të 12 mijë hektarëve të bishkëqve të gjerdanit të Alpeve shqiptare, duke filluar nga Bëshkë e Roshkodolir e komunës së Deganit e deri në shkallë të Zhlebit në Kullë. Për këtë qëllim më se 500 banorë të trevave të Rugovës dhe të Podgorit të Anadimit janë taluar të dëfen nëmbanë në Vitoznice për të shprehur edhe një herë shqetësimet e tyre për "lojërat e pista" që dikush po i luan me vijën kufitare, e që sipas shumicës nga ta nuk do të pranohet as një

te recipronë, që nuk janë të barabarta
ra sot qytetarit të Kosovës ju ka dhënë
or ju ka dhënë mundësi me u plaçkitur
r vetëm për të dhënë a qytetarit të

S'preket asnjë metër i Kosovës me Malin e Zi

Albert Ahmeti / Prishtinë

Qeveria e Kosovës e ka miratuar raportin e Komisionit Shtetëror për shënjimin e vijës kufitare me Malin e Zi. Ndërsa drejtuesit e koalicionit qeverisës, kryeministri Isa Mustafa dhe zëvendësi i tij, Hashim Thaçi, kanë thënë se nga demarkacioni i kufirit me Malin e Zi, Kosova nuk e humb asnjë milimetër territor. Në mbledhjen e së mërkurës para Qeverisë, për këtë çështje ka raportuar edhe kreu i këtij Komisioni, Murat Meha.

Kryeministri, Isa Mustafa, ka thënë se me shënimin e kësaj vije kufitare nuk preket territori i Kosovës dhe ka kërkuar nga Komisioni për Demarkacionin që ta garantojë edhe një herë një gjë të tillë.

"Kam qenë unë, ka qenë zëvendëskryeministri Thaçi, ka qenë zëvendëskryeministri Shala, kemi mbajtur edhe takime të tjera, dhe ajo çka na intereson ne është se a ndryshon sipërfaqja e Republikës së Kosovës me rastin e përcaktimit të këtij kufiri. Komisioni ka dëshmuar se sipërfaqja nuk ndryshon për asnjë centimetër katror, edhe një herë kisha kërkuar nga kryetari i Komisionit t'ia thotë Qeverisë e po ashtu nuk ndryshon sipërfaqja e komunës së Pejës ku ka pasur probleme", ka deklaruar Mustafa.

Ndërsa, zëvendëskryeministri dhe ministri i Punëve të Jashtme, Hashim Thaçi, ka thënë se ky kufi është në përputhje me Kushtetutën e vitit 1974 dhe me Pakon e Ahtisaarit.

"Në bazë të Raportit të Punës të Komisionit Shtetëror, shënjimi i vijës kufitare me Malin e Zi është në përputhshmëri të plotë me vijën kufitare sipas Kushtetutës së vitin 1974, me Planin e Ahtisaarit dhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe se komisioni shtetëror garanton se me

përcaktimin e vijës kufitare me Malin e Zi nuk do të tjetërsohet asnjë milimetër katror i territorit të Republikës së Kosovës", është shprehur Thaçi.

Për këtë çështje ka folur edhe kryetari i Komisionit Shtetëror për shënjimin dhe mirëmbajtjen e pikave kufitare, Murat Meha, i cili ka njoftuar se tani vetëm po bëhet shënjimi i vijës kufitare administrative me Malin e Zi dhe se nuk po krijohen kufij të rinj.

"Komisioni kishte për detyrë të shënojë vijën administrative që kishte Krahina Socialiste Autonome e Kosovës brenda RSF të Jugosllavisë, ndërsa tani bëhet kufi ndërkombëtar i Republikës së Kosovës... Ndërsa me shënimin e vijës kufitare me këtë rast nuk krijohen kufij të rinj, po shënohet kufiri administrativ i Kosovës duke e rikthyer të njëjtën në kufi shtetëror", ka sqaruar Meha.

Ndërkohë që në mesin e shumë dokumenteve dhe projektligjeve të miratuara, Qeveria ka aprovuar edhe emërimin e Herset Mazrekajt për Avokat të Përgjithshëm të Avokaturës Shtetërore për një mandat trevjeçar.

Në mbledhjen e të mërkurës, Qeveria po ashtu ka miratuar anulimin e amendamentit të 10-të në shqyrtimin e dytë të Buxhetit të aprovuar nga Kuvendi më 16 korrik 2015 për këtë vit me të cilën janë ridestinuuar një pjesë e mjetet nga dy projekte ekzistuese në Ministrinë për Komunitete dhe Kthim në 12 projekte të reja në shumë prej 1 milion e 450 mijë euro të destinuar për komunitetin turk, boshnjak dhe ashkali, egjiptian, goran dhe romë. Ky vendim erdhi pasi që ishte konstatuar se nuk kishte buxhet të mjaftueshëm për realizimin e këtij amendamenti.

Fakte:

"Me shënimin e vijës kufitare me këtë rast nuk krijohen kufij të rinj, po shënohet kufiri administrativ i Kosovës duke e rikthyer të njëjtën në kufi shtetëror", ka sqaruar Meha.

Literatura

- 4.** Asllan Pushka; Metodot kuantitative në gjeografi, ETMM, Prishtinë 1985
- 5.** David Martin; Geographic Information Systems Socioeconomic applications, Routledge, London & New York 1996
- 6.** Jankovic Bogomir; Prirucnik iz vojne topografije; Beograd 1985
- 7.** Muharem Cërabregu; Kosova në hartat e vjetra, Prishtinë 1977
- 8.** Muharem Cërabregu ; Aerokozmofotointerpretimi në gjeografi, ETMM, Prishtinë 1983
- 9.** Pal Nikolli; Elemente të hartografisë dhe topografisë, Fan Noli, Tiranë, 1998
- 10.** Rifat Talani; Praktikum i laboratorëve e detyrave të hartografi - topografisë, Camaj - Pipa, Shkodër, 1997
- 11.** Hartat topografike 1:50 000, 1:100 000, 1:300 000, të prodhuara nga VGI JNA, vitit 1948, 1958, 1962
- 12.** Gjeo - portalet e ndryshme nga interneti
- 13.** Enciklopedija NR Jugosllavije, Naklada Leksikografski Zavod FNRJ, Zagreb 1962
- 14.** Dr. Musa Gashi, "Disa fakte mbi Kosovën", 1997
- 15.** Dr. Asllan Pushka: "Aspekte gjeopopullative në Kosovë dhe rreth saj", Prishtinë 2000
- 16.** Mirela Slukan Altiq: "Gjeografia historike e Kosovës", Unioni i bashkësive shqiptare në Republikën e Kroacisë, Zagreb 2007
- 17.** Instituti për Studime të Avancuara GAP; "Letërnjoftimi i Komunës së Pejës 2013"
- 18.** Instituti për Planifikim Hapësinor, Plani Hapësinor "Parku Kombëtar Bjeshkët e Nemuna", MMPH, 2015



Qendra per promovimin e zhvillimit

**FRIEDRICH
EBERT** 
STIFTUNG

DEMARKACIONI KOSOVË - MALI I ZI

(ASPEKTE NDËKOMBËTARE, GJEOGRAFIKE, POLITIKE DHE HISTORIKE)

Redaktura: Prof. dr. Muhamet Sadiku

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

Thyerja kompjuterike: The Milky Way

Shtypshkronja: Studio FORMA

Botuesi: Kolegji evropian "Dukagjini" - Pejë

dukagjini
KOLEGJI EVROPIAN EUROPEAN COLLEGE

DEMARKACIONI KOSOVË-MALI I ZI

(ASPEKTE NDËRKOMBËTARE,
GJEOGRAFIKE,
POLITIKE DHE HISTORIKE)

2015

341.222(496.51:497.16)(091)

32(496.51:497.16)(091)

Demarkacioni Kosovë – Mali i Zi : (aspekte ndërkombëtare, gjeografike, politike dhe historike) / redaktor Muhamet Sadiku. – Pejë : Kolegji Evropian “Dukagjini”, 2015. – f 95. : ilustr. me ngjyra ; 24

Literatura : f. 91

1. Sadiku, Muhamet

ISBN 978-9951-623-09-4